



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË



Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2024 – Numri: 170

Tiranë – E martë, 8 tetor 2024

PËRMBAJTJA

Faqe

Vendim i Këshillit të Ministrave
nr. 615, datë 2.10.2024

Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2024, miratuar për Ministrinë e Drejtësisë, për pagesën e tarifës për konsulencën e ofruar nga subjekti ndërkombëtar “*Boston Consulting Group (BCG)*”, për ofrimin e shërbimit të konsulencës për identifikimin e mekanizmave eficientë për të nxitur më tej luftën kundër korrupsionit dhe mundësinë e përdorimit të inteligjencës artificiale (IA) për këtë qëllim, si dhe për pagesën e tarifës për konsulencën e ofruar nga subjekti ndërkombëtar “*G37 Chambers*”, për ofrimin e shërbimit të konsulencës për analizimin dhe vlerësimin e të dhënave, që duhet të mbliidhen nga Ministria e Drejtësisë, me qëllim vlerësimin e fushave të rekomandimeve prioritare në luftën kundër kriminalitetit dhe për hartimin e metodologjisë për mënyrën e vlerësimit e të ndjekjes në vazhdimësi të zbatimit të këtyre rekomandimeve.....

19807

Udhëzim i ministrit të Arsimit
dhe Sportit nr. 20, datë 2.10.2024

Për ndryshimet në udhëzimin nr. 12, datë 30.6.2023, të ministrit të Arsimit dhe Sportit, “Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në institucionet e arsimit të lartë”.....

19807

Urdhër i ministrit të Shëndetësisë
dhe Mbrojtjes Sociale
nr. 473/1, datë 1.10.2024

Për një shtesë në urdhrin nr. 473, datë 4.9.2024, “Për delegim kompetence”.....

19808

Urdhër i ministrit të Bujqësisë
dhe Zhvillimit Rural nr. 744,
datë 24.9.2024

Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së gjuhës blu të shfaqur në shtetin e Italisë.....

19808

Urdhër i ministrit të Bujqësisë
dhe Zhvillimit Rural nr. 745,
datë 24.9.2024

Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së lisë së dhenve dhe dhive të shfaqur në shtetin e Turqisë.....

19810

Urdhër i ministrit të Bujqësisë
dhe Zhvillimit Rural nr. 746,
datë 24.9.2024

Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së gjuhës blu të shfaqur në shtetin e Danimarkës.....

19812

Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 747, datë 24.9.2024	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve të shfaqur në shtetin e Republikës së Çekisë.....	19813
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 56, datë 16.7.2024	Me objekt shfuqizimin e pjesëshëm të ligjit nr. 81/2022, “Për një ndryshim në ligjin nr. 61/2012, ‘Për akcizat në Republikën e Shqipërisë’”, për “Kategoria B000, kodin NK 22 03, produkti ‘Birra nga malto me shkallë alkoolometrike ndaj volumit më të madh se 0.5%’, në tabelën II” dhe të ligjit nr. 94/2023, “Për disa ndryshime në ligjin nr. 61/2012, ‘Për akcizat në Republikën e Shqipërisë’, të ndryshuar” për “Kategoria B000, kodin NK 22 03, produkti ‘Birra nga malto me shkallë alkoolometrike ndaj volumit më të madh se 0.5%’, në tabelën II”, si të papajtueshme me nenet 11, 41 dhe 17, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, me nenin 70 të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, direktivën nr. 92/83/KE dhe direktivën nr. 92/84/KE. Pezullimin e ekzekutimit të ligjeve nr. 81/2022 dhe nr. 94/2023 deri në kohën kur vendimi fillon efektet.	19814
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 57, datë 17.9.2024	Me objekt shfuqizimin e vendimit nr. 00-2023-3812, datë 12.10.2023 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e procedurave në gjykimin e çështjes administrative nr. 31154-02568-86-2019, datë 28.6.2019, të regjistruar pranë Gjykatës Administrative të Apelit. Detyrimin e Gjykatës Administrative të Apelit të shqyrtojë çështjen brenda afatit njëmuor nga dhënia e vendimit të Gjykatës Kushtetuese.....	19832
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 160, datë 15.8.2024	Mbi fillimin e procedurës, lidhur me shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “Hpg Energy” sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike	19838
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 161, datë 15.8.2024	Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin korrik 2024 për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV.....	19839
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 162, datë 15.8.2024	Mbi rinovimin e licencës së shoqërisë “Furnizuesi i Shërbimit Universal” sh.a. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.....	19841
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 163, datë 15.8.2024	Mbi fillimin e procedurës, lidhur me shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “Noa Energy Trade” sh.p.k. për rinovimin e licencës në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.....	19842
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 164, datë 15.8.2024	Mbi licencimin e shoqërisë “Nova Prospect” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.....	19842
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 165, datë 15.8.2024	Mbi zgjatjen e vendimmarrjes së Bordit të ERE-s lidhur me shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “BMG Energy SAL” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.....	19844
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 166, datë 15.8.2024	Mbi disa ndryshime në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 135, datë 9.7.2024, “Mbi licencimin e shoqërisë ‘5GX Energy’ sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”.....	19845

Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 177, datë 3.9.2024	Mbi miratimin e kontratës tip për depozitimin/shkëmbimin/shitjen/ blerjen e energjisë elektrike midis shoqërive KESH sh.a. dhe FTL sh.a.....	19846
Kërkesë e Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin nr. 498/12, datë 4.10.2024	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Rikonstruksioni i shkollës së mesme, ‘Ramis Aranitasi’ Çorovodë, si dhe ruajtjes së perimetrit të sigurisë në shkolla”.....	19857



VENDIM
Nr. 615, datë 2.10.2024

**PËR NJË SHITESË FONDI NË
BUXHETIN E VITIT 2024, MIRATUAR
PËR MINISTRINË E DREJTËSISË, PËR
PAGESËN E TARIFËS PËR
KONSULENCËN E OFRUAR NGA
SUBJEKTI NDËRKOMBËTAR “*BOSTON
CONSULTING GROUP (BCG)*”, PËR
OFRIMIN E SHËRBIMIT TË
KONSULENCËS PËR IDENTIFIKIMIN
E MEKANIZMAVE EFICIENTË PËR TË
NXITUR MË TEJ LUFTËN KUNDËR
KORRUPSIONIT DHE MUNDËSINË E
PËRDORIMIT TË INTELIGJENCËS
ARTIFICIALE (IA) PËR KËTË QËLLIM,
SI DHE PËR PAGESËN E TARIFËS PËR
KONSULENCËN E OFRUAR NGA
SUBJEKTI NDËRKOMBËTAR “*G37
CHAMBERS*”, PËR OFRIMIN E
SHËRBIMIT TË KONSULENCËS PËR
ANALIZIMIN DHE VLERËSIMIN E TË
DHËNAVE, QË DUHET TË MBLIDHEN
NGA MINISTRIA E DREJTËSISË, ME
QËLLIM VLERËSIMIN E FUSHAVE TË
REKOMANDIMEVE PRIORITARE NË
LUFTËN KUNDËR KRIMINALITETIT
DHE PËR HARTIMIN E
METODOLOGJISË PËR MËNYRËN E
VLERËSIMIT E TË NDJEKJES NË
VAZHDIMËSI TË ZBATIMIT TË
KËTYRE REKOMANDIMEVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të pikës 1, të nenit 14, të ligjit nr. 97/2023, “Për buxhetin e vitit 2024”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin dhe të ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në buxhetin e vitit 2024, miratuar për Ministrinë e Drejtësisë, shtohet fondi prej 36 000 000 (tridhjetë e gjashtë milionë) lekësh, prej të cilave 30 000 000 (tridhjetë milionë) lekë për pagimin e tarifës për konsulencën e ofruar nga subjekti

ndërkombëtar “*Boston Consulting Group (BCG)*” për ofrimin e shërbimit të konsulencës për identifikimin e mekanizmeve eficientë për të nxitur më tej luftën kundër korrupsionit dhe mundësinë e përdorimit të inteligjencës artificiale (IA) për këtë qëllim, si dhe 6 000 000 (gjashtë milionë) lekë për pagimin e kështit të parë të tarifës për konsulencën e ofruar nga subjekti ndërkombëtar “*G37 Chambers*”, për ofrimin e shërbimit të konsulencës për analizimin dhe vlerësimin e të dhënave, që duhet të mblidhen nga Ministria e Drejtësisë, me qëllim vlerësimin e fushave të rekomandimeve prioritare në luftën kundër kriminalitetit dhe për hartimin e metodologjisë për mënyrën e vlerësimit e të ndjekjes në vazhdimësi të zbatimit të këtyre rekomandimeve.

2. Efekti financiar, që rrjedh nga zbatimi i këtij vendimi, përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave, miratuar për vitin 2024.

3. Ngarkohen ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

UDHËZIM
Nr. 20, datë 2.10.2024

**PËR NDRYSHIMET NË UDHËZIMIN
NR. 12, DATË 30.6.2023, TË MINISTRIT
TË ARSIMIT DHE SPORTIT, “PËR
PROCEDURAT E APLIKIMIT DHE TË
REGJISTRIMIT NË INSTITUCIONET E
ARSIMIT TË LARTË”**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe të urdhrin nr. 113, datë 26.3.2024, “Për delegimin e kompetencave dhe caktimin e detyrave të zëvendësministrit të Arsimit dhe Sportit, znj. Ana Kapaj”, i ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Në udhëzimin nr. 12, datë 30.6.2023, të Ministrit të Arsimit dhe Sportit “Për procedurat e



aplikimit dhe të regjistrimit në institucionet e arsimit të lartë”, bëhen ndryshimet si më poshtë:

a) Pika 9, e kreut VII, ndryshohet si më poshtë:

“9. Për ndjekjen e studimeve në programe të ciklit të dytë, pranohen kandidatët që:”;

b) Në pikën 9, të kreut VII, shkronjat “a” ndryshohet si më poshtë:

“a) zotërojnë një diplomë të ciklit të parë, të fituar pas përfundimit me sukses të studimeve përkatëse në një institucion të arsimit të lartë dhe program studimi, i cili ka qenë i licencuar përpara regjistrimit të studentit dhe me akreditim përpara lëshimit të diplomës, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi të kohës.

Për kandidatët të cilët zotërojnë diplomë të ciklit të parë të lëshuar nga institucionet e arsimit të lartë të mbyllura në zbatim të legjislacionit në fuqi, data e lëshimit të diplomës duhet të ketë qenë sipas afateve të përcaktuara në aktet nënligjore për mbylljen e tyre. Vërtetësia (autenticiteti) i të dhënave të këtyre diplomave konfirmohet përmes vërtetimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave.

Vlerësimi i mësipërm kryhet nga institucioni përgjegjës për dhënien e numrave të matrikullimit, i cili sipas rastit, kërkon informacion në MAS dhe ASCAL, lidhur me aktet e licencimit dhe akreditimit të institucioneve dhe/ose të programeve të studimit.”.

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimit Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, Qendra e Shërbimeve Arsimore, Qendra Ndërinstitucionale e Rrjetit Akademik Shqiptar, drejtoritë rajonale dhe zyrat vendore të arsimit parauniversitar dhe institucionet e arsimit të lartë.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSMINISTËR I ARSIMIT
DHE SPORTIT
Ana Kapaj

URDHËR

Nr. 473/1, datë 1.10.2024

PËR NJË SHITESË NË URDHRIN NR. 473, DATË 4.9.2024, “PËR DELEGIM KOMPETENCE”

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, datë 30.4.2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; nenit 11, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, si dhe pikës 3, shkronja “a”, të vendimit nr. 870, datë 14.12.2011, të Këshillit të Ministrave, “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit”,

URDHËROJ:

1. Në urdhrin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 473, datë 4.9.2024, “Për delegim kompetence”, pika 1, pas shkronjës “h”, të shtohet shkronja “i”, me përmbajtje si më poshtë vijon:

i) të nënshkruajë urdhrin për dërgimin me shërbim jashtë vendit, të punonjësve të institucioneve të varësisë.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I SHËNDETËSISË DHE
MBROJTJES SOCIALE
Albana Koçiu

URDHËR

Nr. 744, datë 24.9.2024

PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ SËMUNDJES SË GJUHËS BLU TË SHFAQUR NË SHTETIN E ITALISË

Mbështetur në nenin 102, pika 4 e Kushtetutës, neni 43, i ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit, tranzitimit në territorin e Republikës së Shqipërisë, të:



a) kafshëve të gjalla të llojit të ruminantëve dhe kamelidëve;

b) spermën dhe embrionet e kafshëve të gjalla të llojit të ruminantëve dhe kamelidëve,

nga shteti i Italisë, sipas ndarjeve administrative të tabelës së mëposhtme:

Ndarja administrative e nivelit të parë	Ndarja administrative e nivelit të dytë*	Ndarja administrative e nivelit të tretë
Valle d'Aosta	Aosta	Aosta*
Valle d'Aosta	Aosta	Chambave*
Valle d'Aosta	Aosta	Chatillon*
Valle d'Aosta	Aosta	Challand-Saint-Anselme*
Valle d'Aosta	Aosta	Courmayeur*
Valle d'Aosta	Aosta	Donnas*
Valle d'Aosta	Aosta	Perloz*
Valle d'Aosta	Aosta	Pont-Saint-Martin*
Valle d'Aosta	Aosta	Montjovet*
Valle d'Aosta	Aosta	Morgex*
Valle d'Aosta	Aosta	Saint-Denis*
Valle d'Aosta	Aosta	Quart*
Valle d'Aosta	Aosta	Verrès*

Shënime. Simboli () nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.*

2. Importi dhe tranzitimi nga ndarjet administrative të cilat nuk janë të cituara në tabelën e mësipërme, lejohet vetëm nëse plotësohen kushtet e mëposhtme:

a) Certifikata shëndetësore veterinarë vërteton që kafshët e gjalla të llojit të ruminantëve dhe kamelidëve:

i. nuk kanë treguar asnjë shenjë klinike të gjuhës blu në ditën e dërgesës; dhe

ii. kanë qenë të mbrojtur nga sulmet e mushkonjave të gjinisë *Culicoides*, në përputhje me nenin 8.3.13 të Kodit të Kafshëve Tokësore, në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët për të paktën 60 ditë para dërgesës dhe gjatë transportit në vendin e dërgesës; ose

iii. kanë qenë të mbrojtur nga sulmet e mushkonjave të gjinisë *Culicoides*, në përputhje me nenin 8.3.13 të Kodit të Kafshëve Tokësore, në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët për të paktën 28 ditë para dërgesës dhe gjatë transportit në vendin e dërgesës, dhe gjatë asaj periudhe i janë nënshtruar një testi serologjik për të zbuluar antitrupe ndaj

virusit të gjuhës blu, me rezultate negative, të kryera të paktën 28 ditë pas futjes në stabilimentin e mbrojtur nga vektorët; ose

iv. kanë qenë të mbrojtur nga sulmet e mushkonjave të gjinisë *Culicoides*, në përputhje me nenin 8.3.13 të Kodit të Kafshëve Tokësore, në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët për të paktën 14 ditë para dërgesës dhe gjatë transportit në vendin e dërgesës, dhe gjatë kësaj periudhe i janë nënshtruar një testi identifikimi të agjentit të sëmundjes, me rezultate negative, të kryer të paktën 14 ditë pas futjes në stabilimentin e mbrojtur nga vektorët;

b) janë:

i. vaksinuar, të paktën 60 ditë përpara dërgesës, kundër të gjitha stereotipave të demonstruara të pranishme në popullatën burimore nëpërmjet një programi mbikëqyrjeje, në përputhje me nenet 8.3.14 deri në 8.3.17 të Kodit të Kafshëve Tokësore;

ii. identifikuar si të vaksinuar; ose

iii. është demonstruar se kishte antitrupe për të paktën 60 ditë përpara dërgesës kundër të gjitha stereotipave të demonstruara se janë të pranishme në popullatën burimore nëpërmjet një programi mbikëqyrjeje, në përputhje me nenet 8.3.14 deri në 8.3.17 të Kodit të Kafshëve Tokësore;

c) Certifikata shëndetësore veterinarë të vërtetojë që meshkujt dhurues të spermës së kafshëve të gjalla të llojit të ruminantëve dhe kamelidëve:

i. nuk kanë treguar asnjë shenjë klinike të gjuhës blu në ditën e mbledhjes; dhe

ii. janë mbajtur në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët, në përputhje me pikën 1, të nenit 8.3.13 të Kodit të Kafshëve Tokësore për të paktën 60 ditë para fillimit dhe gjatë mbledhjes së spermës; ose

iii. i janë nënshtruar një testi serologjik për zbulimin e antitrupeve ndaj virusit të gjuhës blu, me rezultate negative, midis 28 dhe 60 ditësh pas çdo grumbullimi për këtë ngarkesë; ose

iv. i janë nënshtruar një testi identifikimi të agjentit të sëmundjes në mostrat e gjakut të mbledhura në fillim dhe përfundim të, dhe të paktën çdo 7 ditë (testi i izolimit të virusit) ose të paktën çdo 28 ditë (testi PCR) gjatë mbledhjes së spermës për këtë ngarkesë, me rezultate negative;

v. sperma është mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me kapitujt 4.6 dhe 4.7 të Kodit të Kafshëve Tokësore;

d) Certifikata shëndetësore veterinarë të vërtetojë që femrat dhuruese të embrioneve *in vivo* të kafshëve të gjalla të llojit të ruminantëve dhe kamelidëve:



i. nuk kanë treguar asnjë shenjë klinike të gjuhës blu në ditën e mbledhjes; dhe

ii. janë mbajtur në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët, në përputhje me pikën 1, të nenit 8.3.13 të Kodit të Kafshëve Tokësore, për të paktën 60 ditë përpara fillimit dhe gjatë mbledhjes së embrioneve; ose

iii. i janë nënshtruar një testi serologjik për të zbuluar antitrukat ndaj virusit të gjuhës blu midis 28 dhe 60 ditësh pas grumbullimit, me rezultate negative; ose

iv. i janë nënshtruar një testi për identifikimin e agjentit të sëmundjes në një kampion gjaku të marrë në ditën e mbledhjes së embrioneve, me rezultate negative;

v. embrionet janë mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me kapitujt 4.8, 4.9 dhe 4.10 të Kodit të Kafshëve Tokësore, sipas rastit;

vi. sperma e përdorur për fekondimin e ovociteve ishte në përputhje me nenin 8.3.9 ose nenin 8.3.10 të Kodit të Kafshëve Tokësore.

3. Certifikata veterinare shëndetësore të garantojë origjinën e tyre, sipas përcaktimeve të pikave 1 dhe 2.

4. Urdhri nr. 721, datë 18.9.2024, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së gjuhës blu të shfaqur në shtetin e Italisë”, shfuqizohet.

5. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht brenda 24 orëve Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit për çdo ngarkesë të të gjitha kafshëve të gjalla të llojit të ruminantëve të vegjël dhe spermën, dhe embrionet e kafshëve të gjalla të llojit të ruminantëve.

6. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSMINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
Arian Jaupllari

URDHËR

Nr. 745, datë 24.9.2024

PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ SËMUNDJES SË LISË SË DHENVE DHE DHIVE TË SHFAQUR NË SHTETIN E TURQISË

Mbështetur në nenin 102, pika 4 e Kushtetutës, neni 43, i ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë të të gjitha kafshëve të gjalla të llojit të dhirta dhe të leshta, materialit biologjik, dhe nënprodukteve të kafshëve të llojit të dhirta dhe të leshta, sipas njoftimeve të marra nga faqja zyrtare e OIE-së dhe ADIS-it, përkatësisht nga ndarjet administrative të përcaktuara në tabelën e mëposhtme.

Ndarja administrative e nivelit të parë	Ndarja administrative e nivelit të dytë*	Ndarja administrative e nivelit të tretë
Adana	Kozan*	
Adana	Aladağ*	
Malatya	Arguvan*	
Karaman	Merkez*	
Izmir	Dikili*	
Izmir	Çiğli*	
Izmir	Ödemiş*	
Izmir	Güzelbahçe*	
Kars	Kağızman*	
Hakkari	Merkez*	
Aydın	Sultanhisar*	
Çankiri	Çerkeş*	
Çankiri	Merkez*	
Ankara	Bala*	
Ankara	Polatlı*	
Ankara	Elmadag*	
Afyon	Sandıklı*	
Aksaray	Merkez*	
Balikesir	Bandırma*	
Balikesir	İvrindi*	
Balikesir	Merkez*	
Bursa	Gemlik*	
Erzurum	Tekman*	
Erzincan	Tercan*	
Isparta	Uluborlu*	
Karabük	Eflani*	
Giresun	Yağlıdere*	
Rize	Çamlıhemşin*	
Tokat	Zile*	



Tokat	Başçiftlik*	
Usak	Merkez*	
Usak	Eşme*	
Aydin	Köşk*	
Çorum	Kargı*	
Erzincan	Merkez*	
Eskisehir	Beylikova*	
Eskisehir	Seyitgazi*	
Kütahya	Tavşanlı*	
Bursa	Orhangazi*	
Bursa	Orhaneli*	
Çanakkale	Lapseki*	
Agri	Doğubeyazıt*	
Kütahya	Gediz*	
Malatya	Yazıhan*	

Shënime. Simboli () nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.*

2. Lejimin e importit dhe tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë të të gjitha kafshëve të gjalla të llojit të dhirta dhe të leshta, materialit biologjik, dhe nënprodukteve të kafshëve të llojit të dhirta dhe të leshta, nga ndarjet administrative të shtetit të Turqisë, të cilat nuk janë të cituara në tabelën e mësipërme, të pa infektuara nga sëmundja, nëse plotësohen kushtet e mëposhtme nga pika 2.1 deri në pikën 2.3:

2.1 Për kafshët e llojit të dhirta dhe të leshta certifikata veterinare duhet të vërtetojë që kafshët:

a) nuk kanë shfaqur asnjë shenjë klinike të lisë së dhenve ose dhive në ditën e dërgesës;

b) janë mbajtur që nga lindja, ose për 21 ditë e fundit, në një stabiliment ku nuk është raportuar zyrtarisht asnjë rast i lisë së dhenve ose dhive gjatë asaj periudhe, dhe se stabilimenti nuk ka qenë i vendosur në një zonë të infektuar me linë e dhenve ose të dhive; ose

c) janë mbajtur në një stacion karantine për 21 ditë para dërgesës;

d) nuk janë vaksinuar kundër lisë së dhenve dhe dhive; ose

e) janë vaksinuar duke përdorur një vaksinë që përputhet me standardet e përshkruara në Manualin Tokësor jo më pak se 15 ditë dhe jo më shumë se 4 muaj përpara dërgesës (natyra e vaksinës së përdorur, nëse është virusi i gjallë, i çaktivizuar apo i modifikuar, llojet dhe shtamet e virusit të përfshirë në vaksinë duhet të shënohen në certifikatë).

2.2 Për spermën e cjepëve dhe deshëve, certifikata veterinare duhet të vërtetojë se kafshët dhuruese:

a) nuk shfaqin asnjë shenjë klinike të lisë së dhenve ose dhive në ditën e mbledhjes së spermës dhe për 21 ditë në vijim;

b) janë mbajtur në vendin eksportues për 21 ditë para grumbullimit, në një stabiliment ose qendër fekondimi artificial ku nuk janë raportuar zyrtarisht asnjë rast i lisë së dhenve dhe dhive gjatë asaj periudhe, dhe se stabilimenti ose qendra e mbarështimit artificial nuk është e vendosur në zonën e infektuar të lisë së dhenve dhe dhive;

c) nuk janë vaksinuar kundër lisë së dhenve dhe dhive; ose

d) janë vaksinuar duke përdorur një vaksinë që përputhet me standardet e përshkruara në Manualin Tokësor (natyra e vaksinës së përdorur, nëse është virusi i gjallë i inaktivuar apo i modifikuar, llojet dhe shtamet e virusit të përfshira në vaksinë do të tregohen gjithashtu në certifikatë).

2.3 Për lëkurën dhe leshin e kafshëve të llojit të dhirta dhe të leshta, certifikata veterinare duhet të vërtetojë se këto produkte:

a) vijnë nga kafshë që nuk janë mbajtur në zonën e infektuar me linë e dhenve dhe të dhive; ose

b) janë përpunuar për të garantuar asgjësimin e virusit të lisë së dhenve dhe dhive, në ambiente të kontrolluara dhe të miratuara nga Autoriteti Veterinar i vendit eksportues.

3. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht brenda 24 orëve Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit për çdo ngarkesë të kafshëve të llojit dhen dhe dhi, nënprodukteve të tyre dhe materialit biologjik.

4. Urdhri nr. 676, datë 6.9.2024, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së lisë së dhenve dhe dhive të shfaqur në shtetin e Turqisë”, shfuqizohet.

5. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSMINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
Arian Jaupllari



URDHËR

Nr. 746, datë 24.9.2024

**PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ
SËMUNDJES SË GJUHËS BLU TË
SHFAQUR NË SHTETIN E
DANIMARKËS**

Mbështetur në nenin 102, pika 4 e Kushtetutës, neni 43, i ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit, tranzitimit në territorin e Republikës së Shqipërisë, të:

a) kafshëve të gjalla të llojit të ruminantëve dhe kamelidëve;

b) spermën dhe embrionet e kafshëve të gjalla të llojit të ruminantëve dhe kamelidëve,

nga shteti i Danimarkës, sipas ndarjeve administrative të tabelës së mëposhtme:

Ndarja administrative e nivelit të parë	Ndarja administrative e nivelit të dytë*	Ndarja administrative e nivelit të tretë
Veterinary Inspection Unit South	Tønder*	
Veterinary Inspection Unit South	Varde*	
Veterinary Inspection Unit North	Ringkøbing-Skjern*	

Shënime. Simboli (*) nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.

2. Importi dhe tranzitimi nga ndarjet administrative të cilat nuk janë të cituara në tabelën e mësipërme, lejohet vetëm nëse plotësohen kushtet e mëposhtme:

a) Certifikata shëndetësore veterinare vërteton që kafshët e gjalla të llojit të ruminantëve dhe kamelidëve:

i. nuk kanë treguar asnjë shenjë klinike të gjuhës blu në ditën e dërgesës; dhe

ii. kanë qenë të mbrojtur nga sulmet e mushkonjave të gjinisë *Culicoides*, në përputhje me nenin 8.3.13 të Kodit të Kafshëve Tokësore, në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët për të paktën

60 ditë para dërgesës dhe gjatë transportit në vendin e dërgesës; ose

iii. kanë qenë të mbrojtur nga sulmet e mushkonjave të gjinisë *Culicoides*, në përputhje me nenin 8.3.13 të Kodit të Kafshëve Tokësore, në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët për të paktën 28 ditë para dërgesës dhe gjatë transportit në vendin e dërgesës, dhe gjatë asaj periudhe i janë nënshtruar një testi serologjik për të zbuluar antitrupe ndaj virusit të gjuhës blu, me rezultate negative, të kryera të paktën 28 ditë pas futjes në stabilimentin e mbrojtur nga vektorët; ose

iv. kanë qenë të mbrojtur nga sulmet e mushkonjave të gjinisë *Culicoides*, në përputhje me nenin 8.3.13 të Kodit të Kafshëve Tokësore, në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët për të paktën 14 ditë para dërgesës dhe gjatë transportit në vendin e dërgesës, dhe gjatë kësaj periudhe i janë nënshtruar një testi identifikimi të agjentit të sëmundjes, me rezultate negative, të kryer të paktën 14 ditë pas futjes në stabilimentin e mbrojtur nga vektorët;

b) janë:

i. vaksinuar, të paktën 60 ditë përpara dërgesës, kundër të gjitha stereotipave të demonstruara të pranishme në popullatën burimore nëpërmjet një programi mbikëqyrjeje, në përputhje me nenet 8.3.14 deri në 8.3.17 të Kodit të Kafshëve Tokësore;

ii. identifikuar si të vaksinuar; ose

iii. është demonstruar se kishte antitrupe për të paktën 60 ditë përpara dërgesës kundër të gjitha stereotipave të demonstruara se janë të pranishme në popullatën burimore nëpërmjet një programi mbikëqyrjeje, në përputhje me nenet 8.3.14 deri në 8.3.17 të Kodit të Kafshëve Tokësore;

c) Certifikata shëndetësore veterinare të vërtetojë që meshkujt dhurues të spermës së kafshëve të gjalla të llojit të ruminantëve dhe kamelidëve:

i. nuk kanë treguar asnjë shenjë klinike të gjuhës blu në ditën e mbledhjes; dhe

ii. janë mbajtur në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët, në përputhje me pikën 1, të nenit 8.3.13 të Kodit të Kafshëve Tokësore, për të paktën 60 ditë para fillimit dhe gjatë mbledhjes së spermës; ose

iii. i janë nënshtruar një testi serologjik për zbulimin e antitrupeve ndaj virusit të gjuhës blu, me rezultate negative, midis 28 dhe 60 ditësh pas çdo grumbullimi për këtë ngarkesë; ose

iv. i janë nënshtruar një testi identifikimi të agjentit të sëmundjes në mostrat e gjakut të mbledhura në fillim dhe përfundim të, dhe të paktën



çdo 7 ditë (testi i izolimit të virusit) ose të paktën çdo 28 ditë (testi PCR) gjatë mbledhjes së spermës për këtë ngarkesë, me rezultate negative;

v. sperma është mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me kapitujt 4.6 dhe 4.7 të Kodit të Kafshëve Tokësore;

d) Certifikata shëndetësore veterinarë të vërtetojë që femrat dhuruese të embrioneve *in vivo* të kafshëve të gjalla të llojit të ruminantëve dhe kamelidëve:

i. nuk kanë treguar asnjë shenjë klinike të gjuhës blu në ditën e mbledhjes; dhe

ii. janë mbajtur në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët, në përputhje me pikën 1, të nenit 8.3.13 të Kodit të Kafshëve Tokësore, për të paktën 60 ditë përpara fillimit dhe gjatë mbledhjes së embrioneve; ose

iii. i janë nënshtruar një testi serologjik për të zbuluar antitrupe ndaj virusit të gjuhës blu midis 28 dhe 60 ditësh pas grumbullimit, me rezultate negative; ose

iv. i janë nënshtruar një testi për identifikimin e agjentit të sëmundjes në një kampion gjaku të marrë në ditën e mbledhjes së embrioneve, me rezultate negative;

v. embrionet janë mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me kapitujt 4.8, 4.9 dhe 4.10 të Kodit të Kafshëve Tokësore, sipas rastit;

vi. sperma e përdorur për fekondimin e ovociteve ishte në përputhje me nenin 8.3.9 ose nenin 8.3.10 të Kodit të Kafshëve Tokësore.

3. Certifikata veterinarë shëndetësore të garantojë origjinën e tyre, sipas përcaktimeve të pikave 1 dhe 2.

4. Urdhri nr. 652, datë 23.8.2024, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së gjuhës blu të shfaqur në shtetin e Danimarkës”, shfuqizohet.

5. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht brenda 24 orëve Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit për çdo ngarkesë të të gjitha kafshëve të gjalla të llojit të ruminantëve të vegjël dhe spermën, dhe embrionet e kafshëve të gjalla të llojit të ruminantëve.

6. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit

dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSMINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
Arian Jaupllari

URDHËR
Nr. 747, datë 24.9.2024

**PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ
SËMUNDJES SË INFLUENCËS AVIARE
ME PATOGJENITET TË LARTË TË
SHPENDËVE TË SHFAQUR NË
SHTETIN E REPUBLIKËS SË ÇEKISË**

Mbështetur në nenin 102, pika 4 e Kushtetutës, neni 43, i ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë, të:

- shpendëve të gjallë shtëpiakë;
- zogjve 24-orësh;
- shpendëve dekorativë;
- materialit biologjik të shpendëve;
- vezëve të shpendëve;
- mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht;
- nënprodukteve të shpendëve të patrajuara termikisht,

nga shteti i Çekisë, sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	Ndarja administrative e nivelit 1	* Ndarja administrative e nivelit 2	Ndarja administrative e nivelit 3
	Středočeský	Příbram*	

Shënime. Simboli () nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.*

2. Certifikata veterinarë të garantojë origjinën e ngarkesës së ardhur.

3. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit dhe Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve për çdo ngarkesë të shpendëve të gjallë shtëpiakë,



zogjve 24-orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht dhe nënprodukteve të shpendëve të patrajuara termikisht, që vijnë nga vendet e sipërcituara në pikën 1.

4. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Drejtoria e Politikave Veterinare, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSMINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
Arian Jaupllari

VENDIM
Nr. 56, datë 16.7.2024

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë,
e përbërë nga:

Holta Zaçaj	kryetare;
Marsida Xhaferllari	anëtare;
Fiona Papajorgji	anëtare;
Elsa Toska	anëtare;
Sonila Bejtja	anëtare;
Ilir Toska	anëtar;
Genti Ibrahim	anëtar;
Marjana Semini	anëtare;
Sandër Beci	anëtar,

me sekretare Enina Kotoni, në datat 16.5.2024 dhe 28.5.2024, mori në shqyrtim në seancë plenare publike çështjen nr. 27 (Sh) 2023 të Regjistrit Themeltar, që u përket:

KËRKUESE: Shoqata e Prodhuesve dhe Tregtuesve të Pijeve Alkoolike Vendase, përfaqësuar nga drejtori ekzekutiv, avokat Sajmir Laçej.

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Mimoza Arbi dhe Aurela Biçja, me autorizim.

Këshilli i Ministrave, përfaqësuar nga Herald Jonuzaj dhe Nikolla Lera, si dhe avokatja e shtetit Irma Qosja, me autorizim.

Faqe | 19814

OBJEKTI: Shfuqizimi i pjesshëm i ligjit nr. 81/2022, “Për një ndryshim në ligjin nr. 61/2012, ‘Për akcizat në Republikën e Shqipërisë’”, për “Kategoria B000, kodin NK 22 03, produkti ‘Birra nga malto me shkallë alkoolometrike ndaj volumit më të madh se 0.5%’, në tabelën II” dhe i ligjit nr. 94/2023, “Për disa ndryshime në ligjin nr. 61/2012, ‘Për akcizat në Republikën e Shqipërisë’, të ndryshuar” për “Kategoria B000, kodin NK 22 03, produkti ‘Birra nga malto me shkallë alkoolometrike ndaj volumit më të madh se 0.5%’, në tabelën II”, si të papajtueshme me nenet 11, 41 dhe 17, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, me nenin 70 të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, direktivën nr. 92/83/KE dhe direktivën nr. 92/84/KE.

Pezullimi i ekzekutimit të ligjeve nr. 81/2022 dhe nr. 94/2023 deri në kohën kur vendimi fillon efektet.

BAZA LIGJORE: Nenet 11, 17 dhe 41 të Kushtetutës; neni 70 i Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (MSA); neni 1, i Protokollit nr. 1, të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ); direktivat e Komisionit Evropian nr. 92/83/KE dhe nr. 92/84/KE; ligji nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (ligji nr. 8577/2000).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Sandër Beci, mori në shqyrtim pretendimet e kërkuases, Shoqatës së Prodhuesve dhe Tregtuesve të Pijeve Alkoolike Vendase, e cila ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet e subjekteve të interesuara, Kuvendit të Republikës së Shqipërisë (Kuvendi) dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë (Këshilli i Ministrave), që kanë kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I Rrethanat e çështjes

1. Në datën 24.5.2012, Kuvendi, me propozimin e Këshillit të Ministrave, ka miratuar ligjin nr. 61/2012, “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë”



(ligji nr. 61/2012), i cili ka përcaktuar rregullat e përgjithshme për prodhimin, mbajtjen, magazinimin, lëvizjen dhe kontrollet për produktet që u nënshtrohen detyrimeve të akcizës, si dhe rregullat e veçanta në lidhje me akcizën që zbatohet për konsumin e produkteve energjetike, alkoolin dhe pijet alkoolike, duhanin dhe nënproduktet e tij. Sipas nenit 18 të këtij ligji, akciza llogaritet bazuar në njësitë matëse, sipas seksioneve respektive dhe sipas shtojcës nr. 1 të këtij ligji. Produktet e tregtuara pajisen me pullë akcize (pika 16, e nenit 2). Në shtojcën nr. 1, ndër të tjera, parashikohet se vlera e taksimit të birrës nga malto me shkallë alkoolometrike ndaj volumit më të madh se 0.5% (*produkti i birrës*) është: për prodhuesit vendas e të huaj, ligjërish dhe ekonomikisht të pavarur, me sasi më të vogël se 200.000 HL në vit – 360 lekë/HL/shkallë alkoolometrike dhe për prodhuesit vendas e të huaj, ligjërish dhe ekonomikisht të pavarur, me sasi më të madhe se 200.000 HL në vit – 710 lekë/HL/shkallë alkoolometrike. Ligji nr. 61/2012 iu është nënshtruar ndryshimeve në vitet 2012, 2013, 2014, 2015, 2016, 2017, 2018 dhe 2021.

2. Në vijim të këtyre ndryshimeve, në datën 24.11.2022, Kuvendi ka miratuar ligjin nr. 81/2022, “Për një ndryshim në ligjin nr. 61/2012, ‘Për akcizat në Republikën e Shqipërisë’, të ndryshuar” (ligji nr. 81/2022). Ky ligj është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 170, datë 20.12.2022 dhe ka hyrë në fuqi në datën 4.1.2023, ndërkohë që sipas nenit 2 ai i shtrin efektet nga data 1.1.2023. Ky ligj ka zëvendësuar shtojcën nr. 1, “Mallrat e tatueshme me akcizë në Republikën e Shqipërisë”, që i bashkëlidhet ligjit nr. 61/2012, duke ndryshuar, ndër të tjera, shkallën e taksimit dhe duke përcaktuar për produktin e birrës vlerën 710 lekë/HL/shkallë alkoolometrike.

3. Kërkuesja, në datën 22.9.2023, i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me kërkesë për shfuqizimin pjesërisht të ligjit nr. 81/2022, shtojcës nr. 1 të tij, përkatësisht në pjesën që parashikon: “*Kategoria B000, kodi NK 22 03, produkti Birra nga malto me shkallë alkoolometrike ndaj volumit më të madh se 0.5%, në tabelën IP*”, si të papajtueshëm me Kushtetutën, si dhe pezullimin e zbatimit të tij sipas objektit të kërkesës. Kërkesa, pasi është plotësuar sipas parashikimeve të ligjit nr. 8577/2000, është regjistruar në datën 5.10.2023. Në datën 5.12.2023, Kolegji i Gjykatës, bazuar në nenin 21, pika 1, të ligjit nr. 8577/2000, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare publike.

4. Në datën 7.12.2023, Kuvendi ka miratuar ligjin nr. 94/2023, “Për disa ndryshime në ligjin nr. 61/2012, ‘Për akcizat në Republikën e Shqipërisë’, të ndryshuar” (ligji nr. 94/2023), i cili është publikuar në Fletoren Zyrtare nr. 187, datë 22.12.2023 dhe sipas nenit 3 ai i shtrin efektet nga data 1.1.2024. Nëpërmjet këtij ligji është ndryshuar sërish shtojca nr. 1, “Mallrat e tatueshme me akcizë në Republikën e Shqipërisë”, që i bashkëlidhet ligjit nr. 61/2012, duke përcaktuar, ndër të tjera, se shkalla e taksimit për produktin e birrës është në vlerën 744.4 lekë/HL/shkallë alkoolometrike. Ky ligj ka ndryshuar edhe nenin 18, të ligjit nr. 61/2012, për sa i përket mënyrës së llogaritjes së akcizës, duke parashikuar se akciza e llogaritur sipas pikës 2 të këtij neni indekssohet çdo dy vjet në masën e normës zyrtare të inflacionit të shpallur nga INSTAT-i, por jo më shumë se 1.5%, me përjashtim të duhanit dhe nënprodukteve të tij, për të cilat akciza do të aplikohet sipas kalendarit të përcaktuar në shtojcën nr.1 që i bashkëlidhet ligjit. Indeksi i akcizës, sipas paragrafit të parë të kësaj pike, është shuma e normës së shpallur të inflacionit të vitit të dytë paraardhës plus normën e shpallur të inflacionit që rezulton deri në fund të 9-mujorit të vitit paraardhës, por jo më shumë se 1.5%.

5. Në datën 19.1.2024, kërkuesja ka paraqitur kërkesë për shtimin e objektit të kërkesës, duke kërkuar shfuqizimin e pjesës së ligjit nr. 94/2023. Mbledhja e Gjyqtarëve në datën 12.4.2024, bazuar në nenin 43/b, pika 2, të ligjit nr. 8577/2000, ka vendosur pranimin e kërkesës duke shtuar objektin e kërkesës. Në lidhje me afatin e publikimit të vendimit përfundimtar të arsyetuar, të përcaktuar në nenin 26, pika 2, të ligjit nr. 8577/2000, bazuar në nenin 15, pika 2, të Rregullores për Procedurat Gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese në këtë afat nuk llogaritet periudha e lejes vjetore, e parashikuar në nenin 18, pika 1, shkronja “b”, të po këtij ligji.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

6. **Kërkuesja**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar si vijon:

6.1 Për juridiksionin e Gjykatës:

Kërkesa është paraqitur ndërkohë që ishte ende në fuqi ligji nr. 81/2022, për rrjedhojë kërkuesja nuk mund të parashikonte ndryshimet në paketën fiskale që ligjvënësi do të aplikonte në vitin 2024. Ndonëse



ligji nr. 81/2022 ka përfunduar efektet e tij me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 94/2023, shkaku ligjor i kërkesës dhe argumentet e kërkujes shtrihen edhe për këtë të fundit.

6.2 Për kërkesën për pezullim:

Ligji nr. 81/2022 i ka filluar efektet prej datës 1.1.2023 dhe efektet negative të tij janë reflektuar në veprimtarinë e grupeve që përfaqëson kërkuësja, veçanërisht gjatë kohës së sezonit turistik. Duke marrë në konsideratë natyrën tregtare të veprimtarisë së subjekteve dhe karakterin dinamik të veprimit të këtyre subjekteve, pezullimi do të ndikonte pozitivisht në pakësimin e dëmit ekonomik që do t'u shkactohej atyre. Prodhuesit vendas i importojnë lëndët e para, në dallim nga prodhuesit e huaj, të cilët përfitojnë nga marrëveshje favorizuese për blerjen e tyre 20–30% më lirë. Klasifikimi i akcizës ishte mënyra e mbrojtjes së prodhuesve vendas, pasi në kushtet e rritjes së çmimeve të lëndëve të para, energjisë dhe rënies së konsumit, ligji i ndryshuar do të sjellë pasoja për ekonominë, punësimin dhe do të sjellë falimentimin. Nga të dhënat rezulton se pesha në përqindje e prodhimit vendas ndaj importit ka rënë ndjeshëm. Duke qenë se ligji nr. 94/2023 prodhon të njëjtat efekte si ligji nr. 81/2022, ai duhet të pezullohet deri në marrjen e vendimit nga Gjykata.

6.3 Për legjitimitimin e kërkujes:

Kërkuësja është person juridik, me objekt dhe qëllim ndërmarrjen e veprimeve për mbrojtjen e interesave legjitimë të anëtarëve të shoqatës, prodhues të birrës vendase, të cilët preken drejtpërdrejt nga shkalla e re e taksimit për produktin birrë. Ndonëse është krijuar pas miratimit të ligjit nr. 81/2022, ky nuk përbën kusht për legjitimitimin, për sa kohë ajo provon interesin që ekziston midis veprimtarisë që kryen dhe çështjes kushtetuese të ngritur. Pavarësisht se subjektet e interesuara kanë pretenduar se anëtarët e shoqatës janë biznese të mëdha dhe për rrjedhojë nuk bëjnë pjesë në përjashtimin e parashikuar nga direktiva evropiane, përkufizimi i “birrarisë së vogël” nuk përputhet me termin “biznes i vogël” të parashikuar nga legjislacioni tatimor shqiptar, pasi direktiva përdor si kriter mbrojtës vetëm sasinë e prodhimit deri në 200.000 HL në vit. Nga ana tjetër, terminologjia e legjislacionit tatimor lidhet me aplikimin e tatimit mbi fitimin dhe TVSH-në dhe jo me nivelin e akcizës në varësi të sasisë së prodhimit.

6.4 Për themelin e kërkesës:

A. Ligjet nr. 81/2022 dhe 94/2023 ka cenuar:

6.4.1 Lirinë e veprimtarisë ekonomike dhe parimin e proporcionalitetit të ndërhyrjes, të garantuara nga nenet 11 dhe 17 të Kushtetutës, pasi ndryshimi i akcizës i ngarkon kërkuësën një detyrim fiskal më të lartë se kuadri rregullator i Bashkimit Evropian (BE). Unifikimi i taksimit, pa marrë në konsideratë sasinë e prodhuar, mund të sjellë falimentimin e prodhuesve të vegjël vendas. Ligjvënësi nuk ka kryer asnjë analizë të efekteve të këtyre ndryshimeve ligjore, duke dëmtuar interesat ekonomikë të prodhuesve vendas që prodhojnë nën 200.000 HL birrë, si dhe nuk është konsultuar me grupet e interesit gjatë hartimit të projektligjit, përveç një seance formale. Megjithatë ndryshimi ligjor është justifikuar me përafrimin e legjislacionit të BE-së, nuk është argumentuar konkretisht cilës direktivë i referohet. Edhe argumenti se unifikimi bëhet me qëllim shmangien e evazionit potencial nuk qëndron, pasi procesi i prodhimit dhe importit të birrës monitorohet me sistem gjurmimi, duke mos u bazuar vetëm te vetëdeklarimi i subjekteve prodhuese. Efekti financiar i synuar nga ligjvënësi nuk ka asnjë peshë në të ardhurat doganore në krahasim me dëmet që do t'u shkattohen bizneseve që janë kredituar nga bankat për planet e tyre të biznesit. Aplikimi i akcizës ka barazuar çmimin e produktit të birrës vendase me atë të importit ose e ka tejkaluar atë, si dhe ka ulur prodhimin vendas me 11%. Disa fabrika kanë ndërprerë prodhimin duke e transferuar aktivitetin e tyre në kompani të tjera. Shqipëria aplikon akcizë deri 3 herë më të lartë se niveli minimal i rekomanduar nga direktiva evropiane.

6.4.2 Po për sa i përket lirisë ekonomike, diferencimi i akcizës nuk bazohet në prejardhjen e produkteve, por në sasinë e prodhuar dhe teknologjinë e përdorur, pra prapësimi se ky diferencim favorizonte vetëm prodhuesit vendas nuk është i vërtetë, pasi nga ai përfitonin edhe prodhuesit e huaj në varësi të sasisë së prodhuar. Përafrimi me legjislacionin e BE-së nuk është i mjaftueshëm për respektimin e parimit të proporcionalitetit, ndërkohë që qëllimi i diferencimit të akcizës është lehtësimi i barrës fiskale të tyre për shkak të kapaciteteve të limituara. Për sa u përket produkteve të tjera, ligjvënësi ka ndryshuar taksimin në mënyrë të përshtatshme për 5 vjet dhe jo me rritje 100% të menjëhershme siç ka vepruar për produktin e birrës. Rritja e nivelit të akcizës nuk do



të ulë nivelin e evazionit fiskal, përkundrazi do ta rrisë atë.

6.4.3 *Të drejtën e pronës*, të garantuar nga neni 41 i Kushtetutës dhe neni 1, i Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së, pasi unifikimi i taksimit konsiston në rritjen e barrës tatimore, e cila ka sjellë pakësimin e të ardhurave të subjekteve prodhuese. Kjo ndërhyrje nuk diktohej nga një interes publik dhe nuk është proporcionale, si dhe është realizuar pa një analizë kosto - përfitim për tatimpaguesit shqiptarë. Unifikimi i akcizës sjell si pasojë falimentimin dhe rënien e numrit të të punësuarve deri në 15%, si dhe ndërhyrjen tek të ardhurat e prodhuesve, duke cenuar të drejtën e pronës. Ky kufizim nuk respekton parashikimet e nenit 17 të Kushtetutës për sa i përket proporcionalitetit të ndërhyrjes dhe mjetet e përdorura nuk përputhen me qëllimin që kërkohet të arrihet.

6.4.4. *Parimin e sigurisë juridike*, pasi është miratuar një nivel taksimi i rritur në masën 100%, pa marrë në konsideratë efektin që do të shkaktojë në ekonomi dhe në mënyrë specifike në avantazhet konkurruese të produkteve të importit kundrejt atyre vendase, të cilat ky ndryshim i gjen të papërgatitura. Në të njëjtin ligj është parashikuar një sistem i skedulluar i rritjes së shkallës së taksimit rreth 5% në vit për produktet e duhanit të shtrirë në 5 vjet, ndërsa nuk është parashikuar unifikimi për produktin e verës, megjithëse konsiderohen industri të njëjta. Aplikimi i një niveli taksimi të rritur në masën 100% nuk mund të analizohet pa marrë në konsideratë efektin që do të shkaktojë në ekonomi dhe në mënyrë specifike për produktet vendase, prodhuesit e të cilave ky ndryshim i gjen të papërgatitur.

6.4.5 *Nenin 70 të MSA-së*, që parashikon detyrimin e shtetit për përafrimin e legjislacionit të brendshëm me *aquis* të BE-së, pasi unifikimi i taksimit vjen në kundërshtim me direktivat e KE-së nr. 92/84/KE dhe nr. 92/83/KE. Detyrimi për përafrim nuk lidhet vetëm me të drejtën e konsumatorit. Niveli i akcizës në Shqipëri është 3 herë më shumë se niveli i parashikuar në këto direktiva. Kryerja e ndryshimeve ligjore në kundërshtim me këto direktiva përbën shkelje të MSA-së. Parashikimet ligjore para ndryshimeve me ligjet objekt kundërshtimi ishin në përputhje me direktivat e BE-së dhe implementimi i këtyre direktivave përbën zbatim të drejtpërdrejtë të nenit 70 të MSA-së.

7. Subjekti i interesuar, Kuvendi, në mënyrë të përmblëdhur, ka prapësuar si vijon:

7.1 *Për juridiksionin e Gjykatës:*

Për sa i përket ligjit nr. 81/2022, kërkesa ka mbetur pa objekt, pasi ai është shfuqizuar me ligjin nr. 94/2023 dhe ka qenë pjesë e paketës fiskale që sillte efektin e saj në buxhetin e vitit 2023. Për rrjedhojë, me mbylljen e vitit fiskal kanë pushuar efektet e kësaj shtojce, ndaj Gjykata duhet të vendosë pushimin e gjykimit të çështjes.

7.2 *Për kërkesën për pezullim:*

Ligji nr. 81/2022 nuk sjell dëm të menjëhershëm, pasi deri në momentin e paraqitjes së kërkesës në Gjykatë kanë kaluar 10 muaj. Për më tepër, në datën 1.1.2024 ka filluar të zbatohet ligji nr. 94/2023. Kërkuesja nuk ka paraqitur argumente konkrete dhe reale në lidhje me pasojat e menjëhershme që do të duhet të parandalohen apo rrezikun për pasojat të mundshme që vijnë nga zbatimi i tij, të cilat prekin interesin e anëtarëve të saj. Për sa i përket ligjit nr. 94/2023, niveli i akcizës ka kohë që zbatohet, ndaj nuk mund të pretendohet se vjen një dëm i menjëhershëm. Për më tepër, pezullimi i ligjit në një vit tjetër buxhetor të zbatimit do të sillte dëm të interesit publik. Gjithashtu, duke qenë se pezullimi i ligjit nuk passjell ligjin e vjetër në fuqi, i cili është shfuqizuar, kjo do të sillte mangësi në buxhetin e shtetit.

7.3 *Për legjitimitimin e kërkuës:*

Ligji nr. 81/2022 është miratuar në datën 24.11.2022 dhe ka filluar efektet në datën 1.1.2023, ndërsa kërkuësja është krijuar me vendimin e datës 31.7.2023, të gjykatës së shkallës së parë, pra 8 muaj pasi ligji kishte filluar efektet. Nisur nga ky fakt kërkuësja nuk është cenuar nga ky ndryshim ligjor. Anëtarët e shoqatës nuk konsiderohen biznese të vogla sipas legjislacionit tatimor, për rrjedhojë ata nuk mund të pretendojnë se gëzojnë mbrojtje për tarifa të reduktuara, sipas përmbajtjes së direktivës evropiane. Pretendimi i kërkuësës se anëtarët e saj janë biznese të mëdha, por, nga ana tjetër, berrari të vogla, është jologjik dhe nuk përputhet me qëllimin e direktivës, e cila parashikon uljen e akcizës vetëm për berraritë e vogla tradicionale. Kërkuësja nuk legjitimohet as për pretendimin për mbrojtjen e bizneseve të huaja.

7.4 *Për themelin e kërkesës:*

7.4.1 Pretendimi për cenimin e *lirisë së veprimtarisë ekonomike dhe parimit të proporcionalitetit* nuk është i bazuar, pasi plotësohen kriteret e ndërhyrjes sipas



nenit 17 të Kushtetutës. Ligji plotëson kriteret formale si në aspektin procedural, ashtu edhe material dhe ekziston interesi publik në drejtim të konsolidimit të financave publike, rritjes së të ardhurave në buxhet, uljes së borxhit publik dhe shmangies së pagesës së akcizës. Ai plotëson edhe kriterin e proporcionalitetit midis mjetit dhe qëllimit që kërkohet të arrihet, që është përmirësimi i politikave në fushën e akcizave, shpërndarja e barrës fiskale dhe unifikimi i akcizës me vendet e rajonit. Shteti shqiptar ka detyrimin të mos bëjë dallime në taksim midis produkteve vendase dhe atyre të importuara, duke shmangur diskriminimin fiskal.

7.4.2 Po kështu, përjashtimi i pretenduar për aplikimin e tarifave të reduktuara nga kërkuesja nuk qëndron, pasi, *së pari*, ai është në diskrecion të shtetit dhe nuk përbën detyrim për të dhe, *së dyti*, në Shqipëri nuk ka pasur fabrika të vogla të prodhimit të birrës, të cilat të prodhonin në mënyrë artizanale këtë produkt. Edhe dy nga anëtarët e kërkueses nuk janë ndërmarrje të vogla që të pretendojnë mbrojtje të veçantë, por fabrika të lidhura me njëra-tjetrën, pra jo të pavarura. Diferencimi i akcizës ka krijuar hapësira për shmangien nga detyrimet dhe ka bërë që prodhuesit vendas të mos tentojnë të rrisin prodhimin me qëllim ruajtjen e nivelit të ulët të akcizës. Ky diferencim ka qenë zgjedhje e ligjvënësit dhe jo i bazuar në direktivat e BE-së. Pavarësisht se anëtarët e kërkueses kanë vepruar në treg edhe përpara se ligji të parashikonte diferencimin e nivelit të akcizës në vitin 2007, gjatë një periudhe 15-vjeçare ato nuk u fuqizuan, duke mos e kaluar kufirin prej 200.000 HL të prodhimit të birrës.

7.4.3 Për më tepër, ky pretendim i kërkueses nuk ka natyrë kushtetuese, pasi Gjykata nuk mund të bëjë një vlerësim “politik” në kuptimin që të hartojë politika ekonomike ose të gjejë zgjidhjen më të përshtatshme ekonomike. Edhe pretendimi për mospërmblidhjen e objektivave sociale të shtetit nuk mund të shqyrtohet nga kjo Gjykatë. Po kështu, referimi në vendimin nr. 33/2016 të Gjykatës është i gabuar, pasi kjo e fundit nuk ka shfuqizuar asnjëherë detyrime tatimore ose doganore si joproporcionale, por ka marrë në shqyrtim vetëm sanksionet administrative. Pretendimi se për ndryshimet ligjore nuk është kryer ndonjë studim paraprak dhe nuk ka referenca në direktivat e BE-së në relacionin shoqërues nuk është i bazuar, pasi ky i fundit nuk mund të përdoret për të interpretuar dispozitën. Gjithashtu, pretendimi se ndryshimet

ligjore kanë sjellë impakt negativ duke ulur praninë e prodhuesve vendas në treg nuk qëndron, pasi ata janë përballur prej vitesh me vështirësi ekonomike.

7.4.4 Në lidhje me pretendimin për cenimin e *së drejtës së pronës private* kërkuesja ka sjellë argumentet teorike, por nuk ka referuar në mënyrë konkrete se në cilat raste është cenuar kjo e drejtë. Në lidhje me fushën e taksave dhe tatimeve shteti ka një diskrecion të gjerë për të vlerësuar llojin dhe masën e tyre. Nisur nga fakti se birra nuk është mall konsumi i zakonshëm dhe se në Shqipëri nuk ka birrari të vogla tradicionale, përcaktimi i këtij detyrimi financiar është në përputhje me kërkesat kushtetuese.

7.4.5 Edhe pretendimi për cenimin e *parimit të sigurisë juridike* është i pabazuar, pasi ndryshimet ligjore kanë të bëjnë me përmblidhjen e detyrimeve ndërkombëtare të Shqipërisë, mirëfunksionimin e buxhetit të shtetit, konsolidimin financiar, përmirësimin e politikave në fushën e akcizave dhe ky parim nuk mund të prevalojë në çdo rast.

7.4.6 Për sa i përket pretendimit për cenimin e *nenit 70 të MSA-së*, nuk rezulton ndonjë detyrim specifik që të jetë shkelur nga miratimi i ndryshimeve ligjore të kundërshtuara. Për më tepër, kërkuesja nuk legjitimohet për pretendimet e saj në lidhje me direktivat e BE-së, pasi jo vetëm që nuk përbëjnë të drejtë ndërkombëtare detyruese për shtetin shqiptar, por ato lënë në diskrecion të shtetit të vendosë nëse do të miratojë ulje të akcizës për birrën.

8. Subjekti i interesuar, Këshilli i Ministrave, në mënyrë të përmblidhur, ka përpësuar si vijon:

8.1 Për kërkesën për pezullim:

Kërkesa për pezullim nuk qëndron, pasi ligji nr. 81/2022 nuk krijon hapësira që mund të sjellin dëm të interesit publik. Kërkuesja nuk ka paraqitur argumente konkrete dhe reale në lidhje me kriterin e menjëhershëm, pra parandalimin e rrezikut për pasoja të mundshme që vijnë nga zbatimi i ligjit të cilat prekin interesin e saj.

8.2 Për legjitimitetin e kërkueses:

Kërkuesja nuk legjitimohet, pasi anëtarët e shoqatës nuk gëzojnë cilësitë e përcaktuara në direktivën evropiane, pra nuk konsiderohen “birrari të vogla të pavarura” dhe veprojnë të pajisur me licencë nga Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB), pasi tregtojnë me shumicë. Ajo ka pretenduar se parashikimet ligjore dëmtojnë interesin e anëtarëve të saj, operatorëve të cilët synojnë të hyjnë në treg



dhe nuk legjitimohet as për sa i përket pretendimit për cenimin e bizneseve të huaja.

8.3 Për themelin e kërkesës:

8.3.1 Pretendimi për cenimin e *lirisë së veprimtarisë ekonomike* nuk është i bazuar, pasi ligji ka respektuar kriteret e kufizimit të nenit 17 të Kushtetutës. Më konkretisht, ligji plotëson kriteret formale dhe materiale, si dhe ekziston interesi publik, pasi ligji ka për qëllim konsolidimin e financave publike, rritjen e të ardhurave në buxhet, uljen graduale të borxhit publik, si dhe reduktimin e hapësirave për shmangien nga pagesa e akcizës. Në rastin konkret ballafaqohen interesat e prodhuesve vendas për të ushtruar lirinë e veprimtarisë ekonomike me interesat e shtetit për marrjen e masave konkrete për përmirësimin e politikave në fushën e akcizave. Kërkesja nuk është ngarkuar me një barrë të tepruar. Po kështu, ndryshimi ligjor ka ardhur si angazhim për përmbushjen e rekomandimeve të Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN) për rritjen e përqindjes së të ardhurave dhe përafrimin e legjislacionit vendas me atë të BE-së. Për shkak të natyrës teknike të legjislacionit tatimor diskrecioni i ligjvënësit është i domosdoshëm.

8.3.2 Pretendimi për cenimin e *së drejtës së pronës* nuk qëndron, pasi qëllimi i ligjit lidhet me përmirësimin e politikave në fushën e akcizave, duke lejuar industrinë e prodhimit të jetë konkurruese me produktet e importuara. Kërkesja nuk ka paraqitur asnjë argument konkret se mbi çfarë baze janë shkelur interesat dhe e drejta e pronësisë së subjekteve që mbrohen prej saj, por është përqendruar vetëm në aspektin teorik.

8.3.3 Për sa i përket pretendimit për cenimin e *parimit të sigurisë juridike*, arsyet që kanë të bëjnë me mirëfunksionimin e buxhetit të shtetit dhe konsolidimin financiar e imponojnë këtë masë, e cila lidhet me përmirësimin e politikave në fushën e akcizave, shpërndarjen më të drejtë të barrës fiskale, duke lejuar industrinë e prodhimit në vend të mallrave të akcizës që të jetë konkurruese me produktet e importuara dhe duke përmirësuar transparencën e parandaluar evazionin fiskal për dekurajimin e importeve ilegale me mallrat e akcizës.

8.3.4 Në lidhje me pretendimin për cenimin e *nenit 70 të MSA-së*, pretendimet e kërkuarës janë të pabazuara, pasi shteti shqiptar nuk ka ndërmarrë asnjë detyrim specifik në këtë marrëveshje ndërkombëtare, i cili të jetë shkelur nga miratimi i ndryshimeve ligjore të kundërshtuara. Megjithatë,

nisur nga fakti se direktivat nuk janë pjesë e rendit juridik shqiptar, ky pretendim nuk bën pjesë në juridiksionin kushtetues.

III

Procesi në gjykimin kushtetues

A. Për kërkesën për pezullim

9. Gjykata vëren se kërkuarja i është drejtuar me kërkesën e datës 5.10.2023, për shfuqizimin si të papajtueshëm të ligjit nr. 81/2022, duke kërkuar edhe pezullimin e zbatimit të tabelës II të shtojcës nr. 1 të tij, në pjesën që parashikon: “*Kategoria B000, kodi NK 22 03, produkti Birra nga malto me shkallë alkoolometrike ndaj volumit më të madh se 0.5%*”, me pretendimin se cenon në mënyrë të drejtpërdrejtë interesat e subjekteve që kërkuarja përfaqëson në gjykimin kushtetues. Sipas saj, ky ligj i ka filluar efektet prej datës 1.1.2023 dhe efektet negative të tij janë reflektuar në veprimtarinë e anëtarëve të saj, veçanërisht gjatë kohës së sezonit turistik. Megjithatë ligji i ka filluar efektet, duke marrë në konsideratë natyrën tregtare të veprimtarisë së subjekteve dhe karakterin dinamik të veprimit të tyre, pezullimi i tij do të ndikonte pozitivisht në pakësimin e dëmit ekonomik që do t’u shkaktonte atyre. Po kështu, sipas saj, prodhuesit vendas i importojnë lëndët e para, në dallim nga prodhuesit e huaj të cilët përfitojnë nga marrëveshje favorizuese për blerjen e tyre 20–30% më lirë. Kërkuarja ka pretenduar edhe se klasifikimi i akcizës ishte mënyra e mbrojtjes së prodhuesve vendas, pasi në kushtet e rritjes së çmimeve të lëndëve të para, energjisë dhe rënies së konsumit, ligji i ndryshuar do të sjellë pasoja për ekonominë, punësimin dhe do të sjellë falimentimin. Gjithashtu, sipas kërkuarës, nga të dhënat rezulton se pesha në përqindje e prodhimit vendas ndaj importit ka rënë ndjeshëm.

10. Në vijim, kërkuarja, pas miratimit të ligjit nr. 94/2023, i është drejtuar Gjykatës me kërkesë për shtesën e objektit të kërkesës, duke kërkuar si shfuqizimin e shtojcës nr. 1 të tij, në pjesën që parashikon: “*Kategoria B000, kodi NK 22 03, produkti Birra nga malto me shkallë alkoolometrike ndaj volumit më të madh se 0.5%*” të këtij ligji, ashtu edhe pezullimin e këtyre parashikimeve, për të njëjtat shkaqe për të cilat kishte kërkuar pezullimin e parashikimeve të ligjit nr. 81/2022.

11. Subjekti i interesuar, Kuvendi, për sa u përket pretendimeve për pezullimin e ligjit nr. 81/2022, ka



prapësuar se që nga momenti i fillimit të efekteve dhe deri në paraqitjen e kërkesës në Gjykatë kanë kaluar 10 muaj, ndaj nuk është provuar se ai ka sjellë dëm të menjëhershëm dhe, për më tepër, në datën 1.1.2024, ka filluar të zbatohet ligji nr. 94/2023. Sipas Kuvendit, kërkesja nuk ka paraqitur argumente konkrete dhe reale në lidhje me pasojat e menjëhershme që do të duhet të parandalohen apo rrezikun për pasoja të mundshme që vijnë nga zbatimi i tij, të cilat prekin interesin e kërkuës. Po kështu, edhe për sa i përket kërimit për pezullimin e ligjit nr. 94/2023, subjekti i interesuar ka prapësuar se ky ligj ka kohë që zbatohet, ndaj nuk mund të pretendohet se vjen një dëm i menjëhershëm nga niveli i akcizës dhe, për më tepër, pezullimi i ligjit në një vit tjetër buxhetor të zbatimit do të sillte cenim të interesit publik. Po sipas tij, duke qenë se pezullimi i ligjit nuk passjell ligjin e vjetër në fuqi, i cili është shfuqizuar, kjo do të sillte mungesa në buxhetin e shtetit.

12. Subjekti i interesuar, Këshilli i Ministrave, ka prapësuar se ligji nr. 81/2022 nuk krijon hapësira që mund t'i sjellin dëm interesit publik dhe se kërkesja nuk ka paraqitur argumente konkrete dhe reale në lidhje me kriterin e menjëhershëm, pra parandalimin e rrezikut për pasoja të mundshme që vijnë nga zbatimi i ligjit të cilat prekin interesin e saj.

13. Për sa i përket kërkesës për pezullimin e zbatimit të ligjit nr. 81/2022, në datën 19.12.2023, Mbledhja e Gjyqtarëve ka vendosur shqyrtimin e saj në seancë plenare publike, pas dëgjimit të palëve. Në seancën plenare të datës 16.5.2024 kërkesja, mbi të njëjtat argumente të parashtruara në kërkesë, ka kërkuar edhe pezullimin e ligjit nr. 94/2023.

14. Sipas nenit 45, pika 1, të ligjit nr. 8577/2000, Gjykata, kryesisht ose me kërkesë të palës, kur vlerëson se zbatimi i ligjit ose i aktit mund të sjellë pasoja që prekin interesa shtetërorë, shoqërorë ose të individëve, sipas rastit, me vendim të Mbledhjes së Gjyqtarëve ose në seancë plenare urdhëron pezullimin e ligjit ose të aktit. Pezullimi vazhdon derisa vendimi përfundimtar i Gjykatës hyn në fuqi. Në kushtet kur pezullimi është një masë e jashtëzakonshme, vendosja e tij lidhet me vlerësimin e pasojave ose efekteve të zbatimit të aktit. Këto pasoja jo vetëm duhet të jenë reale, pra në realizim e sipër, por edhe të rënda, në atë masë që shkojnë tej masës normale të kufizimit, në veçanti në pikëpamje të urgjencës.

15. Gjykata vëren, fillimisht, se ligji nr. 81/2022 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 170, datë 20.12.2022, ka hyrë në fuqi në datën 4.1.2023 dhe sipas nenit 2 i shtrin efektet nga data 1.1.2023. Ndërsa ligji nr. 94/2023, është publikuar në Fletoren Zyrtare nr. 187, datë 22.12.2023 dhe sipas nenit 3, i shtrin efektet nga data 1.1.2024. Gjykata, në seancën plenare të datës 16.5.2024, pasi mori në shqyrtim pretendimet e kërkuës për pezullimin e dispozitave ligjore të këtyre ligjeve, si dhe dëgjoi prapësimet e subjekteve të interesuara, vlerësoi se në kuptim të nenit 45, pika 1, të ligjit nr. 8577/2000, kërkesja nuk ka paraqitur argumente bindëse për të provuar ardhjen e pasojave të rënda ose të pariparueshme nga zbatimi i tyre. Për rrjedhojë, Gjykata vendosi rrëzimin e kërkesës për pezullim si të pabazuar.

IV

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

B. Për juridiksionin e Gjykatës

16. Gjykata vëren se kërkesja ka kundërshtuar ligjet nr. 81/2022 dhe nr. 94/2023, të cilat i kanë shtrirë efektet përkatësisht nga datat 1.1.2023 dhe 1.1.2024.

17. Kërkesja ka pretenduar se kërkesa është paraqitur ndërkohë që ishte ende në fuqi ligji nr. 81/2022, për rrjedhojë ajo nuk mund të parashikonte ndryshimet në paketën fiskale që ligjvënësi do të aplikonte në vitin 2024. Sipas saj, ndonëse ligji nr. 81/2022, ka përfunduar efektet e tij me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 94/2023, shkaku ligjor i kërkesës dhe argumentet e kërkuës shtrihen edhe për këtë të fundit.

18. Subjekti i interesuar, Kuvendi, ka prapësuar se për sa i përket ligjit nr. 81/2022, kërkesa ka mbetur pa objekt, pasi ai është shfuqizuar me ligjin nr. 94/2023, i cili ka ndryshuar shtojcën nr. 1 dhe ka qenë pjesë e paketës fiskale që sillte efektin e saj në buxhetin e vitit 2023. Për rrjedhojë, sipas Kuvendit, me mbylljen e vitit fiskal kanë pushuar efektet e shtojcës së miratuar me ligjin nr. 81/2022, ndaj Gjykata duhet të vendosë pushimin e gjykimit të çështjes. Ndërsa subjekti tjetër i interesuar, Këshilli i Ministrave, nuk ka paraqitur prapësime në lidhje me juridiksionin e Gjykatës për shqyrtimin e kësaj çështjeje.

19. Gjykata konstaton se ligji nr. 94/2023, ka për objekt të tij disa ndryshime në ligjin nr. 61/2012,



duke ndryshuar, ndër të tjera, shtojcën nr. 1 të këtij të fundit, sipas përmbajtjes së saj të ndryshuar me ligjin nr. 81/2022, pra duke ndryshuar akcizën e produktit të birrës nga vlera 710 lekë/HL për shkallë alkoolometrike në 744.4 lekë/HL për shkallë alkoolometrike, pavarësisht sasisë së prodhimit të produktit të birrës. Për rrjedhojë, për sa kohë që ligji nr. 81/2022 nuk është më pjesë e rendit juridik, Gjykata vlerëson të ndalet, fillimisht, në fuqinë juridike të këtij ligji, element ky që lidhet me juridiksionin e vetë Gjykatës dhe kufijtë e shqyrtimit të kësaj çështjeje.

20. Sipas pikës 2, të nenit 51, të ligjit nr. 8577/2000, kur një ligj ose akt normativ, ose pjesë të tij, është objekt shqyrtimi para Gjykatës, shfuqizohen ose ndryshohen para se ajo të marrë vendim, gjykimi pushohet, me përjashtim të rasteve kur ajo çmon se gjykimi duhet të vazhdojë për shkak të një interesi publik ose shtetëror. Lidhur me kontrollin kushtetues të akteve të shfuqizuara, Gjykata në jurisprudencën e saj ka pohuar se, si rregull, normat juridike i nënshtrohen kontrollit kushtetues nëse janë në fuqi në kohën e kontrollit ose, e thënë ndryshe, nëse janë akte të vlefshme që prodhojnë pasoja juridike. Përjashtimisht, kontrollit kushtetues i nënshtrohen edhe normat juridike të shfuqizuara, kur këto, si pjesë e së drejtës pozitive, duhet të zbatohen për rregullimin e pasojave juridike që zgjasin në kohë dhe janë të lidhura me ekzekutimin periodik ose me afat të detyrimeve juridike civile që rrjedhin nga marrëdhënie juridike të krijuara në kohën e ligjit të shfuqizuar (*shih vendimet nr. 8, datë 7.2.2017; nr. 2, datë 31.1.2003, të Gjykatës Kushtetuese*).

21. Gjykata vëren se ndonëse ligji nr. 81/2022, nuk është më në fuqi, ai ka sjellë pasoja të drejtpërdrejta për anëtarët e kërkuës në drejtim të shkallës së akcizës që ato duhet të paguajnë për produktin e birrës. Ndërsa vlera e akcizës së këtij produkti përpara ndryshimeve të vitit 2022 ka qenë e diferencuar në varësi të prodhimit vjetor të produktit të birrës përkatësisht: nën 200.000 HL në vit – 360 lekë/HL dhe mbi 200.000 HL në vit – 710 lekë/HL, me ligjin nr. 81/2022 ky diferencim u shfuqizua, duke bërë që ai të unifikohet në 710 lekë/HL. Edhe pse efektet e këtij ligji janë shtrirë përgjatë periudhës 1.1.2023 – 1.1.2024, datë pas së cilës ka shtrirë efektet ligji nr. 94/2023, që ka përcaktuar akcizën për produktin e birrës në vlerën 744.4 lekë/HL, Gjykata konstaton se është pikërisht

ligji nr. 81/2022 që ka përcaktuar masën e akcizës, duke vendosur për herë të parë unifikimin e saj pavarësisht sasisë së prodhimit, rrjedhimisht është ligji që ka sjellë pasoja të drejtpërdrejta për anëtarët e shoqatës kërkuëse. Kurse ligji nr. 94/2023 nuk ka sjellë ndryshim në këtë parashikim të ligjit nr. 61/2012, sipas ndryshimit të bërë me ligjin nr. 81/2022, por vetëm për sa i përket indeksimit të akcizës nga 710 lekë/HL në 744.4 lekë/HL.

22. Për sa më lart, në ndryshim nga sa pretendon subjekti i interesuar, Kuvendi, Gjykata çmon se ajo ka juridiksion për të shqyrtuar edhe pajtueshmërinë me Kushtetutën të ligjit nr. 81/2022, ndaj ajo do të trajtojë, në vijim, pretendimet e kërkuës për të dyja ligjet objekt kërkesë.

23. Kërkuësja ka pretenduar edhe se ndryshimet ligjore të kundërshtuara bien ndesh me nenin 70 të MSA-së, që parashikon detyrimin e shtetit për përafrimin e legjislacionit të brendshëm me *aquis* të BE-së, pasi unifikimi i taksimit është në kundërshtim me direktivat e Komisionit Evropian (KE) nr. 92/84/KE dhe nr. 92/83/KE, për sa kohë që niveli i akcizës në Shqipëri është 3 herë më shumë se niveli i parashikuar në këto direktiva.

24. Për sa u përket pretendimeve të kërkuës në drejtim të pajtueshmërisë së ndryshimeve ligjore të kundërshtuara me direktivat e BE-së që parashikojnë se shtetet mund të aplikojnë tarifa të reduktuara të akcizës në varësi të prodhimit vjetor të produkteve alkoolike, duke përcaktuar një kufi prej 200.000 HL në vit, ato nuk mund të bëhen objekt i kontrollit kushtetues, për sa kohë këto akte ligjore nuk janë pjesë e rendit juridik shqiptar, në kushtet kur Republika e Shqipërisë nuk i ka përmblyllur ende procedurat për integrimin në BE. Për rrjedhojë, Gjykata, duke respektuar kufijtë e juridiksionit të saj, të përcaktuara në nenin 131, pika 1, shkronja “a”, të Kushtetutës, do të vlerësojë përputhshmërinë e ndryshimeve ligjore të kundërshtuara me Kushtetutën dhe me MSA-në.

C. Për legjitimitimin e kërkuës

25. Kërkuësja ka pretenduar se legjitimohet, pasi është një person juridik i regjistruar me vendim gjyqësor, që ka për objekt dhe qëllim të veprimtarisë ndërmarrjen e veprimeve për mbrojtjen e interesave legjitimë të anëtarëve të saj, prodhues të birrës vendase, që preken drejtpërdrejt nga shkalla e re e taksimit për produktin birrë. Sipas kërkuës, ndonëse është krijuar si subjekt juridik pas miratimit të ligjit nr. 81/2022, ky fakt nuk përbën kusht për



legjitimimin, për sa kohë ajo provon interesin që ekziston midis veprimtarisë që kryen dhe çështjes kushtetuese të ngritur. Sipas saj, ndonëse subjektet e interesuara kanë pretenduar se anëtarët e shoqatës janë biznese të mëdha, terminologjia e legjislacionit tatimor lidhet me aplikimin e tatimit mbi fitimin dhe TVSH-në dhe jo me nivelin e akcizës në varësi të sasisë së prodhimit.

26. Subjekti i interesuar, Kuvendi, ka prapësuar se kërkesja nuk legjitimohet, pasi është krijuar me vendimin e datës 31.7.2023, pra 8 muaj pasi ligji nr. 81/2022 kishte filluar të jepte efekte, duke mos u cenuar nga ky ndryshim ligjor. Sipas Kuvendit, anëtarët e kërkeses nuk konsiderohen biznese të vogla sipas legjislacionit tatimor, për rrjedhojë ata nuk mund të pretendojnë se gëzojnë mbrojtje për tarifa të reduktuara. Sipas këtij subjekti, pretendimi i kërkeses se anëtarët e saj janë biznese të mëdha, por, nga ana tjetër, berrari të vogla, është jologjik. Ajo nuk legjitimohet as për pretendimin për mbrojtjen e bizneseve të huaja.

27. Sipas subjektit të interesuar, Këshillit të Ministrave, anëtarët e kërkeses nuk konsiderohen “berrari të vogla të pavarura” dhe ata operojnë me licencë të pajisur nga QKB-ja, pasi tregtojnë me shumicë. Sipas tij, kërkesja ka pretenduar se parashikimet ligjore dëmtojnë interesin e anëtarësisë së saj, operatorët që synojnë të hyjnë në treg. Po sipas këtij subjekti, kërkesja nuk legjitimohet as për sa i përket pretendimit për cenimin e bizneseve të huaja.

28. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) është vlerësuar si një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen një procesi kushtetues. Kushtetuta në nenin 134, pika 1, të saj ka përcaktuar në mënyrë shteruese rrethin e subjekteve kushtetuese që legjitimohen të vënë në lëvizje juridiksionin kushtetues. Për sa i përket legjitimitetit të shoqatave, si subjekte që vënë në lëvizje Gjykatën, sipas nenit 134, pika 1, shkronja “h”, të Kushtetutës, Gjykata ka tashmë një jurisprudencë të konsoliduar, e cila ka pranuar se shoqatat janë një ndër subjektet që e ushtrojnë në mënyrë të kushtëzuar të drejtën për t’iu drejtuar Gjykatës, duke pasur legjitimitet kushtetues vetëm për çështjet që lidhen me interesat e tyre (*shih vendimet nr. 4, datë 15.2.2021; nr. 16, datë 1.3.2017; nr. 78, datë 22.12.2015, të Gjykatës Kushtetuese*).

29. Gjykata konstaton se kërkesja është regjistruar si person juridik me vendimin nr. 7166, datë 31.7.2023 të Gjykatës së Shkallës të

Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë dhe gëzon personalitet juridik në përputhje me kërkesat e ligjit. Anëtare të kësaj shoqate janë shoqëritë “Birra Tirana” sh.a., “Birra Korça” sh.p.k., “Stefani & Co” sh.a. dhe “TEA” sh.p.k., të cilat janë prodhuese dhe tregtuese të produktit të berrës.

30. Referuar nenit 2 të statutit të kërkeses, ajo është organizatë jofitimprurëse që synon zgjidhjen e problemeve që hasen nga bizneset dhe nga konsumatorët lidhur me prodhimin, tregtimin dhe konsumin e pijeve alkoolike, si dhe ka për qëllim mbrojtjen e interesave të prodhuesve dhe tregtuesve të pijeve alkoolike vendase në marrëdhëniet me autoritetet shtetërore. Ndërsa për sa i përket objektit të veprimtarisë, ai përfshin, ndër të tjera: promovimin dhe rritjen e informacionit për industrinë dhe tregtinë në lidhje me pijet alkoolike; organizimin e kurseve dhe trajnimeve për sa u përket risive teknologjike dhe industriale të prodhimit, tregtimit dhe përpunimit të pijeve alkoolike; krijimin dhe zgjerimin e bashkëpunimit me shoqata të tjera të njohura në të gjithë botën për prodhimin dhe tregtimin e pijeve alkoolike; pjesëmarrjen si grup interesi në nisma ligjore, ekonomike e sociale në vend në lidhje me tregtimin e produkteve të anëtarëve të shoqatës; mbrojtjen e interesave të tyre në treg në përputhje me praktikat më të mira për mbrojtjen e konsumatorëve; ndërmarrjen e veprimeve në mbrojtje të interesave legjitimë të anëtarëve në lidhje me kushtet e hyrjes në treg, operimit dhe trajtimit të barabartë etj.

31. Gjykata konstaton se, sikurse u pohua edhe nga palët në seancë plenare, anëtarët e shoqatës nuk e tejkalojnë sasinë e prodhimit të produktit të berrës mbi 200.000 HL në vit, pra ata bëjnë pjesë në kategorinë e prodhuesve vendas të cilët paguanin një shkallë taksimi të akcizës në vlerën 360 lekë/HL përpara ndryshimeve ligjore, për rrjedhojë ata preken nga ndryshimet ligjore të kundërshtuara.

32. Në lidhje me prapësimin e subjektit të interesuar, Kuvendit, për mungesën e legjitimitetit të lidhur me kohën e krijimit të kërkeses, Gjykata vlerëson se ai është i pabazuar, pasi, sikur ajo ka pohuar, shoqatat legjitimohen për sa kohë që arrijnë të provojnë se mbartin interes në çështjen kushtetuese (*shih vendimin nr. 17, datë 27.3.2012, të Gjykatës Kushtetuese*). Gjithashtu, Gjykata e gjen të pabazuar edhe prapësimin tjetër të subjekteve të interesuara se anëtarët e shoqatës nuk konsiderohen biznese të vogla sipas legjislacionit tatimor, pasi ky



fakt nuk është përcaktues për vlerësimin e legjitimitetit të shoqatës si subjekt që ka të drejtë të vërë në lëvizje kontrollin kushtetues, përderisa anëtarët e saj preken nga dispozitat e kundërshtuara. Po kështu, i pabazuar është edhe prapësimi i subjektit të interesuar, Kuvendit, se kërkesja nuk legjitimohet për pretendimin për mbrojtjen e bizneseve të huaja, për sa kohë që thelbi i pretendimit të kërkesës lidhet me mbrojtjen e interesave të prodhuesve vendas, anëtarë të saj.

33. Për sa më lart, Gjykata vlerëson se kërkesja justifikon interesin e saj të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar në kuptim të nenit 131, shkronja “a”, të Kushtetutës dhe nenit 49, pika 3, shkronja “d”, të ligjit nr. 8577/2000, ndaj legjitimohet *ratione personae*.

34. Në lidhje me legjitimitetin *ratione temporis*, sipas nenit 50, pika 1, të ligjit nr. 8577/2000, kërkesa për pajtueshmërinë e ligjit ose të akteve të tjera me Kushtetutën duhet të paraqitet brenda 2 vjetëve nga hyrja në fuqi e aktit. Ligji nr. 81/2022 është botuar në Fletoren Zyrtare të datës 20.12.2022 dhe ka hyrë në fuqi në datën 4.1.2023, kurse kërkesa në Gjykatë është paraqitur në datën 22.9.2023. Ligji nr. 94/2023 është publikuar në Fletoren Zyrtare të datës 22.12.2023, ndërsa kërkesa për kundërshtimin e tij (kërkesa për shtimin e objektit) është paraqitur në Gjykatë në datën 19.1.2024. Për rrjedhojë, kërkesja legjitimohet edhe *ratione temporis*.

35. Për sa i takon legjitimitetin *ratione materiae*, kërkesja ka pretenduar cenimin e lirisë së veprimtarisë ekonomike në drejtim të proporcionalitetit të ndërhyrjes, së drejtës së pronës private dhe parimit të sigurisë juridike, të garantuara nga nenet 4, 11, 17 dhe 41 të Kushtetutës, si dhe të nenit 70 të MSA-së. Sipas kërkesës, ndonëse ndërhyrja është miratuar me ligj, ajo nuk diktohej nga interesi publik, si dhe nuk plotëson kriterin e proporcionalitetit midis mjetit dhe qëllimit që kërkohet të arrihet. Sipas saj, unifikimi i akcizës konsiston në rritjen e barrës tatimore, e cila ka sjellë pakësimin e të ardhurave të subjekteve prodhuese. Gjykata, nisur nga thelbi dhe përmbajtja e këtyre pretendimeve, vlerëson t'i analizojë ato në këndvështrim të lirisë së veprimtarisë ekonomike, në kuptim të nenit 11 të Kushtetutës të lidhur me nenin 17 të Kushtetutës.

Ç. Për themelin e pretendimeve

Ç.1 Për cenimin e lirisë së veprimtarisë ekonomike

36. Kërkesja ka pretenduar se ndryshimi i akcizës i ngarkon asaj një detyrim fiskal të lartë dhe

unifikimi i taksimit, pa marrë në konsideratë sasinë e prodhuar, mund të sjellë falimentimin e prodhuesve të vegjël vendas. Sipas saj, ligjvënësi nuk ka kryer asnjë analizë të efekteve të këtyre ndryshimeve ligjore, duke dëmtuar interesat ekonomikë të prodhuesve vendas që prodhojnë nën 200.000 HL. Sipas kërkesës, aplikimi i akcizës ka barazuar çmimin e produktit të birrës me atë të importit ose e ka tejkaluar çmimin e saj, si dhe ka ulur prodhimin vendas me 5%, duke sjellë falimentimin e disa fabrikave. Gjithashtu, kërkesja ka pretenduar edhe se ky ndryshim nuk përmbush kriterin e proporcionalitetit të ndërhyrjes dhe se qëllimi i diferencimit të akcizës është lehtësimi i barrës fiskale të tyre për shkak të kapaciteteve të limituara. Për sa u përket produkteve të tjera, kërkesja ka pretenduar se ligjvënësi ka ndryshuar taksimin në mënyrë të përshtatshme për 5 vjet dhe jo me rritje 100% të menjëhershme siç ka vepruar për produktin e birrës dhe se rritja e nivelit të akcizës nuk do të ulë nivelin e evazionit fiskal, përkundrazi do ta rrisë atë.

37. Subjektet e interesuara, Kuvendi dhe Këshilli i Ministrave, në mënyrë të përmbledhur, kanë prapësuar se ligji plotëson kriteret e përcaktuara nga neni 17 i Kushtetutës, pasi ai është miratuar me ligj, për një interes publik, dhe se përmbushet kriteri i proporcionalitetit midis mjetit dhe qëllimit që kërkohet të arrihet, që është përmirësimi i politikave në fushën e akcizave, shpërndarja e barrës fiskale dhe unifikimi i akcizës me vendet e rajonit. Sipas tyre, shteti shqiptar ka detyrimin të mos bëjë dallime në taksim midis produkteve vendase dhe atyre të importuara, duke shmangur diskriminimin fiskal. Subjektet e interesuara kanë prapësuar se parashikimi me ligj i akcizave është në diskrecion të ligjvënësit dhe në Shqipëri nuk ka fabrika të vogla të prodhimit të birrës të cilat të prodhojnë në mënyrë artizanale këtë produkt dhe diferencimi i akcizës ka krijuar hapësira për shmangien nga detyrimet, si dhe ka bërë që prodhuesit vendas të mos tentojnë të rrisin prodhimin me qëllim ruajtjen e nivelit të ulët të akcizës.

38. Neni 11 i Kushtetutës parashikon parimin themelor se sistemi ekonomik bazohet në pronën private e publike, si dhe në ekonominë e tregut dhe lirinë e veprimtarisë ekonomike. Gjykata në jurisprudencën e saj ka pohuar se kjo liri përmban në vetvete edhe lirinë e biznesit ose aftësinë për të krijuar dhe mbyllur një sipërmarrje, lirinë monetare si masë për të garantuar qëndrueshmërinë e çmimit,



lirinë fiskale për të ardhurat qoftë individuale, qoftë ndaj biznesit në mënyrë të veçantë, lirinë financiare dhe pavarësinë nga kontrolli shtetëror ose lirinë e punës për të ndërvepruar pa kufizime nga shteti (*shih vendimet nr. 21, datë 18.4.2023; nr. 86, datë 30.12.2016; nr. 33, datë 8.6.2016, të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë drejtim, ajo ka vlerësuar se liria e veprimtarisë ekonomike përfshin edhe detyrimin e shtetit që nëpërmjet legjislacionit të ndërhyjë në rregullimin e saj, me qëllim që krahas lirisë së veprimtarisë ekonomike të garantohet edhe parimi i shtetit social dhe i së mirës së përbashkët. Në këtë rast shteti duhet të luajë rolin e katalizatorit për realizimin efektiv të lirisë ekonomike, nga njëra anë, dhe mbrojtjes së kësaj lirie, nga ana tjetër (*shih vendimet nr. 60, datë 31.7.2017; nr. 16, datë 1.3.2017; nr. 33, datë 8.6.2016, të Gjykatës Kushtetuese*).

39. Gjykata e ka vlerësuar cenimin ose jo të lirive dhe të drejtave kushtetuese duke iu referuar përmbajtjes së nenit 17 të Kushtetutës. Kjo dispozitë, përveç arsyes publike, përmban detyrimin për të respektuar edhe kritere të tjera, si: kufizimi për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve dhe ekzistenca e raportit të drejtë midis kufizimit dhe gjendjes që e dikton atë. Parimi i njohur i proporcionalitetit nënkupton që ndërhyrja e ligjvënësit për kufizimin e një të drejte apo lirie të caktuar të bëhet me mjete të përshtatshme që u përgjigjen drejt qëllimit që synohet të arrihet (*shih vendimet nr. 1, datë 25.1.2024; nr. 30, datë 5.7.2021; nr. 16, datë 1.3.2017, të Gjykatës Kushtetuese*).

40. Nën dritën e sa më sipër, Gjykata ripohon se kontrolli i saj në shqyrtimin e ligjeve tatimore nisat nga premisa se ligjvënësi ka një hapësirë të gjerë vlerësimi të sistemit fiskal, ndaj ajo shqyrton përmbushjen e garancive dhe parimeve kushtetuese të parashikimeve ligjore që normojnë këtë sistem. Thënë ndryshe, juridiksioni i Gjykatës nuk shtrihet në vlerësimin e përgjithshëm ose përshtatshmërinë e sistemit tatimor, formave të veçanta të tatimeve apo kategorive të subjekteve që u nënshtrohen këtij sistemi. Në këtë kontekst, edhe ligjet objekt kundërshtimi, të cilat janë instrumente që lidhen me zbatimin e akcizës, e cila është pjesë e sistemit fiskal, janë objekt kontrolli vetëm në aspektin e garancive që ato ofrojnë në mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave dhe lirive kushtetuese, kryesisht të atyre me natyrë ekonomike, të subjekteve (operatorëve) të tij. Për këtë qëllim, Gjykata mban në konsideratë se për shkak të natyrës teknike që paraqet kuadri ligjor i

këtij sistemi, diskrecioni i ligjvënësit domosdoshmërisht, në të gjitha rastet, duhet të respektojë parimet e drejtësisë dhe të shtetit të së drejtës të sanksionuara në Kushtetutë. Këto parime janë universale, ato duhet të ndiqen si në bërjen e ligjeve, ashtu dhe në zbatimin e tyre (*shih vendimin nr. 33, datë 26.1.2016, të Gjykatës Kushtetuese*).

41. Gjykata në jurisprndencën e saj ka theksuar se parashikimi në nivel kushtetues i burimeve të krijimit të të ardhurave të buxhetit të shtetit është shprehje e rëndësisë së tyre për të realizuar në një shkallë të gjerë politikat ekonomike shtetërore dhe për të konsoliduar sistemin buxhetor. Dispozitat e neneve 155 dhe 157 të Kushtetutës, të cilat konsolidojnë sistemin buxhetor dhe përcaktojnë burimet e krijimit të të ardhurave të buxhetit të shtetit, sanksionojnë detyrimin kushtetues për të paguar detyrimet tatimore. Qëllimi i sistemit tatimor është mirëqenia e përgjithshme, që do të thotë e individëve dhe e komunitetit në përgjithësi, si dhe përmbushja e objektivave sociale të shtetit. Marrëdhëniet e tatimtaksave janë marrëdhënie ligjore detyrimi ndërmjet shtetit dhe tatimpaguesve dhe si të tilla ato mund të përcaktohen vetëm me ligj (*shih vendimet nr. 33, datë 26.1.2016; nr. 16, datë 25.7.2008, të Gjykatës Kushtetuese*).

42. Ndryshimet e kuadrit ligjor për sa i përket akcizës janë trajtuar edhe në jurisprndencën e gjykatave kushtetuese të vendeve të tjera. Kështu, akciza është përkufizuar si një taksë e cila vendoset për shkak të natyrës së produktit, i cili konsiderohet i dëmshëm për shëndetin e individëve dhe ka si karakteristikë faktin se përbën një element të çmimit të produktit. Pra, me rregullimin e nivelit të akcizës rregullohet edhe çmimi i produktit. Ajo përbën një nga burimet e buxhetit të shtetit, i cili përdoret për nevojat e shoqërisë dhe të shtetit. Nëpërmjet akcizës rregullohet edhe importi i mallrave, duke mbrojtur interesat e prodhuesve vendas. Për shkak të natyrës së saj, akciza, në krahasim me taksat e tjera, është më dinamike dhe lehtësisht e ndryshueshme (*shih vendimin nr. 4/98, datë 9.10.1998, të Gjykatës Kushtetuese të Lituanisë*).

43. Gjykata, mbështetur edhe në qasjen krahasimore, sjell në vëmendje se akciza përbën një taksë e cila reflekton veçantitë e sistemeve ligjore, zhvillimin historik të taksimit të pijeve alkoolike dhe karakteristikat specifike të administratës tatimore të secilit shtet. Nën këtë këndvështrim, Gjykata evidenton se në referim të ligjit nr. 61/2012, akciza



është një taksë që zbatohet mbi produktet e prodhuara dhe të importuara që hidhen për konsum në territorin e Republikës së Shqipërisë, ku përfshihen produktet energjetike, alkooli dhe pijet alkoolike, duhani dhe produktet e tij, si dhe produkte të tjera të përcaktuara në ligj dhe detyrimi i saj lind në momentin e hedhjes së mallit për konsum në territor (neni 2).

44. Gjykata vëren se ndonëse kuadri ligjor në fushën e akcizave ka pësuar ndryshime përgjatë viteve 2012–2021, për sa i përket produktit të birrës, në thelb, rezulton që të jetë ruajtur diferencimi i kësaj takse në varësi të sasisë së prodhuar në vit, duke përcaktuar si kufi ndarës sasinë 200.000 HL. Me ndryshimet ligjore të vitit 2021 ky diferencim është shfuqizuar, duke u unifikuar akciza fillimisht në vlerën 710 lekë/HL dhe në vitin 2023 në vlerën 744.4 lekë/HL, që do të thotë se ndaj anëtarëve të shoqatës kërkuese do të aplikohet një detyrim i shtuar për akcizën e produktit të birrës. Në këtë mënyrë duket se ligjvënësi ka vendosur kufizim të lirisë së veprimtarisë ekonomike të prodhuesve të produktit të birrës, për sa kohë akciza përbën një detyrim financiar që paguhet prej tyre. Për këtë shkak, Gjykata do të analizojë nëse ndërhyrja në fjalë përmbush kriteret kufizuese, pra: i. kufizimi të jetë bërë me ligj; ii. për arsye të rëndësishme publike/interes publik; iii. të ketë respektuar parimin e proporcionalitetit.

45. Gjykata çmon se *kriteri i parë* i kufizimeve rezulton të jetë respektuar, pasi ndërhyrja është bërë nëpërmjet një ligji që unifikon akcizën e produktit të birrës pavarësisht sasisë së prodhuar në vit, i cili është miratuar nga Kuvendi në mbështetje të neneve 78, 81, pika 1 dhe 155, të Kushtetutës, sipas procedurave të parashikuara për këtë qëllim.

46. Në lidhje me *kriterin e dytë*, atë të interesit publik, në praktikën e saj Gjykata ka pranuar tashmë se ligjvënësi, parimisht, është i lirë të veprojë brenda hapësirës së tij normuese, duke përcaktuar qartë dhe rast pas rasti qëllimet që kërkon të arrijë (*shih vendimet nr. 20, datë 20.4.2021; nr. 16, datë 1.3.2017; nr. 1, datë 16.1.2017, të Gjykatës Kushtetuese*). Sikurse është theksuar në jurisprudencën e Gjykatës, politikat fiskale përbëjnë faktorë të rëndësishëm në strategjinë e zhvillimit ekonomik afatmesëm dhe afatgjatë të një vendi (*shih vendimet nr. 33, datë 8.6.2016; nr. 52, datë 27.6.2024, të Gjykatës Kushtetuese*). Për sa i përket rastit konkret, Gjykata vlerëson se ndryshimet ligjore të kundërshtuara i shërbejnë

interesit publik, i cili konkretizohet në rritjen e të ardhurave në buxhetin e shtetit dhe përdorimin e tyre për përmirësimin e nevojave të shoqërisë si dhe shmangien e evazionit fiskal.

47. Në kushtet kur edhe ky kriter konsiderohet i përmbushur, Gjykata do të vijojë me analizën e *kriterit të tretë*, atij të proporcionalitetit, në thelb të të cilit qëndron ekuilibrimi i drejtë i interesave, vlerësimi objektiv, si dhe shmangia e konfliktit nëpërmjet përzgjedhjes së mjeteve të duhura për realizimin e tyre (*shih vendimet nr. 70, datë 27.12.2023; nr. 30, datë 5.7.2021; nr. 20, datë 20.4.2021; nr. 16, datë 1.3.2017, të Gjykatës Kushtetuese*). Për vlerësimin e proporcionalitetit të ndërhyrjes merret në shqyrtim balanca ndërmjet dëmit të shkaktuar individit dhe së mirës së përgjithshme të shoqërisë, masa e mbrojtjes nga arbitrariteti që ofrojnë procedurat ligjore, si dhe mundësia e shtetit për të përdorur mënyra a mjete të tjera për të arritur qëllimin. Shteti, brenda mundësive, duhet të kufizojë ndërhyrjen në minimum, duke kërkuar zgjidhje alternative dhe, përgjithësisht, duke u përpjekur t'i arrijë qëllimet në mënyrë sa më pak të dëmshme nga pikëpamja e të drejtave të njeriut (*shih vendimin nr. 17, datë 23.4.2010, të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë kuptim, Gjykata vlerëson të analizojë kriterin e proporcionalitetit në këndvështrim të tre nënkritereve të tij, nevojës, domosdoshmërisë dhe përshtatshmërisë (*shih vendimet nr. 1, datë 25.1.2024; nr. 70, datë 27.12.2023; nr. 16, datë 1.3.2017, të Gjykatës Kushtetuese*).

48. Lidhur me nënkriterin e nevojës, Gjykata thekson se duhet të ekzistojë një lidhje e arsyeshme mes kufizimit dhe gjendjes që kërkon ndërhyrje. Në rastin konkret, nevoja për ndryshimet ligjore është shprehur edhe në raportin e shqyrtimit në parim të projektligjit (ligji nr. 81/2022), sipas të cilit propozimi për unifikimin e akcizës së produktit të birrës argumentohet në kuadër të hartimit të strategjisë afatmesme të të ardhurave dhe rekomandimeve të FMN-së, të cilat kanë theksuar se të gjitha përjashtimet jostandarde, normat e ulëta dhe trajtimet preferenciale duhet të eliminohen nga TVSH-ja, akcizat dhe taksat kombëtare. Për më tepër, sipas relacionit, skema diferencuese ekzistuese ka krijuar premisa dhe hapësira për shmangie nga detyrimet e akcizës, si dhe ka bërë që prodhuesit e vegjël të mos tentojnë të rrisin prodhimin, me qëllim ruajtjen e nivelit të ulët të akcizës (*shih faqet 7–8 të raportit shoqëruar*).



49. Gjykata çmon se nevoja për ndërhyrjet ligjore lidhet me rritjen e të ardhurave në buxhetin e shtetit në raport me prodhimin e brendshëm bruto, si dhe me unifikimin e akcizës për të shmangur diskriminimin midis prodhuesve të birrës. Në këtë drejtim, Gjykata vlerëson se ligjvënësi ka respektuar parimin e neutralitetit në tatime, pasi barazia në barrën fiskale për prodhuesit e birrës respekton këtë parim. Në analizë të këtyre fakteve, duke mbajtur në vëmendje se në fushën fiskale ligjvënësi ka hapësirë të gjerë vlerësimi, në raport edhe me analizën *supra* të nenit 155 të Kushtetutës, i cili evidenton rëndësinë e burimit të të ardhurave në buxhetin e shtetit, Gjykata e konsideron të prezumuar nevojën për ndryshimin ligjor të kundërshtuar.

50. Për sa i përket nënkriterit të domosdoshmërisë, Gjykata vëren se merr rëndësi analiza nëse ka mjete të tjera të disponueshme që do të ishin në mënyrë të qartë efektive për arritjen e qëllimit, pasi domosdoshmëria lidhet edhe me përdorimin e mjeteve më pak të dëmshme për subjektet që u cenohen të drejtat dhe liritë. Në këtë drejtim, Gjykata vlerëson nëse ligjvënësi ka pasur në dispozicion mjete më pak të ashpra për të arritur qëllimin e tij (*shih vendimin nr. 52, datë 27.6.2024, të Gjykatës Kushtetuese*). Për më tepër, masat e marra nga ligjvënësi mund të jenë të shumëllojshme, madje edhe të karakterit monetar, por ajo që ka rëndësi në këtë rast është që thelbi i aktivitetit të individit të mos cenohet deri në atë masë sa të bëhet i pamundur ushtrimi i tij (*shih vendimet nr. 70, datë 27.12.2023; nr. 37, datë 1.12.2022; nr. 52, datë 5.12.2012, të Gjykatës Kushtetuese*).

51. Fillimisht, Gjykata çmon të theksojë se në vlerësimin e kushtetutshmërisë së ligjeve ajo nisët nga prezumimi i pajtueshmërisë së tyre me Kushtetutën. Kjo do të thotë se lidhur me antikushtetutshmërinë e pretenduar duhet të parashtrohen argumente bindëse për t'i dhënë mundësi Gjykatës të vlerësojë nëse zgjidhjet ligjore të zbatuara shkelin normat dhe vlerat kushtetuese (*shih vendimet nr. 21, datë 18.4.2023; nr. 16, datë 1.3.2017; nr. 4, datë 23.2.2016, të Gjykatës Kushtetuese*).

52. Në çështjen në shqyrtim, Gjykata evidenton se unifikimi i akcizës është realizuar nga ligjvënësi pas një periudhe 15-vjeçare të funksionimit të akcizës së diferencuar në varësi të prodhimit. Konkretisht, me ligjin nr. 61/2012 akciza për produktin e birrës ka qenë 360 lekë/HL për sasinë e prodhuar nën 200.000 HL në vit dhe mbi këtë sasi

710 lekë/HL, ndërsa me ligjin nr. 81/2022, ky diferencim u shfuqizua, duke përcaktuar akcizën në vlerën 710 lekë/HL, pavarësisht sasisë së prodhuar, ndërkohë që me ligjin nr. 94/2023 kjo taksë u rrit në masën 744.4 lekë/HL.

53. Gjykata vë në dukje faktin se subjektet prodhuese dhe tregtuese të birrës kanë ushtruar veprimtarinë në treg duke përfutur për një periudhë 15-vjeçare një trajtim preferencial, i cili përbënte një masë lehtësuese që ka synuar dhënien e mundësisë që ata të përshtateshin dhe të konsolidonin aktivitetin e tyre. Edhe pse ligjvënësi me miratimin e ligjit nr. 81/2022, pas një periudhe kohore relativisht të konsiderueshme, ka vendosur të kufizojë këtë trajtim, duke aplikuar një taksë të unifikuar, kjo politikë nuk ka cenuar në thelb lirinë e anëtarëve të shoqatës për të ushtruar aktivitetin e tyre prodhues dhe tregtar. Kjo do të thotë se ndonëse kërkesja ka pretenduar se ndryshimet ligjore në ligjin për akcizën kanë ndikuar në uljen 11% të prodhimit, në këtë gjykim, në drejtim të pasojave, nuk u arrit të provohej se kjo masë ka ndikuar në ushtrimin e aktivitetit ekonomik në atë shkallë sa të cenojë në mënyrë thelbësore lirinë e veprimtarisë ekonomike.

54. Në vështrim të sa më sipër, Gjykata rithekson se ajo nuk vë në dyshim diskrecionin e ligjvënësit për të përcaktuar masën e akcizës *per se* (vlerën 744.4 lekë), por as faktin se përfitimi i taksave të reduktuara nuk përbën të drejtë të fituar të subjektit ndaj të cilit rëndon ky detyrim. Por në rastin në fjalë, nga analiza e rrethanave, Gjykata vlerëson se ndërhyrja e ligjvënësit është proporcionale në drejtim të domosdoshmërisë, ndaj edhe ky nënkriter rezulton i përmbushur. Për më tepër, kërkesja nuk arriti të përmbysë prezumimin se (mos)ndryshimi i masës së akcizës mund të shmangte evazionin në këtë fushë.

55. Në lidhje me nënkriterin e përshtatshmërisë së masës, Gjykata, duke u nisur nga fakti se heqja e trajtimit preferencial të subjekteve prodhuese të birrës do të passjellë rritjen e të ardhurave në buxhetin e shtetit dhe reduktimin e hapësirave për shmangien nga pagesa e saj, vlerëson se kjo masë sjell efektin e duhur dhe realizon synimin për të cilin është përzgjedhur.

56. Për sa më sipër, Gjykata çmon se në ekuilibrin e interesave të prodhuesve të produktit të birrës, nga njëra anë, dhe interesit publik, nga ana tjetër, ndërhyrja në ligjin për akcizën nuk cenon parimin e proporcionalitetit, ndaj pretendimi i kërkuësës për



cenimin e lirisë së veprimtarisë ekonomike është i pabazuar.

57. Në përfundim, Gjykata vlerëson se pretendimet e kërkuases janë të pabazuara, sipas arsytimit të mësipërm, ndaj kërkesa rrëzohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “a” dhe 134, pika 1, shkronja “h”, të Kushtetutës, si dhe neneve 71 dhe 72, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me shumicë votash,

VENDOSI:

1. Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë, më 16.7.2024.

Shpallur, më 3.10.2024.

Kryetare: Holta Zaçaj

Anëtarë: Ilir Toska, , Sonila Bejtja, Elsa Toska, Sandër Beci, Marjana Semini, Genti Ibrahim

Anëtar kundër: Fiona Papajorgji, Marsida Xhaferllari

MENDIM PARALEL

1. Në çështjen me kërkuese Shoqatën e Prodhuesve dhe Tregtuesve të Pijeve Alkoolike Vendase, me objekt shfuqizimin e ligjeve nr. 81/2022 dhe 94/2023, “Për disa ndryshime në ligjin nr. 61/2012, ‘Për akcizat në Republikën e Shqipërisë’”, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, ndonëse bashkohemi me shumicën për rrëzimin e kërkesës, nuk pajtohemi tërësisht me linjën e arsytimit të ndjekur prej saj.

2. Pretendimet e kërkuases lidhur me rregullimet e reja ligjore, të cilat kanë unifikuar akcizën e produktit të birrës pavarësisht sasisë së prodhimit vjetor, u vlerësua që të trajtohen në këndvështrim të lirisë së veprimtarisë ekonomike, duke u analizuar nëse ndërhyrja respekton kriteret kushtetuese që lejojnë kufizimin në këndvështrim të neneve 11 dhe 17 të Kushtetutës, pra nëse: i. është bërë me ligj; ii. për interes publik; iii. respekton parimin e proporcionalitetit. Në analizë të këtyre kriterëve, në

lidhje me interesin publik, shumica ka vlerësuar se ndryshimet ligjore të kundërshtuara i shërbejnë interesit publik, i cili konkretizohet në rritjen e të ardhurave në buxhetin e shtetit dhe përdorimin e tyre për përmirësimin e nevojave të shoqërisë si dhe shmangien e evazionit fiskal. Për rrjedhojë, sipas saj, interesi publik për këto ndërhyrje ligjore konsiderohet i prezumuar. Në vijim, shumica, ka vijuar me analizën e *kriterit të tretë*, atij të proporcionalitetit të ndërhyrjes, duke e trajtuar plotësimin e tij në këndvështrim të nënkritereve të nevojës, domosdoshmërisë në kuptim të ashpërsisë së masës dhe përshtatshmërisë së masave ligjore të kundërshtuara (*shih paragrafin 47 të vendimit*), elemente këto të evidentuara tashmë në praktikën e Gjykatës (*shih vendimet nr. 70, datë 27.12.2023 (hartat gjyqësore)*; nr. 1, datë 25.1.2024 (*për studentët e mjekësisë*)).

3. Megjithatë, sikurse jemi shprehur edhe në mendimin e pakicës, në çështjen e ligjit për tatimin mbi të ardhurat (*shih mendimin e pakicës të vendimit nr. 52, datë 27.6.2024, të Gjykatës Kushtetuese*) ne jemi të qëndrimit se kontrolli kushtetues i ligjeve që kanë për objekt rregullimin e çështjeve të taksave dhe tatimeve nuk është një kontroll klasik si ai që kryhet në rastet e tjera të ndërhyrjeve në të drejtat dhe liritë kushtetuese në kuptim të nenit 17 të Kushtetutës. Në fushën e tatimtaksave ligjvënësit i është njohur një hapësirë e gjerë, pasi vetëm në këtë mënyrë, duke pasur liri në përcaktimin e burimeve dhe të shkallës tatimore, ai mund të miratojë instrumentet e nevojshme me natyrë rregullatore, me qëllim zbatimin e politikave me natyrë ekonomike dhe sociale, zhvillimin e sistemit ekonomik, sigurimin e të ardhurave të qëndrueshme për përmbushjen e objektivave sociale, në interes të drejtësisë ekonomike dhe të mirëqenies së përgjithshme. Në këtë kuptim, kontrolli kushtetues është i rezervuar për sa kohë ai respekton kufijtë e hapësirës së gjerë të vlerësimit të ligjvënësit, e lidhur kjo edhe me parimin e ndarjes dhe balancimit ndërmjet pushteteve, duke e lejuar këtë kontroll veçse kur Gjykata konstaton se ligjvënësi ka shkelur parime ose të drejta kushtetuese, duke vendosur, nëpërmjet masave fiskale, haptazi një barrë të rëndë për subjektet tatimpaguese, e cila mund të çojë deri në shuarjen e të drejtave dhe lirive kushtetuese. Të tilla masa mund të jenë ato që kanë natyrë arbitrare dhe/ose konfiskatore dhe, për këtë shkak, vënë në diskutim proporcionalitetin e tyre në raport me qëllimin për të cilin vendosen. Thënë sa më sipër, në



këto raste kontrolli që duhet të kryejë Gjykata është thuajse përjashtimor dhe, për këtë shkak, nuk ndalet në verifikimin, në të njëjtën mënyrë, të të gjitha kriterëve të ndërhyrjes si në rastet e tjera të verifikimit të kufizimit të të drejtave kushtetuese.

4. Për sa më sipër, për sa kohë që pranohet se ligjvënësi ka një hapësirë të gjerë vlerësimi në këtë fushë, kontrolli kushtetues i Gjykatës do të duhet të niset nga prezumimi i interesit publik të ndërhyrjes, i cili përfshin edhe prezumimin e ekzistencës së nevojës dhe domosdoshmërisë së ndërhyrjes, ashtu edhe të përshtatshmërisë së masës, çka do të thotë se Gjykata nuk mund të vlerësojë nëse një masë apo një tjetër do të ishte ajo më e përshtatshme, diskrecion ky që i takon vetëm ligjvënësit. Megjithatë, ne nuk nënkuptojmë se veprimtaria e ligjvënësit mbetet e pakontrolluar. Në përputhje me sa më sipër, si dhe në linjë edhe me qëndrimin tonë të mëparshëm në çështjen e ligjit për tatimin mbi të ardhurat, edhe në rastin konkret, në drejtim të analizës së kriterëve të ndërhyrjes së ligjvënësit, ne mbajmë qëndrimin se shumica duhej të ishte ndalur vetëm në drejtim të kontrollit të ashpërsisë së masës së kundërshtuar, pra në drejtim të pasojave konkrete dhe dëmit të ardhur subjekteve të këtij ligji për shkak të heqjes së akcizës së diferencuar (trajtimit preferencial) dhe zbatimit të një akcize të unifikuar, për sa kohë nuk është e nevojshme analiza e nënkriterëve të tjera të testit të proporcionalitetit, nisur nga premisa se ekzistenca e tyre konsiderohet e prezumuar.

5. Kurse për sa i përket analizës së shumicës në lidhje me themelin e çështjes, ne i bashkohemi përfundimit të arritur prej saj se në rastin konkret, edhe pse ligjvënësi me miratimin e ligjit nr. 81/2022, pas një periudhe kohore relativisht të konsiderueshme, ka vendosur të kufizojë këtë trajtim, duke aplikuar një taksë të unifikuar, kjo politikë nuk ka cenuar në thelb lirinë e anëtarëve të shoqatës për të ushtruar aktivitetin e tyre prodhues dhe tregtar.

6. Trajtimi preferencial është zbatuar nga ligjvënësi për një periudhë 15-vjeçare, me qëllim nxitjen dhe incentivimin e prodhuesve dhe tregtuesve të këtij produkti. Eliminimi i këtij trajtimi, sikurse provuan edhe subjektet e interesuara, në thelb, respekton parimin e neutralitetit në tatime të lidhur me parimin e drejtësisë tatimore, sipas të cilit subjektet duhet t'i nënshtrohen së njëjtës barrë fiskale dhe të gjitha format e trajtimeve preferenciale

në fushën e taksave dhe tatimeve duhet të minimizohen. Për më tepër, akciza nuk paraqitet si një taksë e re, e miratuar për herë të parë për prodhuesit e produktit të birrës, por një regjim fiskal i njohur dhe i pranuar prej tyre. Nga ana tjetër, diferencimi preferencial nuk mund të konsiderohet se krijonte pritshmëri nga ana e kërkueses, për sa kohë ajo përbën çështje që i përket diskrecionit të ligjvënësit dhe buron drejtpërdrejt nga neni 155 i Kushtetutës. Për këtë shkak, aplikimi i një akcize më të ulët për një periudhë të caktuar nuk mund të përbëjë të drejtë të fituar, pasi legjislacioni tatimor është lehtësisht i ndryshueshëm në varësi të kushteve konkrete dhe nevojave që ka shteti në periudha të caktuara. Në këtë mënyrë eliminimi i trajtimit të diferencuar në vetvete nuk mund të konsiderohet kufizim i lirisë ekonomike.

7. Edhe gjatë seancës plenare vlerësojmë se, referuar parashtrimeve të palëve në proces, nuk u arrit të provohej se masa është arbitrare apo se ka cenuar në thelb veprimtarinë ekonomike të anëtarëve të shoqatës, kërkueses. Anëtarët e shoqatës tashmë i janë nënshtruar akcizës së re për një periudhë gati 2-vjeçare dhe ata nuk arritën të paraqesin fakte se kanë ndërprerë prodhimin për këtë shkak. Kjo do të thotë se ndonëse kërkuësja ka pretenduar se ndryshimet ligjore në ligjin për akcizën kanë ndikuar në uljen 11% të prodhimit, ajo nuk ka mundur të dëshmojë se si kjo masë ka ndikuar në ndryshimin e aktivitetit ekonomik duke e bërë të pamundur ushtrimin e tij. Kërkuësja nuk arriti të provojë përpara Gjykatës, në drejtim të ashpërsisë së masës, se ndërhyrja është e tillë që ka sjellë ndërprerjen e veprimtarisë ekonomike apo se fitimi i munguar për shkak të aplikimit të kësaj mase i ka pamundësuar ushtrimin e aktivitetit deri në mbyllje të tij. Kërkuësja nuk arriti të provonte se masa e përzgjedhur nga ligjvënësi ka qenë e atillë që ka përbërë një masë me natyrë arbitrare deri edhe konfiskatore, pra që pasojat kanë qenë të tilla që kanë cenuar thelbin e lirisë së veprimtarisë ekonomike.

8. Për rrjedhojë, për sa kohë që, në kuptim të kriterit të proporcionalitetit të ndërhyrjes së ligjvënësit nuk provohet që masa, në drejtim të pasojave të saj, të jetë më e ashpër se sa është e nevojshme për arritjen e qëllimit të synuar, kërkesa është e pabazuar.

Kryetare: Holta Zaçaj

Anëtarë: Ilir Toska

**MENDIM PAKICE**

1. Në gjykimin kushtetues të vënë në lëvizje nga Shoqata e Prodhuesve dhe Tregtuesve të Pijeve Alkoolike Vendase (*kërkesja*), me objekt shfuqizimin e ligjeve nr. 81/2022 dhe nr. 94/2023, të cilat kanë ndryshuar ligjin nr. 61/2012, “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë”, si të papajtueshme me Kushtetutën, jemi kundër qëndrimit të shumicës që ka vendosur rrezimin e kërkesës. Në mbështetje të nenit 132, pika 3, të Kushtetutës dhe nenit 72, pika 8, të ligjit nr. 8577/2000, që parashikojnë publikimin e mendimit të pakicës së bashku me vendimin përfundimtar të Gjykatës, parashitrojmë në vijim argumentet që mbështesin qëndrimin tonë kundër.

2. Fillimisht, sjellim në vëmendje se me miratimin e ligjit nr. 61/2012, ligjvënësi kishte parashikuar diferencim në vlerën e akcizës së produktit të birrës në varësi të sasisë së prodhimit vjetor, përkatësisht: nën 200.000 HL në vit – 360 lekë/HL dhe mbi 200.000 HL në vit – 710 lekë/HL. Me ligjin nr. 81/2022, ky diferencim u shfuqizua, duke bërë që akciza të jetë 710 lekë/HL pa asnjë dallim në lidhje me sasinë e prodhimit vjetor të birrës, ndërsa me ligjin nr. 94/2023, akciza është rritur në vlerën 744.4 lekë/HL (për shkak të indeksimit). Kërkesja, një shoqatë me anëtarësi prodhues dhe tregtues të produktit të birrës vendase, ka pretenduar se unifikimi i akcizës së birrës pavarësisht sasisë vjetore të prodhuar, i miratuar me ligjet e kundërshtuara, ka cenuar lirinë e veprimtarisë ekonomike në drejtim të proporcionalitetit të ndërhyrjes, të drejtën e pronës private, parimin e sigurisë juridike, si dhe nenin 70 të MSA-së, pretendime të cilat shumica ka vlerësuar t’i trajtojë në këndvështrim të lirisë së veprimtarisë ekonomike.

3. Lidhur me këtë pretendim, shumica ka pranuar se unifikimi i akcizës përbën një detyrim të shtuar për anëtarët e shoqatës, duke vendosur kufizim të lirisë së veprimtarisë ekonomike të tyre, për sa kohë akciza përbën një detyrim financiar që paguhet prej tyre. Për këtë ajo është ndalur në analizën e kriterëve kufizues të kësaj lirie, pra të: i. kufizimit me ligj; ii. interesit publik; iii. parimit të proporcionalitetit. Ajo (shumica) ka vlerësuar se është përmbushur kriteri i parë, pasi ndërhyrja është bërë me ligj dhe se ndryshimet ligjore të kundërshtuara i shërbejnë interesit publik, duke u nisur nga fakti se politikat fiskale përbëjnë faktorë të rëndësishëm në

strategjinë e zhvillimit ekonomik afatmesëm dhe afatgjatë të një vendi dhe në këtë kuptim ligjvënësi, parimisht, është i lirë të veprojë brenda hapësirës së tij normuese, duke përcaktuar qartë dhe rast pas rasti qëllimet që kërkon të arrijë (*shih paragrafët 44–46 të vendimit*).

4. Krahas sa më lart, shumica ka vijuar me analizën e parimit të proporcionalitetit, në drejtim të tre nënkritereve të tij, nevojës, domosdoshmërisë dhe përshtatshmërisë. Bazuar në faktin se ndërhyrjet ligjore lidhen me rritjen e të ardhurave në buxhetin e shtetit në raport me prodhimin e brendshëm bruto dhe duke konsideruar hapësirën e gjerë të ligjvënësit, ajo ka prezumuar edhe nevojën për këto ndërhyrje. Ndërsa për sa i përket domosdoshmërisë së masave, në drejtim të ashpërsisë së tyre, shumica ka evidentuar se subjektet prodhuese dhe tregtuese të birrës kanë ushtruar veprimtarinë në treg duke përfutur nga një trajtim preferencial, që përbën një masë lehtësuese që ka synuar t’u jepte mundësinë këtyre subjekteve të përshtateshin dhe të konsolidonin aktivitetin e tyre në treg. Sipas shumicës, kjo politikë nuk ka cenuar, në thelb, lirinë ekonomike të anëtarëve të shoqatës për të ushtruar aktivitetin e tyre prodhues dhe tregtar dhe se kërkesja, në drejtim të pasojave, nuk ka arritur të provojë se ndërhyrja është aq e ashpër sa të cenojë në mënyrë thelbësore lirinë e veprimtarisë ekonomike. Edhe në lidhje me nënkriterin e përshtatshmërisë së masës, shumica ka vlerësuar se masat e marra do të sjellin efektin e duhur dhe do të realizojnë synimin për të cilin janë përzgjedhur (*shih paragrafët 47–55 të vendimit*).

5. Ndërkohë që bashkohemi me qëndrimin e shumicës se ndërhyrja në lirinë ekonomike të kërkuarës përmbush kriteret e ndërhyrjes me ligj dhe interesit publik, nuk pajtohemi me faktin se ajo përmbush edhe kriterin e proporcionalitetit në drejtim të nënkriterit të domosdoshmërisë/ashpërsisë së masës.

6. Në parantezë sjellim në vëmendje se akciza përbën një *taksë* që zbatohet mbi produktet e akcizës të prodhuara dhe të importuara që hidhen për konsum në territorin e Republikës së Shqipërisë (*neni 2, pika 2, i ligjit nr. 61/2012*). Në këtë kuadër, sikurse kemi theksuar në mendimin e pakicës në vendimin nr. 52, datë 27.6.2024 (me objekt Ligji i Tatimeve), ripohojmë se ligjvënësi ka diskrecion për të caktuar me ligj taksat dhe tatimet, sikundër lehtësimi apo përjashtimi nga taksat nuk përbën të drejtë *per se* të individit. Këto pohime bazohen në nenet 155 dhe



157 të Kushtetutës, sipas të cilave, taksat, lehtësimi ose përjashtimi prej tyre i kategorive të caktuara të paguesve, caktohen me ligj dhe të ardhurat nga taksat shërbejnë për të krijuar buxhetin e shtetit. Kjo do të thotë se kompetencën për të përcaktuar kategoritë nga të cilat mund të përjashtohen nga detyrimet financiare e ka vetëm ligjvënësi.

7. Megjithatë, kjo kompetencë e ligjvënësit është pjesë e ushtrimit të funksionit publik, ndaj ka kufizimet e veta kushtetuese, që përcaktohen nga parimet themelore dhe të drejtat e njeriut. Në këtë drejtim, Gjykata ka pohuar se, për shkak të natyrës teknike që paraqet kuadri ligjor i tatimeve dhe taksave, diskrecioni i ligjvënësit domosdoshmërisht, në të gjitha rastet, duhet të respektojë parimet e drejtësisë dhe të shtetit të së drejtës të sanksionuara në Kushtetutë. Këto parime janë universale, ato duhet të ndiqen si në bërjen e ligjeve, ashtu dhe në zbatimin e tyre. Ato nënkuptojnë se të gjitha institucionet shtetërore duhet të veprojnë vetëm në bazë dhe në zbatim të ligjit, se të drejtat dhe liritë e njeriut duhet të sigurohen dhe se drejtësisë natyrore duhet t'i kushtohet vëmendje. Gjithashtu, ato presupozojnë faktin se masat e vendosura nga shteti për shkelje të ligjit duhet të jetë proporcionale, pra të përshtatshme për shkeljen, duhet të jenë në përputhje me objektivat legjitimë e të rëndësishëm dhe nuk duhet të kufizojnë personin më shumë se është e nevojshme për të arritur këto objektiva (*shih vendimin nr. 33, datë 8.6.2016, të Gjykatës Kushtetuese*).

8. Ndaj është e rëndësishme që në këtë pikë të ritheksojmë edhe qëndrimin e mbajtur nga Gjykata në vendimin e saj të fundit në lidhje me Ligjin e Tatimeve, se nënkriteri i domosdoshmërisë lidhet me përdorimin e mjeteve më pak të dëmshme për subjektet që u cenohen të drejtat dhe liritë, që do të thotë se duhet të analizohet nëse ligjvënësi ka pasur në dispozicion mjete më pak të ashpra për të arritur qëllimin e tij. Gjykata u shpreh se zbatimi i skemave të reja tatimore duhet të shoqërohet me masa të përshtatshme kalimtare. Midis këtyre masave, dhënia kohë tatimpaguesve u krijon atyre mundësinë jo vetëm të njihen me formulat e llogaritjes së zbatimit të tatimit ndaj tyre, por edhe të marrin masa që vetë subjektet tatimpaguese i vlerësojnë të nevojshme për të përshtatur aktivitetin e tyre në mënyrë që të përballojnë pasojat e skemës së zbatueshme (*shih vendimin nr. 52, datë 27.6.2024, të Gjykatës Kushtetuese*). Në atë rast, Gjykata shqyrtoi proporcionalitetin e skemës së re tatimore (15 % nga

0%) për të vetëpunësuarit dhe entitetet me të ardhura të tatueshme deri në 14 milionë lekë në vit, duke arritur në përfundimin se skema nuk ishte në përputhje me Kushtetutën, për shkak se ndërhynte në lirinë e veprimtarisë ekonomike, të garantuar nga neni 11 i Kushtetutës, pa respektuar parimin e proporcionalitetit në drejtim të domosdoshmërisë/ ashpërsisë së mjetit të përzgjedhur.

9. Duke mbajtur në konsideratë ngjashmërinë e dy çështjeve, çmujmë se çështja konkrete duhet të kishte të njëjtin përfundim me rezultatin e arritur për Ligjin e Tatimeve – atë të pranimi të kërkesës, pasi trajtimi edhe në këtë rast ka të bëjë me shqyrtimin e proporcionalitetit të akcizës për prodhuesit e vegjël, për të cilët ajo u dyfishua menjëherë për shkak të unifikimit. Në këtë pikëpamje, dy zgjidhje diametralisht të kundërta, të dhëna në çështje kushtetuese të shqyrtuara në të njëjtën kohë nga Gjykata dhe me të njëjtën tipologji pasojash, nuk respektojnë parimin e shtetit të së drejtës, në kuptim të respektimit të rregullit të vazhdimësisë së jurisprudencës. Detyrimi për vendimmarrje të njëjtë dhe të qëndrueshme në çështje të ngjashme, të cilin Gjykata e ka imponuar në një sërë rastesh për gjykatat e zakonshme (*shih vendimet nr. 8, datë 19.3.2018; nr. 26, datë 22.5.2015; nr. 6, datë 17.2.2012, të Gjykatës Kushtetuese*) duhet të respektohet edhe prej vetë asaj.

10. Nisur nga premisa e mësipërme, në vijim paraqesim arsyet përse mendojmë se vlera e re e akcizës së unifikuar për prodhuesit e birrës nën 200.000 HL në vit nuk përmbush nënkriterin e domosdoshmërisë, në drejtim të ashpërsisë së masës.

11. Me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 81/2022, pas një periudhe 15-vjeçare të funksionimit të akcizës së diferencuar në varësi të sasisë së prodhimit, ligjvënësi ka realizuar unifikimin e akcizës duke dyfishuar atë për prodhuesit e birrës nën 200.000 HL në vit, nga vlera 360 lekë/HL në 710 lekë/HL (e cila më pas me ligjin nr. 94/2023, për shkak të indeksimit, arriti vlerën 744.4 lekë/HL). Për të dëshmuar efektet e aplikimit të kësaj skeme të re kërkujesja gjatë shqyrtimit në seancë plenare paraqiti një sërë të dhënash konkrete, të cilat nuk u kundërshtuan nga subjektet e interesuara, megjithatë të dhënat nuk u morën në konsideratë nga shumica në analizën e saj mbi proporcionalitetin e ndërhyrjes, që e bën vlerësimin e shumicës abstrakt, pra të palidhur me rrethanat konkrete të çështjes.

12. Në ndryshim nga shumica, ne gjyqtaret në pakicë, duke u ndalur dhe analizuar edhe të dhënat



konkrete të shqyrtuara në gjykimin kushtetues, vlerësojmë se ndryshimet ligjore të kundërshtuara janë të ashpra për katër arsyet e mëposhtme.

13. *Së pari*, për sa i takon *vlerës së masës së re* të parashikuar, nga të dhënat e paraqitura nga kërkuesja në seancën plenare, rezulton se në analizë krahasimore të vendeve të BE-së, 10 shtete aplikojnë një nivel të akcizës më të lartë se në Shqipëri (Estoni, Finlandë, Francë, Greqi, Irlandë, Lituanë, Letoni, Holandë, Suedi dhe Sllovaki), ndërsa 17 shtete të tjera kanë një nivel më të ulët (si p.sh: Austria, Gjermania, Spanja, Kroacia, Rumania etj.). Edhe për sa u përket vendeve të Ballkanit, Shqipëria qëndron në vendin e dytë për akcizën më të lartë prej 0.12 eurosh për 1 shishe 330 ml, në krahasim me shtetet e tjera. Të dhënat e mësipërme, të cilat nuk rezultojnë të jenë vënë në dyshim nga subjektet e interesuara, nxjerrin në pah se ligjvënësi nuk ka zgjedhur masën e përdorur nga shumica dërmuese e vendeve të BE-së dhe atyre të Ballkanit, por ka preferuar të renditet ndër ato vende me akcizën më të lartë.

14. Gjithashtu, sikurse ka pretenduar kërkuesja, niveli i masës aktuale të akcizës është 3 herë më shumë se niveli minimal i parashikuar në direktivat nr. 92/84/KE dhe nr. 92/83/KE. Në këtë pikë, pa vënë në dyshim faktin se direktivat nuk janë pjesë e rendit juridik shqiptar dhe si të tilla pretendimet në lidhje me to nuk mund të hyjnë në juridiksionin kushtetues, nuk mund të mos pranohet vlera e tyre në përafrimin e legjislacionit, në kuadër të detyrimeve të MSA-së, që ka lidhur Republika e Shqipërisë për procesin e integritetit evropian. Në këtë pikëpamje, ndonëse legjislacioni për akcizat ka synuar përafrimin me direktivat e KE-së, përfshirë edhe dy direktivat në fjalë¹, ndryshimet e mëvonshme të këtij ligji, të cilat janë objekt kontrolli në këtë gjykim kushtetues, duket se janë larguar nga qëllimi i legjislatorit në vitin 2012. Thënë kjo, pavarësisht se përafrimi i ligjeve ekzistuese dhe atyre të ardhshme me legjislacionin e BE-së përbën rëndësi parësore për Shqipërinë e konkretizuar në detyrimet e marra përsipër nëpërmjet MSA-së (*shih nenin 70 të MSA-së*), në rastin konkret duket se ligjvënësi nuk është orientuar nga kjo perspektivë.

15. *Së dyti*, në drejtim të *kategorizimit të sasisë së prodhimit*, po nga të dhënat e paraqitura në seancë nga

kërkuesja, rezulton se diferencimi i akcizës në varësi të sasisë së prodhimit është një fenomen i njohur në shumë vende evropiane dhe i mbështetur edhe në direktivën 92/84/KE, ku shtete të ndryshme aplikojnë fasha të ndryshme të akcizës për birraritë e vogla të pavarura. Pavarësisht se direktivat evropiane nuk paraqesin detyrim për shtetet për të aplikuar tarifa të reduktuara, kjo praktikë është e njohur dhe e zbatueshme dhe ka për qëllim diferencimin e prodhuesve të birrës në varësi të kapaciteteve të tyre. Ndërkohë që ligjvënësi, sikurse u theksua më lart, me ligjin e ri unifikoi tarifën e akcizës pavarësisht sasisë së prodhimit, duke barazuar në këtë kuptim prodhuesit me prodhimtari më të lartë me ata me prodhimtari të ulët.

16. *Së treti*, për sa i takon *ekzistencës së mjeteve të tjera më pak të ashpra*, nisur nga shpjegimet dhe argumentet e subjekteve të interesuara gjatë gjykimit kushtetues nuk u provua se unifikimi i akcizës në mënyrë të menjëhershme ishte mjeti i vetëm që mund të përdorej nga ligjvënësi për të arritur qëllimin e tij. Nisur nga premisa se prodhuesit e nën 200.000 HL birrë në vit edhe përpara ndërhyrjes së kundërshtuar nuk kanë qenë të përjashtuar nga pagesa e akcizës, nuk mund të mos konsiderohet se ekzistojnë mjete të tjera, të tilla si rritja progresive dhe graduale e akcizës, e cila do t'u jepte kohë dhe mundësi prodhuesve të përshtateshin me këto ndryshime dhe me barrën e re fiskale. Lidhur me këtë situatë, vëmë në dukje rëndësinë që ka qartësia e normave ligjore në fushën fiskale, përfshirë edhe për akcizat. Në këtë këndvështrim, periudha kohore që përcaktohet për çdo situatë konkrete duhet të vlerësohet duke pasur parasysh një sërë rrethanash, sikurse qëllimi i ligjit në sistemin juridik dhe karakterin e marrëdhënieve shoqërore të rregulluara prej tij; rrethi i subjekteve ndaj të cilëve zbatohet dhe mundësitë e tyre për t'u përshtatur me normimet e reja; nevoja që normat e reja të hyjnë në fuqi në kohë sa më të shpejtë; si dhe interesi publik dhe mbrojtja e vlerave kushtetuese që tejkalojnë interesin e një individi për të pasur më shumë kohë në dispozicion për t'u përshtatur. Në këtë pikë, theksojmë se hyrja e shpejtë në fuqi e ligjeve që vendosin detyrime dhe/ose kufizime duhet të jetë një përjashtim, i bazuar dhe i justifikuar në rrethana të veçanta

¹ Shih

<https://www.dogana.gov.al/c/171/198/258/legjislacioni-mbi-akcizen>.



objektive. Kjo do të thotë se kur bëhen ndryshime në fushën fiskale, sikurse parashikimi i detyrimeve të reja apo rritja e detyrimeve ekzistuese, periudha kohore e lënë në dispozicion për hyrjen në fuqi të tyre duhet të justifikohet vetëm në bazë të premisë së garantimit të një interesi të rëndësishëm publik, sikurse mund të jetë stabiliteti i financave publike. Në këtë drejtim dhe në kontekstin e parimit kushtetues të shtetit të së drejtës, ligjvënësi, në rastet e ligjeve që u përkasin sistemit fiskal, është i detyruar të parashikojë një periudhë kohore të mjaftueshme për hyrjen në fuqi të ligjit, përgjatë së cilës subjektet e tij do të mund të përgatiteshin për zbatimin e kërkesave që rrjedhin prej rregullave të reja ligjore. Kjo u jep garancinë atyre që jo vetëm të njihen paraprakisht me kërkesat e reja ligjore, por edhe të përshtatin interesat e tyre pasurore dhe perspektivat e aktivitetit ekonomik në përputhje me kërkesat e reja ligjore. Përkundër kësaj, në rastin konkret, ligjvënësi zgjodhi të dyfishonte në mënyrë të menjëhershme vlerën e akcizës. Parë nën këtë optikë, një tjetër mjet më i butë i përzgjedhur nga ligjvënësi do të ishte edhe ulja e pragut prej 200.000 HL në një sasi më të ulët, të ngjashme me modelet evropiane, apo edhe ndryshimi proporcional i tarifës për prodhuesit me mbi 200.000 HL në vit.

17. *Së katërti*, vlerësojmë se qëllimi i subjekteve të interesuara për shmangien e evazionit fiskal nuk e justifikon ndërhyrjen e ligjvënësit, për sa kohë anëtarët e shoqatës paraqitën argumente se industria e prodhimit dhe tregtimit të birrës monitorohet nga një sistem gjurmimi me pullë fiskale dhe në praktikë ekziston mundësia që pikërisht rritja e akcizës të motivojë prodhuesit për shmangien e saj. Për më tepër, mungesa e kapaciteteve kontrolluese të institucioneve shtetërore dhe efikasitetit të monitorimit të prodhimit dhe tregtimit të birrës nuk mund të përbëjë arsye të mjaftueshme për kufizimin e lirisë ekonomike, në atë masë sa të mos përmbushë kriterin e proporcionalitetit.

18. Në përfundim, mbështetur në argumentet e mësipërme, ne, gjyqtarët në pakicë, vlerësojmë se Gjykata duhej të kishte pranuar kërkesën e kërkuës dhe të vendoste shfuqizimin e ligjeve të kundërshtuara për sa i përket pjesës që kanë parashikuar unifikimin e akcizës për produktin e birrës, sipas arsyetimit të mësipërm.

Anëtarë: Fiona Papajorgji, Marsida Xhaferllari

VENDIM
Nr. 57, datë 17.9.2024

**NË EMËR TË REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË**

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë,
e përbërë nga:

Holta Zaçaj	kryetare;
Fiona Papajorgji	anëtare;
Elsa Toska	anëtare;
Sonila Bejtja	anëtare;
Sandër Beci	anëtar;
Ilir Toska	anëtar;
Genti Ibrahim	anëtar;
Marjana Semini	anëtar;
Marsida Xhaferllari	anëtare,

me sekretare Belma Lleshi, më datë 17.9.2024,
mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve kërkesën nr. 1 (Y) 2024 të Regjistratit Themeltar, që u përket:

KËRKUES: Ylli Dylgjeri, përfaqësuar nga avokate Etleva Haka, me prokurë të posaçme.

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Agjencia e Trajtimit të Koncesioneve, në mungesë.

Departamenti i Administratës Publike, përfaqësuar nga drejtoresha Enkela Dudushi.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2023-3812, datë 12.10.2023 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

Konstatimi i shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimi i procedurave në gjykimin e çështjes administrative nr. 31154-02568-86-2019, datë 28.6.2019 të regjistruar pranë Gjykatës Administrative të Apelit.

Detyrimi i Gjykatës Administrative të Apelit të shqyrtojë çështjen brenda afatit njëmuor nga dhënia e vendimit të Gjykatës Kushtetuese.

BAZA LIGJORE: Nenet 18, pika 1, 41, 42, 43, 44, 131, pika 1, shkronja “P”, 134, pika 1, shkronja “I” dhe 142 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6, pika 1, i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; nenet 27, pikat 1 dhe 2, 71, pika 1, 71/a dhe 71/b të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).



GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes Marsida Xhaferllari, shqyrtoi kërkesën e kërkuarit, prapësimet me shkrim të subjektit të interesuar, Departamentit të Administratës Publike (DAP), që shprehet në favor të përshpejtimin të procesit, konstatoi mungesën e prapësimeve me shkrim të subjektit të interesuar, Agjencisë së Trajtimit të Koncesioneve (Agjencia), si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuarisi Ylli Dylgjeri (*kërkuarisi*) ka ushtruar detyrën e drejtorit të Drejtorisë së Planifikimit dhe Nxjtes pranë Agjencisë prej datës 31.1.2014 dhe ka pasur statusin e nëpunësit civil. Më datë 18.3.2019 ndaj tij është marrë masa disiplinore e largimit nga Shërbimi Civil për shkeljen e rëndë disiplinore të postimit në rrjete sociale të vlerësimeve politike, në kundërshtim me parimin e paanësisë.

2. Kërkuarisi ka ngritur padi ndaj Agjencisë dhe DAP-it, me objekt shfuqizimin e vendimit për largimin nga detyra, rikthimin në detyrë dhe kryerjen e pagesave deri në rikthimin në detyrë. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. 1615, datë 8.5.2019, ka vendosur pranimin e padisë. Kundër vendimit ka paraqitur ankim pala e paditur. Çështja është regjistruar në Gjykatën Administrative të Apelit me nr. 31154-02568-86-2019, datë 28.6.2019, megjithatë nuk janë kryer veprime gjyqësore.

3. Pas pothuajse 4 vjetëve, më datë 13.6.2023 kërkuarisi i është drejtuar Gjykatës së Lartë me kërkesë për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2023-3812, datë 12.10.2023, në dhomën e këshillimit, ka vendosur rrëzimin e kërkesës, me arsyetimin se nuk vërehet pakujdesi në veprimtarinë e gjykatës së apelit dhe se ajo gjykatë është në pamundësi objektive (mungesë e theksuar gjyqtarësh dhe stafi të kualifikuar ndihmës) për shqyrtimin e menjëhershëm të çështjes.

4. Më datë 1.3.2024 kërkuarisi ka paraqitur ankim kushtetues individual në Gjykatën Kushtetuese

(*Gjykata*) sipas objektit. Kolegji i Gjykatës më datë 18.4.2024 ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

5. *Kërkuarisi*, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar cenimin e *së drejtës për proces të rregullt ligjor*, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në aspektet e mëposhtme:

5.1 *E drejta për gjykim brenda një afati të arsyeshëm*, pasi çështja e largimit të tij nga puna është në pritje në gjykatën e apelit prej më shumë se 4 vjetësh dhe Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë në shqyrtimin e kërkesës për konstatimin e shkeljes nuk ka respektuar afatin ligjor 45-ditor.

5.2 *E drejta e aksesit në gjykatë*, pasi sekretaria e Gjykatës së Lartë, pas shtyrjes së seancës së planifikuar për shqyrtimin e kërkesës për konstatimin e shkeljes, nuk e ka njoftuar kërkuarisen për datën dhe orën e seancës së radhës.

5.3 *E drejta për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj dhe parimi i gjykatës së paanshme*, pasi Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë me vendimmarrjen e tij ka vepruar si një gjykatë e urdhëruar për të marrë një vendim politik ndaj kërkuarisit.

5.4 *Parimi i sigurisë juridike*, pasi tejkalimi i çdo afati të arsyeshëm në gjykimin e çështjes së largimit të padrejtë nga puna të kërkuarisit ka cenuar pritshmëritë e ligjshme të tij për zgjidhjen e mosmarrëveshjes me një vendim të formës së prerë.

6. *Subjekti i interesuar, DAP-i*, në mënyrë të përmbledhur, është shprehur se çështja gjyqësore e largimit të kërkuarisit nga puna duhet të përshpejtohet.

7. *Subjekti i interesuar, Agjencia*, nuk ka paraqitur prapësime me shkrim, edhe pse është njoftuar rregullisht.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitetin e kërkuarisit

8. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) është vlerësuar si një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pikat 1, shkronja “I” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr.



8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë edhe kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, si dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

9. Gjykata vlerëson se kërkuesi, si bartës i të drejtave dhe lirive themelore të parashikuara nga Kushtetuta, legjitimohet *ratione personae*, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës, pasi është palë ndërgjyqëse në gjykimin administrativ të largimit të tij nga detyra, për të cilin ka pretenduar cenimin e procesit të rregullt ligjor.

10. Në lidhje me *shterimin e mjeteve juridike efektive*, Gjykata vëren se kërkuesi, bazuar në nenet 399/2 e vijues të Kodit të Procedurës Civile (KPC), i është drejtuar Gjykatës së Lartë me kërkesë për konstatimin e shkeljes, kërkesë e cila është rrëzuar me vendimin nr. 00-2023-3812, datë 12.10.2023. Për rrjedhojë, i vetmi mjet në dispozicion të kërkuetit për rivendosjen në vend të së drejtës së cenuar është ankimi kushtetues individual.

11. Për sa i takon afatit të paraqitjes së ankimit kushtetues, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës më datë 1.3.2024. Ndërkohë, vendimi i Gjykatës së Lartë që ka rrëzuar kërkesën për konstatimin e shkeljes është dhënë më datë 12.10.2023, por është bërë i disponueshëm për palët dhe është publikuar në faqen zyrtare më datë 10.11.2023. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se kërkuesi legjitimohet edhe *ratione temporis*, sepse jo vetëm që shkelja është vazhduese, por edhe ankimi kushtetues individual është paraqitur brenda afatit 4-mujor të parashikuar nga neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i ligjit nr. 8577/2000.

12. Në drejtim të legjitimitetit *ratione materiae*, Gjykata vëren se kërkuesi, në thelb, ka pretenduar se gjykata e apelit dhe Gjykata e Lartë nuk i kanë garantuar atij të drejtën kushtetuese për gjykimin e çështjes së largimit nga detyra brenda një afati të arsyeshëm dhe, po kështu, kërkesa për konstatimin e shkeljes nuk i është nënshtruar një procesi të rregullt ligjor, në aspektet e aksesit në gjykatë,

gjykatës së caktuar me ligj, gjykatës së paanshme dhe sigurisë juridike. Gjykata, duke mbajtur në konsideratë se pretendimi kryesor i kërkuetit lidhet me të drejtën kushtetuese për gjykimin e çështjes brenda afatit të arsyeshëm, se procesi për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm që zhvillohet nga gjykatat e zakonshme ka natyrë subsidiare dhe se kontrolli kushtetues i kësaj të drejte ushtrohet duke analizuar edhe sjelljen e autoriteteve, përfshirë ato të gjykatave të zakonshme, çmon t'i shqyrtojë pretendimet e kërkuetit në këndvështrim të së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1 Për cenimin e së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm

13. Kërkuesi ka pretenduar cenimin e së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm ligjor, pasi çështja e tij është në pritje për t'u shqyrtuar në shkallë të dytë prej më shumë se 4 vjetësh. Sipas tij, Gjykata e Lartë ka vendosur rrëzimin e kërkesës për konstatimin e shkeljes duke mos respektuar afatin ligjor 45-ditor dhe duke kryer një sërë shkeljesh të të drejtave të kërkuetit.

14. Subjekti i interesuar, DAP-i, ka mbajtur qëndrimin se gjykimi brenda një afati të arsyeshëm është në favor të të gjitha palëve, përfshirë këtu edhe organet publike, si DAP-i, pasi vonesat rrisin dëmin në buxhetin e shtetit dhe vështirësojnë ekzekutimin e vendimit.

15. Neni 42 i Kushtetutës parashikon, ndër të tjera, se kushdo, për mbrojtjen e të drejtave të tij kushtetuese dhe ligjore, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë brenda një afati të arsyeshëm. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka vlerësuar se kohëzgjatja e gjykimit, normalisht, llogaritet nga momenti i fillimit të procesit gjyqësor deri në momentin kur jepet vendimi dhe se në kohëzgjatjen e përgjithshme të gjykimit nuk përjashtohen vonesat e shkaktuara nga zbatimi i reformës në drejtësi, pasi barra e këtyre vonesave nuk duhet të zhvendoset te palët ndërgjyqëse (*shih vendimet nr. 46, datë 3.10.2023; nr. 6, datë 16.2.2023; nr. 13, datë 26.5.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

16. Në çështjen konkrete, Gjykata konstaton se mosmarrëveshja që po gjykohet nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm lidhet me marrëdhënien e punësimit të kërkuetit. Procesi gjyqësor ka filluar në shkallë të parë në vitin 2019 dhe pas dhënies së vendimit në favor të kërkuetit nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë më datë



8.5.2019, subjektet e interesuara kanë paraqitur apel. Çështja është regjistruar në Gjykatën Administrative të Apelit më datë 28.6.2019 dhe deri më datë 9.9.2024 nuk ka ende një datë të planifikuar për gjykim nga gjyqtari relator, pra ndonëse kanë kaluar më shumë se 5 vjet, ende nuk ka një vendimarrje për çështjen.

17. Duke iu referuar objektit të mosmarrëveshjes gjyqësore, Gjykata vëren se neni 399/2, pika 1, shkronja “a”, i KPC-së ka përcaktuar se përbën afat të arsyeshëm përfundimi i gjykimit administrativ në gjykatën e apelit brenda një viti. Kjo do të thotë se gjykimi i çështjes konkrete në Gjykatën Administrative të Apelit është tejzgatur, ndaj për të vlerësuar nëse kërkuesit i është cenuar e drejta kushtetuese për gjykim brenda afatit të arsyeshëm, Gjykata do të analizojë rrethanat e veçanta të çështjes konkrete dhe kriteret e vendosura nga jurisprudenca kushtetuese që lidhen me: (i) sjelljen e kërkuesit; (ii) kompleksitetin e çështjes; (iii) sjelljen e autoriteteve; (iv) rëndësinë e asaj çfarë rrezikon kërkuesi (*shih vendimet nr. 46, datë 3.10.2023; nr. 6, datë 16.2.2023; nr. 13, datë 26.5.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

18. Për sa i takon *sjelljes së kërkuesit*, merr rëndësi të analizohen rrethanat nëse ai ka vepruar në përputhje me të drejtat procedurale, duke shfaqur ose jo interes të vazhdueshëm për gjykimin e çështjes brenda një afati sa më të përshtatshëm për të dhe nëse është bërë shkak ose ka shkaktuar vonesa në këtë drejtim (*shih vendimet nr. 6, datë 16.2.2023; nr. 37, datë 5.11.2021; nr. 35, datë 1.11.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Gjykata vëren se kërkuesi, pasi ka pritur dhe ka konstatuar se nuk ishte planifikuar një datë për shqyrtimin e ankimit në Gjykatën Administrative të Apelit, i është drejtuar fillimisht Gjykatës së Lartë, me kërkesën e regjistruar më datë 13.6.2023, për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm, në përputhje me parashikimet e neneve 399/1 e vijues të KPC-së. Kjo kërkesë është rrëzuar nga Gjykata e Lartë më datë 12.10.2023 dhe sërish çështja ka mbetur pa veprime, në pritje të planifikimit për një datë shqyrtimi. Kërkuesi, pasi është njohur me vendimin e Gjykatës së Lartë, ka paraqitur ankim kushtetues individual, sipas objektit. Për rrjedhojë, Gjykata çmon se sjellja e kërkuesit nuk është bërë shkak për tejzgjatjen e gjykimit të çështjes së tij.

20. Në lidhje me *kompleksitetin e çështjes*, Gjykata vëren se çështja ka në objektin e saj marrëdhëniet e

punësimit të kërkuesit, sipas legjislacionit të Shërbimit Civil. Gjykimi në shkallën e parë është zhvilluar në seancë gjyqësore publike dhe krahas kërkuesit në gjykim janë thirrur si palë ndërgjyqëse Agjencia dhe DAP-i. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë e ka përfunduar gjykimin brenda pak muajve dhe ka vendosur pranimin e padisë. Për rrjedhojë, Gjykata çmon se çështja e kërkuesit nuk paraqitet komplekse që të justifikojë kohëzgjatjen e shqyrtimit të saj prej më shumë se 5 vjetësh në shkallë të dytë.

21. Në lidhje me *sjelljen e autoriteteve*, Gjykata konstaton se ankimi në çështjen e kërkuesit për marrëdhëniet e punësimit është në pritje për shqyrtim prej më shumë se 5 vjetësh në Gjykatën Administrative të Apelit. Ai i është caktuar me short pesë gjyqtarëve, konkretisht në datat 2.7.2019, 20.5.2022, 9.3.2023, 14.9.2023 dhe 24.11.2023, për shkak të organizimit të brendshëm të punës në atë gjykatë. Lloji i çështjes së kërkuesit përfshihet në grupin e çështjeve të parashikuara si prioritare për shqyrtim nga shkronja “gj” e pikës 3.1 të vendimit nr. 78, datë 30.5.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor (KLGJ) “Për kalendarin e shqyrtimit të çështjeve në gjykatën e apelit” (*vendimi nr. 78/2019*). Pavarësisht kësaj, përveç organizimit të shorteve dhe lëvizjes së çështjes nga njëri gjyqtar relator tek tjetri, nuk rezulton të jenë kryer veprime të tjera me çështjen. Ndërkohë, Gjykata e Lartë ka rrëzuar kërkesën për konstatimin e shkeljes, duke vlerësuar se gjykata e apelit është në pamundësi objektive, për shkak të mungesës së theksuar të gjyqtarëve dhe të stafit të kualifikuar ndihmës, si rezultat i zbatimit të reformës në drejtësi.

22. Gjykata konstaton se më datë 28.6.2019, kur çështja e kërkuesit është regjistruar, reforma në drejtësi kishte filluar të zbatohet. Aktualisht, reforma është ende në proces zbatimi dhe çështja e kërkuesit vijon pa vendimarrje, ndërsa numri i gjyqtarëve të Gjykatës Administrative të Apelit është nën organikën e saj, gjithsej, 11 gjyqtarë. Në atë gjykatë janë duke u shqyrtuar çështjet e regjistruara në vitin 2018, ndërsa janë në pritje për shqyrtim 696 çështje të ngjashme me ato të kërkuesit. Gjyqtarja relatore, së cilës i është caktuar për shqyrtim së fundmi çështja e kërkuesit, ka për shqyrtim 2023 çështje gjyqësore.

23. Duke i analizuar treguesit e mësipërm, Gjykata çmon se vonesa prej më shumë se 5 vjetësh në gjykimin e çështjes së kërkuesit është pasojë e



ngarkesës së lartë në Gjykatën Administrative të Apelit dhe të gjyqtarës relatore, shkaktuar nga zbatimi i reformës në drejtësi.

24. Në këtë drejtim, Gjykata thekson në mënyrë të përsëritur se pavarësisht rëndësisë dhe përfitimeve që sjellin reformat në sektorin e drejtësisë, ligjvënësi ka për detyrë të marrë masat dhe të gjejë mjetet e duhura për ndryshimin e gjendjes faktike, me qëllim që ligjet të zbatohen dhe gjykatat e të gjitha niveleve të funksionojnë normalisht (*shih vendimet nr. 2, datë 17.2.2022; nr. 37, datë 5.11.2021; nr. 35, datë 1.11.2021 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjithsesi, kjo gjendje është duke u zgjatur prej disa vitesh, prandaj edhe metodat e identifikuar nga vetë gjykatat dhe KLGJ-ja, në cilësinë e organit kushtetues që ka përgjegjësinë për të siguruar mbarëvajtjen e pushtetit gjyqësor (*neni 147, pika 1, i Kushtetutës*), tregojnë se mekanizmat e parashikuar nga nenet 399/1-399/12 të KPC-së i shërbejnë një kohe normale të veprimtarisë gjyqësore, pra jo situatës së jashtëzakonshme, në pikëpamje të volumit, që ndodhet tashmë sistemi i drejtësisë (*shih vendimet nr. 43, datë 4.6.2024; nr. 21, datë 4.4.2024 të Gjykatës Kushtetuese*).

25. Në lidhje me atë çfarë rrezikon kërkuesi në procesin gjyqësor, Gjykata ka pohuar se disa kategori çështjesh, për shkak të natyrës së tyre, kërkojnë përshpejtim të posaçëm të gjykimit. Disa çështje që lidhen me interesa “vetjakë e jetësorë”, nevojitet të trajtohen me përparësi dhe shpejtësi të veçantë. Lista e këtyre çështjeve nuk mund të jetë shteruese dhe kriteri i interesit të kërkuetit në proces verifikohet nga Gjykata rast pas rasti (*shih vendimet nr. 6, datë 16.2.2023; nr. 35, datë 1.11.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

26. Duke iu kthyer çështjes konkrete, Gjykata vëren se në objektin e saj është marrëdhënia e punësimit të kërkuetit dhe shpërblimi i dëmit që rrjedh prej saj. Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut ka pohuar se mosmarrëveshjet në fushën e punësimit, për nga natyra e tyre, kërkojnë vendimmarrje të përshpejtuar (*shih Votaturo kundër Italisë, 24.5.1991, § 17*), ndërsa KLGJ-ja në vendimin e saj nr. 78/2019 ka vlerësuar se këto lloj çështjesh gjyqësore janë prioritare për shqyrtim. Për këto arsye, Gjykata çmon se mosmarrëveshja e punësimit, për shkak të pasojave të saj me natyrë sociale dhe financiare, përbën interes vetjak dhe jetësor për kërkuetin, i cili aktualisht është i moshës 61 vjeç, ndaj çështja e tij duhet të trajtohet me

shpejtësi të veçantë nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm.

27. Në përmbledhje të analizës së mësipërme, Gjykata vlerëson se interpretimi i ligjit nga Gjykata e Lartë për rrëzimin e kërkesës për konstatimin e shkeljes së të drejtës së kërkuetit për gjykim brenda afatit të arsyeshëm nuk është në përputhje me Kushtetutën, ndaj vendimi i saj duhet shfuqizuar. Gjykimi përtej afatit të arsyeshëm, bazuar vetëm në faktin se shteti ka dështuar të marrë masa efikase, nuk mund të përligjë cenimin e të drejtave kushtetuese të individëve, në kushtet kur mbingarkesa në gjykata tashmë është një situatë e njohur dhe e zgjatur në kohë, e cila nuk varet nga individët dhe nuk mund të rëndoje mbi ta.

28. Në përfundim, duke pasur parasysh kohëzgjatjen prej më shumë se 5 vjetësh të gjykimit të çështjes në shkallë të dytë, natyrën jo komplekse të çështjes, sjelljen e autoriteteve, si dhe interesin vetjak të kërkuetit për marrëdhënien e punësimit, Gjykata vlerëson se kërkuetit i është cenuar e drejta kushtetuese për gjykim brenda një afati të arsyeshëm, ndaj kërkesa duhet të pranohet. Po kështu, bazuar në nenin 81, pika 3, të ligjit nr. 8577/2000 dhe duke mbajtur në konsideratë volumin e punës së Gjykatës Administrative të Apelit, numrin e çështjeve të ngjashme dhe ngarkesën e gjyqtarës relatore, Gjykata çmon se duhet urdhëruar përfundimi i gjykimit të çështjes së kërkuetit brenda 6 muajve.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, si dhe nenit 72, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me shumicë votash,

VENDOSI:

1. Pranimin e kërkesës.
2. Shfuqizimin e vendimit nr. 00-2023-3812, datë 12.10.2023, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.
3. Konstatimin e cenimit të së drejtës për një gjykim brenda afatit të arsyeshëm.



4. Detyrimin e Gjykatës Administrative të Apelit të gjykojë çështjen e kërkesit brenda 6 (gjashtë) muajve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë, më 17.9.2024.

Shpallur, më 3.10.2024.

Kryetare: Holta Zaçaj (kundër)

Anëtarë: Elsa Toska, Sandër Beci, Sonila Bejtja, Marsida Xhaferllari, Marjana Semini, Genti Ibrahimimi

Anëtarë kundër: Fiona Papajorgji, Ilir Toska

MENDIM PAKICE

1. Në gjykimin kushtetues të çështjes që i përket kërkesit Ylli Dylgjeri, me objekt: *“Shfuqizimin e vendimit nr. 00-2023-3812, datë 12.10.2023 të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën. Konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përsheptimin e procedurave në gjykimin e çështjes administrative nr. 31154-02568-86-2019, datë 28.6.2019 të regjistruar pranë Gjykatës Administrative të Apelit. Detyrimin e Gjykatës Administrative të Apelit ta shqyrtojë çështjen brenda një afati një muaj nga dhënia e vendimit të Gjykatës Kushtetuese”*, jemi kundër qëndrimit të shumicës për pranimin e kërkesës dhe vlerësojmë se kërkesa duhej të ishte rrëzuar, për shkak se në drejtim të vlerësimit të kohëzgjatjes së arsyeshme të procesit gjyqësor të kundërshtuar nuk është plotësuar kriteri i rëndësisë së asaj çfarë rrezikon kërkuesi dhe për këtë arsye çmojmë të shprehemi me mendim pakice.

2. Duke iu referuar rrethanave të çështjes konkrete në shqyrtim, siç ka konstatuar edhe shumica, procesi gjyqësor në Gjykatën Administrative të Apelit, ku ankimi i paraqitur nga pala kundërshtare e kërkesit është në pritje për t’u shqyrtuar prej pak më shumë se 5 vjetësh, është në tejkalim të afatit të parashikuar për këtë lloj gjykimi nga Kodi i Procedurës Civile (KPC). Megjithatë, kjo, në vetvete, nuk përbën argument për të deklaruar kohëzgjatjen e paarsyeshme të procesit, për sa kohë që për të arritur në një vlerësim të tillë nevojitet të vlerësohen kriteret e përcaktuara në jurisprudencën kushtetuese, në përputhje me atë të Gjykatës Evropiane të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ), konkretisht ato që kanë të bëjnë me: (i) sjelljen e kërkesit; (ii) kompleksitetin e çështjes; (iii) sjelljen e

autoriteteve; (iv) rëndësinë e asaj çfarë rrezikon kërkuesi.

3. Për sa u përket tre kritereve të para, bashkohemi me shumicën në vlerësimin që ajo i ka bërë sjelljes së kërkesit dhe asaj të autoriteteve, si edhe për sa i përket kompleksitetit të çështjes. Megjithatë, ne ndahemi nga qëndrimi i shumicës në lidhje me kriterin e katërt, pra atë të rëndësisë së asaj çfarë rrezikon kërkuesi nga kohëzgjatja e procesit gjyqësor.

4. Sipas shumicës, objekt i çështjes konkrete është marrëdhënia e punësimit të kërkesit dhe shpërblimi i dëmit që rrjedh prej saj. Nisur nga kjo, duke referuar në jurisprudencën e GJEDNJ-së në çështjen Vocaturo kundër Italisë, më 24.5.1991, si dhe në vendimin nr. 78/2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, shumica ka arritur në përfundimin se mosmarrëveshja e punësimit për shkak të pasojave të saj me natyrë sociale dhe financiare përbën interes vetjak dhe jetësor për kërkuenin, i cili aktualisht është i moshës 61 vjeç, ndaj, për pasojë, çështja e tij duhej të trajtohej me shpejtësi të veçantë nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm (*shih paragrafin 26 të vendimit*).

5. Në lidhje me atë çfarë rrezikon kërkueni nga kohëzgjatja e procesit gjyqësor, sikurse edhe shumica ka evidentuar, Gjykata ka pohuar se disa kategori çështjesh, për shkak të natyrës së tyre, kërkojnë përsheptim të posaçëm të gjykimit. Disa çështje që lidhen me interesa “vetjakë e jetësorë”, nevojitet të trajtohen me përparësi dhe shpejtësi të veçantë. Lista e këtyre çështjeve nuk mund të jetë shteruese dhe kriteri i interesit të kërkesit në proces verifikohet nga Gjykata rast pas rasti (*shih vendimet nr. 6, datë 16.2.2023; nr. 35, datë 1.11.2021 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjithashtu, bazuar në jurisprudencën e GJEDNJ-së, Gjykata ka theksuar se të tilla janë çështjet që kërkojnë “kujdes të veçantë” ose “kujdes të jashtëzakonshëm”, si ato që lidhen me statusin civil, kujdestarinë e fëmijëve, marrëdhëniet e punësimit, sëmundjet e pashërueshme, pensionin (*shih vendimin nr. 37, datë 7.5.2024 të Gjykatës Kushtetuese*). Megjithatë, në vlerësimin tonë, natyra e çështjes, në vetvete, nuk është e mjaftueshme për të përcaktuar interesin e lartë/të veçantë vetjak të personit që kërkon përsheptimin e procedurave, por është e nevojshme edhe të provuarit të këtij interesi në drejtim të pasojave të ardhura ose të mundshme për shkak të asaj vonese. Nisur nga kjo, vërejmë se kërkueni nuk ka parashtruar argumente



dhe as ka paraqitur prova në drejtim të asaj çfarë rrezikon ai për shkak të vonesës së procesit gjyqësor në Gjykatën Administrative të Apelit.

6. Në drejtim të asaj çfarë rrezikon kërkuesi nga kohëzgjatja e procesit gjyqësor, në rastin konkret, mendojmë se vlen të mbahet parasysh edhe fakti se vetë kërkuesi nuk ka vlerësuar se vonesa e procesit gjyqësor dhe, për pasojë, edhe ekzekutimi i dëmshpërblimit të akorduar për të nga gjykata e shkallës së parë, mund t'i shkaktojë atij dëme të rëndësishme, përderisa nuk rezulton të ketë shfrytëzuar të drejtën për të kërkuar dhënien me ekzekutim të përkohshëm të vendimit të gjykatës së shkallës së parë sipas nenit 317 të KPC-së.

7. Në vlerësimin tonë, në drejtim të kriterit të rëndësisë së asaj çfarë rrezikon kërkuesi për shkak të vonesës së procesit gjyqësor në Gjykatën Administrative të Apelit, në kontekst të rrethanave të rastit, ai nuk ka argumentuar dhe provuar rrezikun për interesat e tij “vetjakë e jetësorë”, të cilat kërkojnë trajtimin me përparësi dhe shpejtësi të veçantë të çështjes së tij. Nisur nga kjo, mbajtëm qëndrimin se nuk ka cenim të së drejtës për proces të rregullt në aspekt të kohëzgjatjes së arsyeshme të gjykimit në gjykatën në fjalë, ndaj, për rrjedhojë, kërkesa duhej të ishte rrëzuar.

Kryetare: Holta Zaçaj

Anëtarë: Ilir Toska, Fiona Papajorgji

VENDIM

Nr. 160, datë 15.8.2024

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS, LIDHUR ME SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË “HPG ENERGY” SHPK, PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të neneve 4, pika 1, germa “a”, 5, pika 1, germa “a”, dhe 10, pikat 1 dhe 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe të neneve

15 dhe 19, pika 1, germa “a” të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 15.8.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1724/1 prot., datë 7.8.2024, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘HPG Energy’ sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Shoqëria “HPG Energy” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1724 prot., datë 2.8.2024, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaike, me kapacitet të instaluar 2mw dhe veprave ndihmëse, në Njësinë Administrative Topojë, Bashkia Fier, qarku Fier.

- Nga shqyrtimi i aplikimit, në referencë të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, rezulton se shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit sipas përcaktimeve të aneksit A dhe ka plotësuar dokumentacionin e kërkuar në pikën 1.1, germat: “a” “b” dhe “c”; për pikën 1.2, germat: “a”, “b”, “c” dhe “d”; për pikën 1.3, germat “a” dhe “c”; për pikën 2.1, germat: “b”, “d”, “e” dhe “f”.

- Rezulton se shoqëria “HPG Energy” sh.p.k.:

- Ka nënshkruar me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) kontratën me nr. 1961 rep., nr. 1269 kol., datë 6.4.2023, “Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e centralit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike, me kapacitet prodhues 2 mw dhe veprave ndihmëse, në zonën kadastrale 3358, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, qarku Fier, nga shoqëria ‘HPG Energy’ sh.p.k.”;

- Ka marrë ofertën për rimiratimin e pikës së lidhjes me rrjetin e shpërndarjes nga shoqëria “Operatori i Sistemit të Shpërndarjes” (OSSH) sh.a., nëpërmjet shkresës së kësaj të fundit nr. 2293/1 prot., datë 15.7.2024;

- Është pajisur me vendim për VNM-në paraprake, lëshuar më datë 18.7.2024, nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM), për të ndërtuar impiantin fotovoltaike me fuqi 2 mw;

- Nga ky aplikim nevojitet të plotësohet informacioni/dokumentacioni në vijim:



Neni 9

Pika 1. Dokumentacioni i përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë

Pika 1.3:

- germa “b”: Shoqëria duhet të depozitojë dokumentacion vërtetues për disponimin e fondeve për realizimin e investimit sipas kontratës me MIE-n, duke iu referuar mënyrës së financimit të parashikuar në planin e saj të biznesit.

Pika 2, Dokumentacioni specifik sipas tipit të licencës

Pika 2.1:

- germa “a”: Shoqëria duhet të depozitojë dokumentacionin teknik mbështetës, në lidhje me jetëgjatësinë e pritshme të centralit fotovoltaiq;

- germa “b”: Shoqëria duhet të depozitojë informacion/dokumentacion, në lidhje me zbatimin e afateve të kontratës së nënshkruar MIE-n;

- germa “c”: Shoqëria duhet të depozitojë në ERE rimirimin final/marrëveshjen e nënshkruar me “OSSH” sh.a., për pikën e lidhjes.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “HPG Energy” sh.p.k në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiq me kapacitet të instaluar 2 mw dhe veprave ndihmëse, në Njësinë Administrative Topojë, Bashkia Fier, qarku Fier.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë “HPG Energy” sh.p.k. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 161, datë 15.8.2024

MBI PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA FURNIZUESI I MUNDËSISË SË FUNDIT PËR MUAJIN KORRIK 2024 PËR KLIENTËT E LIDHUR NË NIVELIN E TENSIONIT 35 kV

Në mbështetje të neneve 16 dhe 87, pika 4, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 201, datë 4.12.2017, e ndryshuar; dhe nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 15.8.2024, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 1738/1 prot., datë 13.8.2024, të përgatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve “Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit për muajin korrik 2024 për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV”,

konstatoi se:

- Shoqëria Furnizuesi i Shërbimit Universal (FSHU) sh.a. shkresën nr. 5178 prot., datë 5.8.2024, protokolluar me tonën me nr. 1738 prot., datë 6.8.2024, ka përcjellë në ERE kërkesën mbi miratimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike të muajit korrik 2024, për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV, të cilët furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit. Bazuar në aplikimin e sipërcituar, për muajin korrik 2024, shoqëria FSHU sh.a., e ka siguruar të gjithë sasinë e nevojshme të energjisë elektrike për mbulimin e kërkesës së kësaj kategorie klientësh nëpërmjet blerjeve mujore në Bursën Shqiptare të Energjisë (ALPEX).

- Përlogaritjen e çmimit mesatar të ponderuar të blerjes së energjisë elektrike për këtë periudhë (ÇBEt), shoqëria e ka kryer duke u bazuar në të dhënat e profileve ditore të energjisë elektrike të prokuruar në bursë nga FSHU sh.a., çmimet orare të tregut të ditës në avancë të ALPEX-it të muajit korrik 2024 (euro/kWh), si dhe vlerat rezultuese të faturave ditore. Të dhënat e mësipërme të paraqitura në formë tabelare i janë bashkëlidhur, gjithashtu,



kërkesës për miratimin e çmimit të depozituar nga FSHU sh.a.

- Referuar aplikimit të shoqërisë FSHU sh.a., rezulton se është marrë në konsideratë kursi ditor i këmbimit (EURO/LEK), vlera të cilat janë bazuar në kurset zyrtare të këmbimit të publikuar nga Banka e Shqipërisë për datat 28.6.2024–30.7.2024.

- Mbështetur në nenin 8 të “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 201, datë 4.12.2017, e ndryshuar, komponentët që janë marrë në konsideratë për përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin korrik 2024, janë: kostot administrative, tarifa e shërbimit të rrjetit të transmetimit, tarifa e shërbimit të rrjetit të shpërndarjes, si dhe kursi i këmbimit i përdorur për blerjen e energjisë elektrike në treg të parregulluar.

- **Tarifa e shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike** për periudhën 1 maj 2022–31

dhjetor 2024, e miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 72, datë 13.4.2022, është 0.85 lekë/kWh.

- **Tarifa e shërbimit të shpërndarjes në nivel tensioni 35 kV**, në zbatim të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 365, datë 15.12.2023, “Mbi lënien në fuqi të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 73, datë 13.4.2022”, vijon të jetë 1.55 lekë/kWh.

- **Kostot administrative**, të cilat në zbatim të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 366, datë 15.12.2023, “Mbi lënien në fuqi të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 74, datë 13.4.2022, vijnë të jenë 1.06 lekë/kWh.

- Në zbatim të “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit”, referuar aplikimit të FSHU sh.a., si dhe mbështetur në llogaritjet e ERE-s, çmimi i shitjes së energjisë elektrike për klientët që furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin korrik 2024, përlllogaritet si më poshtë:

Çmimi i energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV për muajin Korrik 2024			
		Njësia	Çmimi
CBEt	Çmimi mesatar i ponderuar i blerjes së energjisë elektrike	Leke/kWh	15.85
Pr	Kthimi për riskun i përcaktuar në përqindje për vitin (3%)	Leke/kWh	0.48
CA	Kosto administrative të Furnizuesit të Mundësisë së Fundit	Leke/kWh	1.06
TRr	Tarifa e përdorimit të rrjetit të transmetimit	Leke/kWh	0.85
TSHt	Tarifa e përdorimit të rrjetit të shpërndarjes	Leke/kWh	1.55
Çmimi i energjisë = CBEt + Pr* CBEt + TRr + TSHt + CA			19.79

- Bazuar në çdo element të formulës llogaritëse si dhe duke marrë në konsideratë të dhënat e paraqitura në aplikimin e shoqërisë, rezulton se:

- Çmimi i shitjes së energjisë elektrike për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit do të jetë 19.79 lekë/kWh për muajin korrik 2024.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit sh.a., për muajin korrik 2024 prej 19.79 lekë/kWh për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV.

2. Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Faqe | 19840

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

**VENDIM****Nr. 162, datë 15.8.2024****MBI RINOVIMIN E LICENCËS SË
SHOQËRISË “FURNIZUESI I
SHËRBIMIT UNIVERSAL” SHA NË
VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “ç”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të neneve 4, pika 1, germa “d”, 5, pika 1, germa “d”, 13, si dhe 16, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 15.8.2024, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 1318/5 prot., datë 5.8.2024, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi rinovimin e licencës së shoqërisë ‘Furnizuesi i Shërbimit Universal’ sh.a., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Furnizuesi i Shërbimit Universal” (FSHU) sh.a., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1318/1 prot., datë 19.6.2024, ka paraqitur kërkesën për rinovimin e licencës në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 142, datë 16.7.2024, vendosi të fillojë procedurën për rinovimin e licencës nr. 427, seria F18, të shoqërisë “FSHU” sh.a., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 97, datë 27.10.2014, rinovuar sërish me vendimin nr. 164, datë 4.11.2019.

- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 17.7.2024 dhe 18.7.2024) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 26.7.2024), nuk rezultoi të ketë të tilla. Ky njoftim u publikua dhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s.

- Me shkresën nr. 1318/3 prot., datë 19.7.2024, ERE i është drejtuar shoqërisë duke i njoftuar

vendimin për fillimin e procedurës dhe kërkesën për plotësimin e dokumentacionit për të vijuar me procedurën për rinovim licence.

- Në vijim, shoqëria, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1318/4 prot., datë 29.7.2024, ka depozituar dokumentacion plotësues të aplikimit.

- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit në zbatim të përcaktimeve të aneksit A, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar.

- Shoqëria ka shlyer ndaj ERE-s të gjitha detyrimet për sa i përket pagesave të rregullimit.

- Nga shqyrtimi i aplikimit, rezulton se shoqëria ka plotësuar tërësisht dokumentacionin e kërkuar.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të rinovojë licencën nr. 427, seria F18, të shoqërisë “FSHU” sh.a. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 97, datë 27.10.2014, rinovuar sërish me vendimin nr. 164, datë 4.11.2019, për një afat 5-vjeçar duke filluar nga data 22.12.2024.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETAR
Petrit Ahmeti**

**VENDIM****Nr. 163, datë 15.8.2024****MBI FILLIMIN E PROCEDURËS,
LIDHUR ME SHQYRTIMIN E KËRKESËS
SË SHOQËRISË “NOA ENERGY TRADE”
SHPK PËR RINOVIMIN E LICENCËS NË
VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “d”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të neneve 4, pika 1, germa “e”, 5, pika 1, germa “e”, 10, pikat 1 dhe 3, dhe 16 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe të neneve 15 dhe 19, pika 1, germa “a”, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 15.8.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1563/2 prot., datë 8.8.2024, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Noa Energy Trade’ sh.p.k. për rinovimin e licencës në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Noa Energy Trade” sh.p.k., me shkresën nr. 1563/1 prot., datë 25.7.2024, ka paraqitur kërkesën për rinovimin e licencës në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- Në nenin 16, pika 1, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, përcaktohet se dokumentimi i kërkesës për rinovimin e licencës bëhet jo më vonë se 6 muaj para përfundimit të kohëzgjatjes së vlefshmërisë së licencës së dhënë (data e përfundimit të licencës nr. 262, seria T15, është 3.2.2025).

- Sa konstatohet, shoqëria e ka paraqitur aplikimin e saj në datën 25.7.2024, pra brenda afatit të parashikuar në nenin 16, pika 1.

- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit në zbatim të përcaktimeve të aneksit A, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin,

transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, si dhe ka shlyer të gjitha detyrimet për sa i përket pagesave të rregullimit.

- Nga shqyrtimi i këtij aplikimit, rezulton se shoqëria ka plotësuar tërësisht dokumentacionin e përcaktuar në nenin 16, pika 1, germa “a”, “b” dhe “c”, si dhe nenin 16, pika 7 të rregullores.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për rinovimin e licencës së shoqërisë “Noa Energy Trade” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar, duke filluar nga data 4.2.2025.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETAR
Petrit Ahmeti**

VENDIM**Nr. 164, datë 15.8.2024****MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “NOVA
PROSPECT” SHPK NË VEPRIMTARINË
E PRODHIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16, 37, pika 2, germa “a”, 38, pika 1, germa “a” dhe 39, pika 4, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 4, pika 1, germa “a”, 5, pika 1, germa “a”, 13 dhe 14, pika 9 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të



miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 15.8.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1448/11 prot., datë 12.8.2024, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Nova Prospect’ sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Nova Prospect” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1448 prot., datë 3.6.2024, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaike, me kapacitet prodhues 2 mw, me vendndodhje në zonën kadastrale nr. 22960, Njësia Administrative Pilur, Bashkia Himarë, qarku Vlorë.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 123, datë 19.6.2024, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë në këtë veprimtari.

- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 20.06.2024 dhe 21.6.2024) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 1.7.2024), nuk rezultoi të ketë të tilla. Njoftimi për fillimin e procedurës u botua edhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s.

- Gjithashtu me shkresën nr. 1558 prot., datë 27.6.2024, ERE ka njoftuar dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) mbi fillimin e procedurës së licencimit të kësaj shoqërie.

- Me shkresën me nr. 1448/3 prot., datë 24.6.2024, ERE i është drejtuar shoqërisë duke i njoftuar vendimin e fillimit të procedurës dhe duke i kërkuar plotësimin e dokumentacionit të konstatuar të pa plotësuar apo plotësuar pjesërisht. Në përgjigje, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1448/4 prot., datë 3.7.2024, shoqëria ka depozituar dokumentacion plotësues të aplikimit.

- Pas shqyrtimit të sa depozituar ka rezultuar se ka ende dokumentacion të paplotësuar, ndaj me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 146, datë 19.7.2024, u vendos që të zgjatet me 30 ditë afati i vendimmarrjes për aplikimin e shoqërisë për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, me qëllim plotësimin e tij.

- Pas korrespondencës së zhvilluar në vijim me shoqërinë, rezultoi se ajo ka plotësuar tërësisht

dokumentacionin në zbatim të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, konkretisht në zbatim të nenit 9, për pikën 1.1, gerrat “a”, “b” dhe “c”; për pikën 1.2, gerrat “a”, “b”, “c” dhe “d”; për pikën 1.3, gerrat “a”, “b” dhe “c”; për pikën 2.1, gerrat “a”, “b”, “c” “d”, “e” dhe “f”, si dhe ka kryer pagesën e aplikimit sipas përcaktimeve të aneksit A të kësaj rregulloreje.

- Rezulton se shoqëria “Nova Prospect” sh.p.k.:

- Ka nënshkruar me MIE-n kontratën nr. 4330 rep., nr. 1983 kol., datë 7.11.2022, “Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e centralit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike, me kapacitet prodhues 2 mw, i cili nuk është objekt koncesioni, dhe veprave ndihmëse, në zonën kadastrale nr. 2960, Baskia Himarë, qarku Vlorë, nga shoqëria ‘Nova Prospect’ sh.p.k.”;

- Ka marrë miratimin për ndryshimin e pikës së lidhjes nëpërmjet shkresës së shoqërisë Operatori i Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) sh.a., nr. 5428/3 prot., datë 29.5.2024, për lidhje e centralit fotovoltaike me rrjetin e shpërndarjes;

- Është pajisur me vendim për VNM-në paraprake, lëshuar më datë 17.8.2022, nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM), për të zhvilluar projektin “Ndërtimi i impiantit fotovoltaike, me fuqi të instaluar 2 mw, me vendndodhje Pilur, Himarë, me fuqi të instaluar 2 mw. Shoqëria ka dokumentuar në ERE fillimin e punimeve brenda afatit të vlefshmërisë së VNM-së paraprake (e vlefshme deri më 17.8.2024) dhe parashikon fillimin e operimit më datë 30.8.2024.

- Shoqëria ka dokumentuar aftësinë dhe mbështetjen financiare për realizimin e projektit sipas planit të saj të biznesit, si dhe ka depozituar shkresën e datës 17.7.2024, drejtuar MIE-s, për ndryshimin e vlerës së investimit. Në këto rrethana vlerësohet që t’i lihet kusht shoqërisë që të depozitojë në ERE qëndrimin e MIE-s dhe/ose amendimin përkatës të kontratës të nënshkruar me Autoritetin Kontraktor. ERE rezervon të drejtën e rishikimit të vendimit të licencimit në varësi të përcaktimeve të kontratës shtesë të koncesionit.

- ERE, në zbatim të nenit 38, pika 1, germa “a” të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, dhe nenit 5, pika 1, germa “a” të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e



energjisë elektrike” e ndryshuar, lëshon një licencë për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike deri në 30 vjet. Shoqëria ka informuar se jetëgjatësia e paneleve është 25 vjet, ndaj ERE-s kushtëzohet nga kjo jetëgjatësi në përcaktimin e afatit të vlefshmërisë së licencës, për 25 vjet. Ky afat do të fillojë nga data e parashikuar nga shoqëria për operimin e centralit, pra nga data 30.8.2024.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Nova Prospect” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltai me kapacitet të instaluar 2 mw, me vendndodhje në zonën kadastrale nr. 2960, Bashkia Himarë, qarku Vlorë, për një afat 25-vjeçar, duke filluar ky afat nga data 30.8.2024.

2. Shoqëria “Nova Prospect” sh.p.k. të raportojë në ERE çdo 3 (tre) muaj në lidhje me qëndrimin e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe/ose amendimin e kontratës së nënshkruar, për njoftimin e bërë nga ana e saj për ndryshimin e vlerës së investimit të projektit, dhe të depozitojë menjëherë në ERE këtë qëndrim apo amendim, në rast se pajiset me të.

3. Ky vendim është objekti rishikimi nga ERE në varësi të depozitimit të dokumentacionit të përcaktuar në pikën 2 të tij.

4. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë “Nova Prospect” sh.p.k. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM Nr. 165, datë 15.8.2024

MBI ZGJATJEN E VENDIMMARRJES SË BORDIT TË ERE-s LIDHUR ME SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË “BMG ENERGY SAL” SHPK PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 14, pika 3 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, e ndryshuar, si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96 datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 15.8.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1569/7 prot., datë 13.8.2024, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘BMG Energy Sal’ sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Shoqëria “BMG Energy Sal” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1569 prot., datë 1.7.2024, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltai, me kapacitet prodhues 2 mw, me vendndodhje në zonën Sheq Marinas, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, qarku Fier.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 141, datë 16.7.2024, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë në këtë veprimtari.

- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 17.7.2024 dhe 18.7.2024) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 26.7.2024), nuk rezultoi të ketë të tilla. Njoftimi për fillimin e procedurës u botua edhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s.

- Gjithashtu, me shkresën nr. 1659 prot., datë 19.7.2024, ERE ka njoftuar Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) mbi fillimin e procedurës së licencimit të kësaj shoqërie.



- Me shkresën me nr. 1569/3 prot., datë 19.7.2024, ERE i është drejtuar shoqërisë duke i njoftuar vendimin e fillimit të procedurës dhe duke i kërkuar plotësimin e dokumentacionit të konstatuar të pa plotësuar apo të plotësuar pjesërisht.

- Pas shqyrtimit të këtij dokumentacioni, në referencë të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, e ndryshuar, ka rezultuar se ka ende informacion/dokumentacion të paplotësuar, ndaj ERE-s i është drejtuar shoqërisë me shkresën nr. 1569/5 prot., datë 7.8.2024. Në përgjigje, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1569/6 prot., datë 13.8.2024, shoqëria ka depozituar informacion/ dokumentacion plotësues të aplikimit.

- Në nenin 14, pika 3, të rregullores së sipërcituar, parashikohet se Bordi mund të vendosë rast pas rasti për zgjatjen e afatit për marrjen e vendimit përfundimtar për pranimin ose refuzimin e aplikimit për licencë kur dokumentacioni nuk është i plotë, por jo më shumë se 30 ditë.

- Me qëllim shqyrtimin dhe analizimin e dokumentacionit të depozituar së fundi nga shoqëria dhe zhvillimin e ndonjë korrespondence të mundshme me të, vlerësohet të zgjatet deri në 30 (tridhjetë) ditë afati i vendimmarrjes së Bordit të ERE-s për aplikimin e shoqërisë “BMG Energy Sal” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të zgjasë deri në 30 (tridhjetë) ditë afatin e vendimmarrjes së Bordit të ERE-s për kërkesën e shoqërisë “BMG Energy Sal” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë “BMG Energy Sal” sh.p.k. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 166, datë 15.8.2024

MBI DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 135, DATË 9.7.2024 “MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË ‘5GX ENERGY’ SHPK NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE”

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 113 të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 15.8.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1731/1 prot., datë 7.8.2024, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi disa ndryshime në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 135, datë 9.7.2024 ‘Mbi licencimin e shoqërisë ‘5GX Energy’ sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike””,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 135, datë 9.7.2024, ka vendosur të *licencojë shoqërinë “5GX Energy” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaike me kapacitet të instaluar 10 mw, me vendndodhje në zonën kadastrale 1020, fshati Allprenaj, Njësia Administrative Golem, Bashkia Lushnjë, qarku Fier për një afat 30-vjeçar, duke filluar ky afat nga data 1.8.2024.*

- Në pikën 2 të këtij vendimi i është lënë kusht shoqërisë që të depozitojë në ERE qëndrimin e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) dhe/ose amendimin e kontratës së nënshkruar, për kërkesën e bërë nga shoqëria për ndryshimin e vlerës së investimit të projektit.

- ERE ka njoftuar shoqërinë për këtë vendimmarrje me shkresën nr. 866/8 prot., datë 15.7.2024, ku i ka kërkuar dhe të mbajë në konsideratë sa përcaktuar në këtë vendim.

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1731 prot., datë 5.8.2024, shoqëria ka depozituar në ERE kontratën nr. 2966 rep., nr. 642 kol., datë 2.8.2024, “Për disa ndryshime të kontratës nr. 2175 rep., nr. 484 kol., datë 23.6.2023 Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e centralit gjenerues



të energjisë elektrike fotovoltaike, me kapacitet prodhues 10 mw, i cili nuk është objekt koncesioni, dhe veprave ndihmëse, në zonën kadastrale 1020, fshati Allprenaj, Njësia Administrative Golem, Bashkia Lushnjë, qarku Fier nga shoqëria ‘5GX Energy’ sh.p.k.’, nënshkruar mes MIE dhe mbajtësit të miratimit për ndërtim, shoqërisë “5GX Energy” sh.p.k., në të cilën është ndryshuar vlera e investimit të projektit sipas planit të rishikuar të biznesit të shoqërisë.

- Me depozitimin e kësaj kontrate shtesë rezulton se shoqëria ka plotësuar kushtin e vendosur në pikën 2 të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 135, datë 9.7.2024, ndaj si e tillë kjo pikë vlerësohet të shfuqizohet.

- Me plotësimin e këtij kushti nuk gjen më zbatim as pika 3 e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 135/2024, si e tillë kjo pikë vlerësohet të shfuqizohet.

- Në nenin 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” është parashikuar mundësia e shfuqizimit të plotë apo të pjesshëm të një akti, apo ndryshimin e tij, me nismën e vet organit, që e ka nxjerrë, duke përcaktuar dhe formën ligjore të këtij ndryshimi të aktit, e cila duhet të bëhet me një akt të ri me shkrim

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Pikat 2 dhe 3 të vendimit të bordit të ERE-s nr. 135, datë 9.7.2024, shfuqizohen.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë “5GX Energy” sh.p.k. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM Nr. 177, datë 3.9.2024

MBI MIRATIMIN E KONTRATËS TIP PËR DEPOZITIMIN/SHKËMBIMIN/ SHITJEN/BLERJEN E ENERGJISË ELEKTRIKE MIDIS SHOQËRIVE KESH SHA DHE FTL SHA

Në zbatim të neneve 16, 20 germa “h”, si dhe 90, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; pjesës I, nenit 5, pikës 7, të vendimit të Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 456, datë 29.6.2022, “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”, të ndryshuar; si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 3.9.2024, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 1847 prot., datë 30.8.2024, të përgatitur nga Drejtoritë Teknike “Mbi miratimin e kontratës tip për depozitimin/shkëmbimin/ shitjen/ blerjen e energjisë elektrike midis shoqërive KESH sh.a dhe FTL sh.a.”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 279, datë 25.9.2023, vendosi miratimin e kontratës ndërmjet shoqërive KESH sh.a dhe FTL sh.a. për shitjen/ blerjen/depozitimin/shkëmbimin e energjisë elektrike për periudhën kohore 1.1.2023–31.12.2023.

- Me përfundimin e kësaj kontrate, shoqëritë KESH sh.a dhe FTL sh.a. kanë vijuar punën dhe nëpërmjet shkresës së përbashkët me nr. 1888/1 prot., datë 23.4.2024 të KESH sh.a. dhe me nr. 1748/1 prot., datë 23.4.2024, të FTL sh.a., përcollën në ERE kontratën ndërmjet shoqërive KESH sh.a. dhe FTL sh.a. për shitjen/ blerjen/ depozitimin/shkëmbimin e energjisë elektrike.

- Nga vlerësimet e bëra nga ERE rezultoi se kontrata e dërguar në ERE nuk ishte një kontratë tip, ndërkohë ligji nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, në nenin 20, germa “h” përcakton se: ERE miraton kontratat tip ose kushtet e përgjithshme të kontratave për shërbimet e rregulluara, të ofruara nga pjesëmarrësit e tregut, të ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik.



- Në vijim, në mbështetje të përcaktimeve të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, dhe neneve 23, pika 10, 2,7 pika 1 dhe 29, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, me urdhrin nr. 79, datë 28.5.2024, u përcaktua organizimi i një seance dëgjimore me përfaqësues të KESH sh.a. dhe FTL sh.a.

- Objekti i kësaj seance dëgjimore lidhej me “Kontratën ndërmjet KESH sh.a. dhe FTL sh.a. për shitjen/blerjen/depozitimin/shkëmbimin e energjisë elektrike” të përcjellë në ERE me shkresën nr. 1888/1 prot., të KESH sh.a. dhe nr. 1748/1 prot., të FTL sh.a., datë 23.4.2024. Seanca dëgjimore u përcaktua të zhvillohet në datën 3.6.2024. FTL sh.a., nëpërmjet *emal*-it të datës 3.6.2024 kërkoi shtyrje të seancës dëgjimore dhe ERE, po më datë 3.6.2024, ka njoftuar palët për realizimin e kësaj seance në datën 10.6.2024, ora 10:00.

- Në datën 10.6.2024 u realizua seanca dëgjimore me përfaqësues të shoqërive KESH sh.a., FTL sh.a. dhe përfaqësues të ERE-s.

- Palët deklaruan në këtë seancë dëgjimore se do të rishikonin kontratën e përcjellë më parë dhe do të bënin saktësimet përkatëse dhe do ta ridërgonin në ERE për miratim. Në këtë periudhë, VKM-ja nr. 456, datë 29.6.2022, “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”, sapo ishte ndryshuar me VKM-në nr. 337, datë 5.6.2024, dhe ishte e arsyeshme që kontrata të rishikohej dhe në përputhje me këto ndryshime të VKM-së.

- Shoqëritë, nëpërmjet shkresës nr. 3463/1 prot., datë 23.7.2024, të KESH sh.a., si dhe nr. 1748/4 prot., datë 23.7.2024, të FTL sh.a., kanë përcjellë në ERE, kontratën tip ndërmjet shoqërive KESH sh.a. dhe FTL sh.a. për shitjen/ blerjen/ depozitimin/ shkëmbimin e energjisë elektrike.

- Kontrata e përcjellë nga palët me shkresën e sipërcituar, me qëllim konsultimin publik është publikuar në faqen zyrtare të internetit të ERE-s në më datë 24.7.2024 dhe deri në këtë vendimarrje nuk është paraqitur asnjë koment në ERE nga palët e interesit.

- Kontrata e propozuar nga palët është e përbërë nga 10 (dhjetë) nene, si dhe aneksi 1 me emërtim:

Akt rakordimi për energjinë elektrike të depozituar/shkëmbyer/shitur/blerë midis palëve.

- Në nenin 1 “Objekti i kontratës” është bërë përcaktimi për rolet që KESH” sh.a. dhe “FTL” sh.a. do të kenë në këtë kontratë tip, për depozitimin, shkëmbimin, shitblerjen e energjisë elektrike në këtë paragraf evidentohet fakti që palët kanë përfshirë realizimin e këtyre transaksioneve “si dhe plotësimin e nevojave të klientëve universale”. Lidhur me këtë përcaktim të bërë nga palët evidentojmë se marrëdhënia ndërmjet KESH sh.a. dhe FSHU sh.a. për furnizimin e klientëve universal rregullohet me kontratën tip të miratuar nga Bordi i ERE-s me vendimin nr. 95, datë 20.5.2024, i cili ka vendosur miratimin e kontratës tip për shitblerjen e energjisë elektrike ndërmjet Shoqërisë së Prodhimit të Energjisë Elektrike të ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik, aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti, KESH sh.a. dhe Furnizuesit të Shërbimit Universal (FSHU) sh.a., për furnizimin e klientëve që furnizohen nga FSHU sh.a. Për rrjedhojë, ky përcaktim i kontratës, i propozuar nga palët në nenin 1, vlerësojmë të ndryshohet dhe të formulohet si më poshtë vijon:

“KESH sh.a. dhe FTL sh.a. lidhin dhe nënshkruajnë këtë kontratë tip për depozitimin, shkëmbimin, shitblerjen e energjisë elektrike, me qëllim plotësimin e kërkesës me sasi energjie elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes, furnizimin e klientëve të Shoqërisë Publike të Furnizimit në Tregun e Lirë për sasinë e pasiguruar në treg të parregulluar, sipas rasteve të mëposhtme;”.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Miratimin e kontratës tip për depozitimin/shkëmbimin/shitjen/blerjen e energjisë elektrike midis shoqërive KESH sh.a. dhe FTL sh.a. (bashkëlidhur).

2. Neni 1 i kontratës së miratuar në pikën 1 të këtij vendimi ndryshon dhe bëhet:

Ishte:

Neni 1

Objekti i kontratës

KESH sh.a. dhe FTL sh.a. lidhin dhe nënshkruajnë këtë kontratë tip për depozitimin, shkëmbimin, shitblerjen e energjisë elektrike, me



qëllim plotësimin e kërkesës me sasi energjie elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes, furnizimin e klientëve të shoqërisë publike të furnizimit në tregun e lirë për sasinë e pasiguruar në treg të parregulluar, si dhe plotësimin e nevojave të klientëve universale sipas rasteve të mëposhtme.”.

Bëhet:

“Neni 1

Objekti i kontratës

KESH sh.a. dhe FTL sh.a. lidhin dhe nënshkruajnë këtë kontratë tip për depozitimin, shkëmbimin, shitblerjen e energjisë elektrike, me qëllim plotësimin e kërkesës me sasi energjie elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes, furnizimin e klientëve të Shoqërisë Publike të Furnizimit në Tregun e Lirë për sasinë e pasiguruar në treg të parregulluar, sipas rasteve të mëposhtme.”.

3. Kontrata e nënshkruar nga palët, me ndryshimet sipas pikës 2 në këtë vendim, të dërgohet

në ERE, brenda 5 ditëve nga marrja dijani e këtij vendimi.

4. Drejtoria Juridike dhe e Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve të njoftojë shoqëritë KESH sh.a., FTL sh.a. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

Nr. 4897 Prot, datë 03 / 10 / 2024Nr. 3741 Prot, datë 03 / 10 / 2024**KONTRATË TIP PËR DEPOZITIMIN/SHKËMBIMIN/ SHITJEN/ BLERJEN E ENERGJISË ELEKTRIKE MIDIS SHOQËRIVE “KESH” SH.A. DHE “FTL” SH.A.**E lidhur sot më datë 03 . 10 . 2024, ndërmjet:

Shoqërisë “Korporata Elektroenergjitike Shqiptare” (KESH) SH.A., shoqëri aksionare regjistruar si person juridik me vendimin Nr.12728, datë 06.11.1995 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me seli në Rrugën “Viktor Eftimiu”, Blloku “Vasil Shanto”, Tiranë, Shqipëri, me NUIS J61817005F, e përfaqësuar nga z. Erald Elezi, që më poshtë do të quhet “Depozituesi/Shitësi/Blerësi”,

dhe

Shoqërisë “Furnizuesi i Tregut të Lirë” (FTL) SH.A., shoqëri aksionare, regjistruar në 30.03.2018 në Rregjistrin Tregtar të mbajtur pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit me NUIS L81530029T, me seli Bulevardi “Gjergj Fishta”, Ndërtesa Nr. 88, H. 1, Kati i IV, Njësia Administrative Nr. 7, 1023, Tiranë, Shqipëri, përfaqësuar nga Administratori z. Albi Gjenerali, që më poshtë do të quhet “Depozitëdhënësi/Blerësi/Shitësi”,

(të cilët do të referohen veç si më sipër së bashku si “Palët” dhe me vete si “Pala”)

Baza ligjore:

- Ligji Nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar;
- Vendimi Nr. 456, datë 29.06.2022 i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”, i ndryshuar;
- Urdhër Nr. 217, datë 29.12.2023 i Ministrit përgjegjës për Energjinë “Për një ndryshim në urdhërin nr. 28, datë 18.01.2021 “Për miratimin e udhërrëfyesit për hapjen e tregut dhe derregullimin e çmimit të energjisë elektrike”, i ndryshuar;
- Vendimi Nr. 23, datë 25.03.2009 i Bordit të Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë “Mbi rinovimin e licencave në aktivitetin e prodhimit dhe tregtimit të energjisë elektrike shoqërisë “KESH” SH.A. ”, i ndryshuar;
- Vendimi Nr. 121, datë 04.04.2023 i Entit Rregullator i Energjisë “Mbi rinovimin e licencës së shoqërisë “Furnizuesi i Tregut të Lirë” SH.A, (FTL SH.A) në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike dhënë me vendimin e bordit të ERE-s nr.199, datë 03.09.2018”;
- Vendimi Nr. 189, datë 06.06.2023 i Entit Rregullator i Energjisë “Mbi rinovimin e licencës së shoqërisë “Furnizuesi i Tregut të Lirë” SH.A, (FTL SH.A) në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e bordit të ERE-s nr. 198, datë 03.09.2018”;



- Vendimi Nr. 364, datë 15.12.2023 i Bordit të ERE-s, “Mbi miratimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike që do t’u paguhet prodhuesve me përparësi për vitin 2024”.

Në kushtet kur:

- Në nenin 12 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 456, datë 29.06.2022, i ndryshuar, parashikohet se shoqëria publike e furnizimit në tregun e lirë, deri në krijimin e operatorit të energjisë së rinovueshme dhe krijimin e tregut likuid të energjisë elektrike të ditës në avancë, do ta tregtojë energjinë elektrike nga burimet e rinovueshme të energjisë për mbulimin e humbjeve të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes dhe furnizim në tregun e lirë. Sasia e tepërt nga prodhimi i burimeve të rinovueshme të energjisë, pas mbulimit të humbjeve të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes dhe/ose furnizimit të klientëve në tregun e lirë, depozitohet në shoqërinë publike të prodhimit për t’u përdorur për nevoja të furnizimit të klientëve universalë.
- Gjithashtu, Furnizuesi i Tregut të Lirë për nevoja të furnizimit të klientëve të saj në treg të lirë ka të drejtë, në mënyrë proporcionale, ta sigurojë këtë energji në treg të parregulluar dhe/ose të përdorë tepëricat/depozitën nga prodhimi i burimeve të rinovueshme të energjisë.
- Në nenin 5, pika 7 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 456, datë 29.06.2022, i ndryshuar, parashikohet trajtimi i tepëricave të prodhimit të energjisë elektrike nga shoqëria publike e prodhimit, me qëllim mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes së “OSSH” SH.A.

Palët bien dakord si më poshtë vijon:

Neni 1**Objekti i Kontratës**

“KESH” SH.A. dhe “FTL” SH.A. lidhin dhe nënshkruajnë këtë kontratë tip për depozitimin, shkëmbimin, shitblerjen e energjisë elektrike me qëllim plotësimin e kërkesës me sasi energjie elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes, furnizimin e klientëve të shoqërisë publike të furnizimit në tregun e lirë për sasinë e pasiguar në treg të parregulluar, sipas rasteve të mëposhtme:

1. “KESH” SH.A. do të quhet “Shitësi” dhe “FTL” SH.A. do të quhet “Blerësi”, për atë sasi të energjisë elektrike që evidentohet si tepëricë e energjisë elektrike mbas mbylljes së bilancit dhe që ka patur destinacion plotësimin e kërkesës për mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes, furnizimin e klientëve të shoqërisë publike të furnizimit në tregun e lirë, të pasiguar në treg të parregulluar, për periudhën kohore 01.01.2024-31.12.2024.
2. “FTL” SH.A. do të quhet “Depozitëdhënësi” dhe “KESH” SH.A. do të quhet “Depozituesi”, për atë sasi të energjisë elektrike të evidentuar si tepëricë nga prodhimi i burimeve të rinovueshme pas mbulimit të humbjeve të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes dhe/ose tregtimit/plotësimin të nevojave të shoqërisë “FTL” SH.A. Kjo sasi e energjisë elektrike e depozituar, do t’i kthehet/shkëmbehet shoqërisë “FTL” SH.A. për plotësimin e kërkesës për humbjet në rrjetin e shpërndarjes dhe furnizimin në tregun e lirë gjatë vitit kalendarik 2024.
3. “FTL” SH.A., do të quhet “Shitësi” dhe “KESH” SH.A. do të quhet “Blerësi”, për atë sasi të energjisë elektrike e cila evidentohet në fund të vitit e pa kompensuar me energji elektrike për mbulimin e humbjeve dhe furnizimin e klientëve të shoqërisë publike të furnizimit në tregun e lirë, për sasinë e pasiguar në treg të parregulluar, ku “FTL” SH.A. ia shet “KESH” SH.A. me çmimin e blerjes së energjisë elektrike nga prodhuesit me përparësi hidrikë.
4. Sasitë e energjisë të depozituara/shkëmbyera/shitura/blera gjatë vitit kalendarik, në zbatim të parashikimeve të pikës 2, të nenit 15, të Vendimit Nr. 456, datë 29.06.2022, i ndryshuar, rakordohen

Faqe 2 nga 8



mes palëve bazuar në të dhënat faktike. Në procesin e rakordimit, sasia e energjisë elektrike e depozituar do të jetë ajo sasi e energjisë elektrike e prodhuar nga burimet e rinovueshme të energjisë përtej sasisë së alokuar për mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes dhe furnizimin e klientëve të shoqërisë publike të furnizimit në tregun e lirë të pasiguar në treg të parregulluar. Palët kujdesen që gjatë procesit të depozitimit/shkëmbimit, të rakordojnë çdo muaj në përputhje me dispozitat e mësipërme për saktësimin e sasisë së energjisë së depozituar/shkëmbyer.

Neni 2

Detyrimet kryesore të Palëve

1. “FTL” SH.A. përpara çeljes së procedurës së blerjes në treg të energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes, do të konfirmojë me “KESH” SH.A. sasinë gjendje të energjisë elektrike të depozituara, si dhe do të informojë “KESH” SH.A. për sasinë që ka planifikuar të blejë për mbulimin e humbjeve në rrjet, duke i kërkuar “KESH” SH.A. informacion mbi mundësinë që kjo e fundit ka për ta furnizuar me sasi energjie elektrike nga prodhimi i kaskadës.
2. “FTL” SH.A. çdo muaj/javë/ditë në avancë planifikon tepricat e pritshme të energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e rinovueshme të energjisë përtej sasisë për mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes si dhe plotësimit të nevojave të klientëve të saj në tregun e lirë të pasiguar në treg të parregulluar dhe i dërgon në rrugë elektronike shoqërisë “KESH” SH.A. për t’i depozituar/shitur, si më poshtë:
 - çdo ditë të enjte informacionin për javën në avancë në profil 24 orë;
 - kur është e nevojshme brenda orës 15:00 informacion të përditësuar për ditën D+2 në profil 24 orë;
 - brenda orës 12:00 informacion për ditën D në profil 24 orë.
3. “FTL” SH.A. pas mbylljes së bilancit energjetik dërgon në “KESH” SH.A. të dhëna për:
 - (i) sasinë faktike të prodhimit nga burimet e rinovueshme;
 - (ii) sasinë e energjisë që është importuar nga “FTL” SH.A. për mbulimin e humbjeve;
 - (iii) sasinë faktike të energjisë e cila është përdorur për mbulimin e humbjeve;
 - (iv) sasinë faktike të energjisë e cila është përdorur për plotësimin e nevojave të klientëve të saj në tregun e lirë, të pasiguar në treg të parregulluar.Saktësimi i sasive të depozituara/ të shkëmbyera do të bëhet mes palëve pas mbylljes së bilancit energjetik për muajin paraardhës.
4. “KESH” SH.A., në funksion të kapacitetit gjenerues (në rast prurjesh në kaskadë) përpara çeljes së procedurave të shitjes së energjisë elektrike, njofton shoqërinë “FTL” SH.A. mbi mundësinë e prodhimit të energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes, ndërsa kjo e fundit duhet të konfirmojë brenda afatit të përcaktuar në kërkesën e KESH-it pranimin ose jo të sasisë së energjisë elektrike të ofruar nga “KESH” SH.A. për mbulimin e humbjeve.
5. Bazuar në pozitën e palëve për muajt paraardhës, energjia e llogaritur mbi të dhënat më sipër do të përbëjë:
 - a) energji e depozituar, është teprica nga prodhimi i burimeve të rinovueshme që rezultojn nga energjia e prodhuar nga burimet e rinovueshme që tejkalon sasinë e pambuluar të humbjeve totale dhe nevojave të furnizimit të klientëve të shoqërisë publike të furnizimit në tregun e lirë të pasiguar në treg të parregulluar sipas bilancit energjetik të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes dhe Furnizuesit të Tregut të Lirë.
 - b) energji e shkëmbyer, është sasia e munguar nga prodhimi i burimeve të rinovueshme që rezultojn nga energjia e prodhuar nga burimet e rinovueshme që nuk plotëson humbjet totale dhe nevojat e furnizimit të klientëve të shoqërisë publike të furnizimit në tregun e lirë të pasiguar në treg të parregulluar.



parregulluar, sipas bilancit energjetik të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes dhe Furnizuesit të Tregut të Lirë.

Neni 3

Realizimi i transaksioneve

1. Sasia e tepërt e energjisë elektrike nga prodhimi i kaskadës së Drinit, pas ezaurimit të sasisë së energjisë së depozituar nga prodhimi i burimeve të rinovueshme të energjisë në periudhat pararendëse, i shitet “FTL” SH.A. nga “KESH” SH.A. për mbulimin e humbjeve me çmimin e blerjes së energjisë nga prodhuesit me përparësi hidrikë, në përputhje me parashikimet e nenit 5, pika 7 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 456, datë 29.06.2022, i ndryshuar.
2. Nëse në përfundim të rakordimit vjetor mes palëve, evidentohet se humbjet janë mbuluar përtej sasisë së energjisë së depozituar nga “FTL” SH.A. në “KESH” SH.A., dhe kjo sasi nuk është pjesë e prodhimit të “KESH” SH.A., atëherë kjo sasi do të faturohet me çmimin mesatar të ponderuar të sigurimit të kësaj energjie nga “KESH” SH.A. në periudhën përkatëse.
3. Transaksionet e depozitimit dhe shkëmbimit të energjisë do të realizohen pa çmim, por me bilance energjitike.
4. Transaksionet e shkëmbimit të energjisë do të realizohen në raportin: 1 (një) njësi e depozituar : 1 (një) njësi e kthyer.
5. Në rast se në fund të vitit, sasia e depozituar e energjisë së prodhuar nga prodhuesit me përparësi është më e madhe se ajo e kthyer për mbulimin e nevojave të humbjeve në rrjetin e shpërndarjes dhe të furnizimit të klientëve të shoqërisë publike të furnizimit në tregun e lirë të pasiguaruar në treg të parregulluar, atëherë “KESH” SH.A. do të kompensojë në vlerë këtë diferencë energjie, me çmimin e blerjes së energjisë nga prodhuesit me përparësi hidrikë.

Neni 4

Çmimi, faturimi dhe pagesa

1. Çmimi i shitjes dhe i blerjes së energjisë elektrike që do të zbatohet në këtë kontratë është ai i miratuar nga Bordi i ERE për energjinë e prodhuar nga prodhuesit me përparësi hidrikë.
2. Në rastin e shitjes së humbjeve, në përputhje me nenin 3, pika 1 të kësaj kontrate, nga shoqëria “KESH” SH.A. për “FTL” SH.A., Shitësi do t'i lëshojë Blerësit një faturë sipas formatit dhe standardeve që parashikon legjislacioni në fuqi, e cila paraqet sasinë totale të energjisë elektrike të dakordësuar nga Shitësi dhe Blerësi për mbulimin e humbjeve në sistemin e shpërndarjes. Lëshimi i faturës tatimore do të bëhet brenda datës 10 të muajit pasardhës të periudhës së livrimit të energjisë elektrike. Krahës faturës, Shitësi do t'i dorëzojë Blerësit edhe të dhënat shoqëruese/sqaruese që lidhen me faturimin.
3. Në përputhje me nenin 3, pika 5 të kësaj kontrate, shoqëria “FTL” SH.A. brenda datës 25 të muajit pasardhës të livrimit të energjisë elektrike, duhet t'i dërgojë “KESH” SH.A. informacion mbi sasinë faktike të energjisë elektrike të prodhuar nga prodhuesit me përparësi më shumë se ajo e kthyer për mbulimin e humbjeve në sistemin e shpërndarjes dhe për plotësimin e nevojave të klientëve të shoqërisë publike të furnizimit në tregun e lirë, të pasiguaruar në treg të parregulluar. Deri më datë 25 Janar për vitin pasardhës, Palët pas marrjes së të dhënave, rakordojnë detyrimin për tepicën nga prodhimi i burimeve të rinovueshme të energjisë, Aneksi Nr. 1 i kësaj kontrate, dhe lëshojnë faturën tatimore për shitjen sipas pozicionit në rakordim.
4. Pagesa e faturës nga ana e Blerësit, sipas përcaktimeve të pikës 2 të këtij neni do të bëhet brenda 30 ditëve kalendarike nga data e lëshimit të faturës.
5. Pagesa e faturës e lëshuar sipas rakordimit të pikës 3 të këtij neni, nga pala blerëse realizohet brenda 30 ditëve kalendarike nga data e lëshimit të faturës pasi palët me marrëveshje, kanë rakorduar dhe shuar me kompensim (netim) detyrimet reciproke që kanë rezultuar përgjatë vitit.

Faqe 4 nga 8



6. Vonesa në kryerjen e pagesës: Nëse Blerësi dështon në kryerjen e pagesës brenda afatit të përcaktuar në këtë Kontratë, shpërblimi për dëmet e shkaktuara si rezultat i vonesës, do të jetë sipas legjislacionit në fuqi. Në llogaritjen e kamatëvonesës nuk përfshihet data kur kryhet pagesa.

Neni 5

Mos-Performanca për shkak të Forcës Madhore apo pamjaftueshmërisë së plotësimi të kërkesës për klientët universalë

1. Përveç se kur specifikohet ndryshe, "Forcë Madhore" për qëllimet e Kontratës do të thotë një ngjarje jashtë kontrollit të arsyeshëm të Palës që pretendon Forcën Madhore ("Pala Pretenduese") që nuk mund ta shmangte ose ta kapërcente në mënyrë të arsyeshme dhe që bën të pamundur që Pala Pretenduese të kryejë detyrimet e livrimit ose pranimi, për shkaqet e mëposhtme, por pa u kufizuar me to:
 - a. defekti në komunikim ose i sistemeve kompjuterikë të OST-së përkatëse që e pengon Palën Pretenduese të kryejë detyrimet e livrimit ose pranimi;
 - b. pezullimi nga OST-ja përkatëse të livrimit, pranimi ose injorimit prej saj të detyrimeve të Palës Pretenduese lidhur me Programimin sipas Kontratës;
 - c. defektet apo ndërprerjet në rrjetin e shpërndarjes;
 - d. defektet apo ndërprerjet në sistemin e gjenerimit të "KESH" SH.A.
2. Nëse një Palë pengohet plotësisht ose pjesërisht për shkak të Forcës Madhore apo pamundësisë objektive të përcaktuar në këtë kontratë, do të konsiderohet se nuk ka ndodhur asnjë shkelje ose mospagim nga ana e Palës Pretenduese dhe ajo do të çlirohet (dhe jo thjesht pezullohet) nga këto detyrime për atë periudhë kohore dhe në atë shkallë që kjo Forcë Madhore e pengon performancën e saj. Asnjë detyrim për të paguar dëmet nuk do t'i merret Palës Pretenduese lidhur me sasinë e palivruara ose të pamarra.
3. Pala Pretenduese, sa më shpejt që të jetë e mundur pasi mëson për Forcën Madhore, do të njoftojë Palën tjetër për fillimin e Forcës Madhore dhe, për aq sa është e mundur, do t'i sigurojë një vlerësim jo-detyrues mbi zgjatjen dhe kohëzgjatjen e pritshme të paaftësisë së saj performuese. Pala Pretenduese do të përdorë gjithë përpjekjet komercialisht të arsyeshme për të lehtësuar efektet e Forcës Madhore dhe gjatë vazhdimi të Forcës Madhore, do t'i sigurojë Palës tjetër përditësime të arsyeshme, kur dhe nëse disponohen, mbi zgjatjen dhe kohëzgjatjen e pritshme të paaftësisë performuese.
4. Në rast dhe në atë shkallë që Shitësi çlirohet nga detyrimet e livrimit për shkak të Forcës Madhore, Blerësi do të çlirohet gjithashtu nga detyrimet korresponduese të pranimi dhe pagesës. Në rast dhe në atë shkallë që Blerësi çlirohet nga detyrimet e pranimi për shkak të Forcës Madhore, Shitësi do të çlirohet gjithashtu nga detyrimet korresponduese të livrimit.
5. Në rast të mos livrimit të plotë apo të pjesshëm të energjisë elektrike nga ana e Shitësit sipas sasisë së përcaktuar ndërmjet palëve, Shitësi, në rastin kur nuk shfajësohet nga Forca Madhore, siç përcaktohet në këtë nen, do t'i paguajë Blerësit një shumë për sasinë e moslivruar të energjisë elektrike, të barabartë me diferencën e çmimit ndërmjet çmimit të përcaktuar në këtë kontratë dhe çmimit më të lartë, nëse ka një të tillë, me të cilin Blerësi e ka blerë ose do ta blinte sasinë e palivruar të energjisë elektrike në treg, duke vepruar në një mënyrë komercialisht të arsyeshme, shumë të cilës do t'i shtohen edhe kostot shtesë, të dokumentuara.
6. Në rast të mos pranimi të plotë apo të pjesshëm të energjisë elektrike nga ana e Blerësit sipas sasisë së përcaktuar ndërmjet palëve, Blerësi, në rastin kur nuk shfajësohet nga Forca Madhore, siç përcaktohet në këtë nen, do t'i paguajë Shitësit një shumë për sasinë e papranuar të energjisë elektrike, të barabartë me diferencën e çmimit ndërmjet çmimit të përcaktuar në këtë kontratë dhe çmimit më të ulët, nëse ka një të tillë, me të cilin Shitësi e ka shitur ose do ta shiste sasinë e papranuar të energjisë

Faqe 5 nga 8



elektrike në treg, duke vepruar në një mënyrë komercialisht të arsyeshme, shumë të cilës do t'i shtohen edhe kostot shtesë, të dokumentuara.

Neni 6**Personat e kontaktit**

Të gjitha njoftimet, që dërgohen sipas ose në lidhje me këtë Kontratë, duhet të dërgohen me shkrim në adresën e mëposhtme ose e-mail:

Për "FTL" SH.A.	Për "KESH" SH.A.
Administratori i Kontratës	
Z./ Zj. Funksioni: Adresa: Bulevardi "Gjergj Fishta", Ndërtesa Nr. 88, H.1, kati IV, Njësia Administrative Nr. 7, 1023, Tiranë. Cel: + E-mail:	Z./ Zj. Funksioni: Adresa: Rr."Viktor Eftimiu", Blloku "Vasil Shanto", Tiranë. Cel: E-mail:
Programimi	
Z./ Zj. Funksioni: Adresa: Bulevardi "Gjergj Fishta", Ndërtesa Nr. 88, H.1, kati IV, Njësia Administrative Nr. 7, 1023, Tiranë. Cel: E-mail:	Z./ Zj. Funksioni: Adresa: Rr."Viktor Eftimiu", Blloku "Vasil Shanto", Tiranë Cel:+ 355 672135152 E-mail:
Back Office	
Z./ Zj. Funksioni: Adresa: Bulevardi "Gjergj Fishta", Ndërtesa Nr. 88, H.1, kati IV, Njësia Administrative Nr. 7, 1023, Tiranë. Cel: E-mail:	Z./ Zj. Funksioni: Adresa: Rr."Viktor Eftimiu", Blloku "Vasil Shanto", Tiranë Cel.: E-mail:

Faqe 6 nga 8



Neni 7

Legjislacioni në fuqi dhe zgjidhja e mosmarrëveshjeve

1. Legjislacioni në Fuqi: Përveç kur specifikohet ndryshe, kjo Kontratë do të interpretohet dhe drejtohet nga legjislacioni në fuqi i Republikës së Shqipërisë.
2. Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve: Përveç kur specifikohet ndryshe, çdo mosmarrëveshje që ngrihet lidhur me Kontratën do t'i referohet fillimisht për zgjidhje ERE-s. Secila palë mund të kërkojë gjithashtu zbatimin nga Gjykata të të drejtave të saj kontraktuale. Gjykata kompetente është Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

Neni 8

Parashikime kalimtare

1. Palët, bazuar në parashikimet e Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 456, datë 29.06.2022, i ndryshuar, rakordojnë sasinë e energjisë elektrike të depozituar/shkëmbyer përgjatë vitit kalendarik, sipas të dhënave faktike të periudhës së rakordimit.
2. Ky rakordim mbyllet jo më vonë se data 25.01.2025.

Neni 9

Hyrja në fuqi

1. Kjo Kontratë dhe secili nga kushtet këtu, do të hyjnë në fuqi pas miratimit nga Enti Rregullator i Energjisë.
2. Ajo mund të përfundojë, ndryshohet apo zgjidhet përpara datës së mbarimit të saj, vetëm me miratimin nga Enti Rregullator i Energjisë.

Neni 10

Të ndryshme

Kjo kontratë nënshkruhet në 6 (gjashtë) kopje të barazvlefshme, 3 (tre) kopje “KESH” SH.A. dhe 3 (tre) për “FTL” SH.A.

“Korporata Elektroenergjitike
Shqiptare” SH.A.

Erald Elezi

Erald ELEZI
ADMINISTRATOR



“Furnizuesi i Tregut të Lirë” SH.A.

Albi GJENERALI
ADMINISTRATOR





Aneksi Nr.1

Akt-rakordim për energjinë elektrike të depozituar/shkëmbyer/shitur/blerë midis palëve

Emërtimi	Nr	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Njësia kWh	
															Progresivi
Prodhimi i prodhuesve me përparësi	1														
Humbjet totale në rrjetin e shpërndarjes	2														
Energji për klientët e "FTL" SH.A të pasiguarur në treg të parregulluar	3														
Depozitum/Shkëmbim	4=1-2-3														

"Korporata Elektroenergjitike Shqiptare" SH.A.

Administrator



"Furnizuesi Tregut të Lirë" SH.A.

Administrator



**KËRKESË****Nr. 498/12, datë 4.10.2024****PËR SHPRONËSIM PUBLIK**

Agjencia Shtetërore për Shpronësimin shpall kërkesën “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit ‘Rikonstruksioni i shkollës së mesme, ‘Ramis Aranitasi’ Çorovodë, si dhe ruajtjes së perimetrit të sigurisë në shkolla”, me vlerë totale paraprake të shpronësimit prej 1,105,974 (një milionë e njëqind e pesë mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e katër) lekësh.

Subjekti kërkues i këtij projekti është Bashkia Skrapar.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim, për interes publik, për pasuritë e paluajtshme, pronë private, të cilat do të kompensohen sipas vlerësimit paraprak të llogaritur:

- Për pasuritë e llojit “truall” është bërë bazuar në vendimin nr. 89, datë 3.2.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”;

- Për pasuritë e llojit “ndërtesë” është bazuar në VKM-në nr. 138, datë 23.8.2000, “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive, pronë private, që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, të ndryshuar.

Personat që preken nga ky projekt të cilët kanë emrin në tabelën e publikuar dhe personat të cilët preken por nuk figurojnë në këto lista, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga publikimi në Fletoren Zyrtare, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre, të shoqëruara me dokumentacionin përkatës, si edhe të shprehen nëse janë dakord me të dhënat e publikuara, për përfundimin e procedurave të shpronësimit, pranë Bashkisë Skrapar, si dhe në Agjencinë Shtetërore për Shpronësimin.

Vlera totale paraprake e shpronësimit është 1,105,974 (një milionë e njëqind e pesë mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e katër) lekë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
KRYETAR I KOMISIONIT TË POSAÇËM
TË SHPRONËSIMIT
Kastriot Gurra



LISTA PARAPRAKE
E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN PËR INTERES PUBLIK NGA PROJEKTI “RIKONSTRUKSION I SHKOLLËS ‘RAMIZ ARANTASI’,
ÇOROVODË, SI DHE RUAJTJES SË PERIMETRIT TË SIGURISË NË SHKOLLA”

Nr.	Pronari			Të dhëna hipotekore										Vlerësimet për shpronësim											Shënime (kufizime hipotekore, barrë mbi pasurinë etj.)		
														Arë			Trrall			Ndërtesë			Kultura bujqësore dhe dru frutorë			Vlera totale (lekë)	
	Emër	Atësi	Mbiemër	Fshati ose qyteti	Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sipërfaqja totale	Arë (m²)	Trrall (m²)	Ndërtesë (m²)	Volumi	Faqe	Sipërfaqja (m²)	Çmimi (lekë/m²)	Vlera (lekë)	Sipërfaqja (m²)	Çmimi (lekë/m²)	Vlera (lekë)	Sipërfaqja (m²)	Çmimi (lekë/m²)	Vlera (lekë)	Vlera e kulturës bujqësore (lekë)	Vlera e drufrutërve (lekë)			
	a	b	c	d	e	f	g	h	i	j	k	l	m	n	o	p=n*o	q	r	s=q*r	t	u	v	x	y	z		
1	Flora	Halil	Jazexhiu	Çorovodë	1420	10/65	Ndërtesë	34			34	10	239			0	0	1,015	0	34	19,521	663,714			663,714	Seksioni D: Shteti është pronar i trrallit 10/131 (v. 10, f.238) mbi të cilin është ndërtues 10/65.	
2	Dajlan	Rrahman	Sciti	Çorovodë	1420	10/66	Ndërtesë	20			20	10	241			0	20	1,015	20,300	20	21,098	421,960			442,260	Seksioni E: Nr. dok. 3856, dt. e regjistrimit 27.10.2005, Vënie sekuestro konservative nr. 361 prot., datë 25.10.2005. Nr. dok.7060, dt. e regjistrimit 7.3.2018. Vënie sekuestro konservative nr. 292/5 prot., datë 23.1.2018, nga përmbanuesi "Kozeta Çaka".	
														0		0	20		20,300	54		1,085,674	0	0	1,105,974		
Çmimet për pasuritë e llojit "trrall" janë marrë nga harta e vlerës, miratuar me VKM-në nr. 89, datë 3.2.2016.																											
Vlerësimet e llojit "ndërtesë", janë bërë sipas VKM-së nr. 138, datë 23.2.2000, të ndryshuar.																											

Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2024

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006



Çmimi 240 lekë